Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (114). TETOR 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.




Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

Folk, Art, Libra

Jeta kulturore mbyll vjeshtën në Dibër









Folku, arti dhe libra do ta ngrohin qytetin e Peshkopisë në këto ditë të fundit të tetorit.

Një ekspozitë e piktorit të talentuar Zaim Elezi - Zaya, i cili kthehet pas 20 vitesh në vendlindje me pikturat e tij plot ngjyra, detaje e ngrohtësi, hap siparin e veprimtarive. Ndërsa një koloni piktorësh ndër më të njohurit në vend, së bashku me piktorë nga Peshkopia dhe Dibra e Madhe, do të hedhin në telajo ngjyrat e vjeshtës. Panairi i Librit kthehet për të dytin vit radhazi në qytet, duke vazhduar një traditë të nisur. Poetë, shkrimtarë, autorë nga Dibra dhe jashtë saj, do të kenë mundësi të takohen me miqtë dhe lexuesit e tyre. Ndërsa Oda Dibrane, festivali i këngës dhe valles nis edicionin e 21-të, duke e kthyer këtë fundjavë në Peshkopi në një dasmë të vërtetë.

Të gjitha këto veprimtari janë një shans që Dibra të ringrihet kulturalisht, por edhe një mundësi e shpejtë që qyteti të presë më shumë vizitorë. Gjithashtu, këto veprimtari së bashku japin mesazhin që gjëra të tilla mund të ndodhin më shpesh, atëherë kur rruga të jetë e ndërtuar.

Të organizosh veprimtari të tilla nuk është e mundur të realizohet vetëm nga institucionet vendore apo dashamirësia e ndonjë individi, sado e madhe qoftë ajo. Është e nevojshme që një rreth më i madh individësh, biznesesh apo shoqatash të vetangazhohen në këtë proces. Shoqatat dibrane nuk po mundin që të bëhen katalizatorë të organizimit të veprimtarive të tilla, megjithëse shpesh përpiqen në këtë drejtim.

Kështu që ka ardhur koha e krijimit të një rrjeti biznesesh dhe qytetarësh të angazhuar, të cilët të ndihmojnë në realizimin e veprimtarive të tilla. Vetëm një angazhim individual dhe pa kërkuar përfitime direkte do të bëjë të mundur që në të ardhmen veprimtari të tilla të jenë më të shpeshta, më të shumta dhe të sjellin përfshirjen në këtë projekt edhe të fushave të tjera kulturore si filmi, teatri, muzika, angazhimin e të rinjve, etj.

Deri më tani Dibra është parë si një pasuri që duhet ta vjelim: që nga prodhimet bujqësore e blegtorale, minierat e pasuritë e saj natyrore e ujore e deri te vota.

Tani është koha të rikthehemi në Dibër. Për ta gjallëruar jetën ekonomike e sociale në qytet. Kështu që besojmë se krijimi i një rrjeti vullnetarësh e kontributorësh, pa interesa financiare në plan të parë, do të arrijmë që ta rikthejmë Dibrën në faqen e parë të artit dhe kulturës. Kjo nuk ka nevojë për përzgjedhje selektive dhe as për ftesa të bukura. Është koha të vetangazhohemi me mundësitë që ka secili, që këto veprimtari të mos jenë të fundit...

Speciale - AGRON TUFA - SHABAN SINANI - EQREM BASHA - XHAFER MARTINI - ZAIM ELEZI - HALIL TEODORI - RAMIZ GJINI - ABDURAHIM ASHIKU - NAIM BERISHA - EDMOND HASANI - HAMDI HYSUKA - DESTAN RAMA - FAIK BALLANCA - NAIM PLAKU - MEVLUD BUCI - LUTFI HANKU - ARJAN KADIU - BASHKIM LLESHI

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin
www.knauf.al

cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (114). 1 - 31 Tetor 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Agron TUFA
Shaban SINANI
Erqrem BASHA
Xhafer MARTINI
Zaim ELEZI
Halil TEODORI
Ramiz GJINI
Agim BAÇI
Abdurahim ASHIKU
Naim BERISHA
Edmond HASANI
Destan RAMA
Hamdi HYSUKA
Naim PLAKU
Mevlud BUCI
Lutfi HANKU
Arjan KADIU
Bashkim LLESHI
Albert VATAJ
Engjëll CELIBASHI
Dukagjin HATA

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

SHOQATA BASHKËSIA DIBRANE I KËRKON KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS:

Një obelisk në kujtim të shpërnguljes së dibranëve

Bashkësia Dibrane ka organizuar në fillim të tetorit një mbledhje të përbashkët mes

Kryesisë së Shoqatës Këshillit të të Urtëve. Në këtë mbledhje, e cila u hap nga Kryetari i SHBD-së, prof. Bujar Kapexhiu, u përcoll mesazhi dhe fryma që mes komunitetit dibranë dhe shoqatës duhet të ketë më tepër bashkëpunim, pjesëmarrje të të rinjë dhe komunitetit dibranë në Tiranë, në veprimtaritë kulturore, sociale dhe promovuese të autorëve, shkrimtarëve e botuesve dibranë.

Në mbledhje merrnin pjesë nga kryesia e SHBD-së, anëtarët, B. Kapexhiu, S. Shatku, M. Erebara, F. Gjymishka, R. Hysa; ndërsa nga Këshilli i të Urtëve ishin prezent në takim anëtarët: T. Jegeni, A. Daci, N. Kosovrasti, F. Kaba, Sh. Kodra, A. Pregja.

Kryesie dhe Këshilli miratuan kalendarin e aktiviteteve për periudhën Tetor 2015-Shator 2016. U diskutua nga T. Jegeni materialet shkencore dhe përgatitja për botim i librit studimor: "Dibra e Madhe dhe Radika"; Ing. F. Kaba foli mbi rëndësinë e programit të SHBD-së, si dhe për ristië që ka sot projekti për implemetimin e "Rrugës së Arbërit". Kurse N. Kosovrasti, A. Pregja, F. Gjymishka dhe R. Hysa, e vunë theksin në krijimin e komisioneve të posaçme (ad-hoc) që do të merren me sesionet shkencore dhe krijimin e grupeve që do të vlerësojnë



Në foto: Dibranët gjatë eksodit në Tiranë. Foto e marrë nga profili ne FCB i Ilia Karanxhës

figurat patriotike, kombëtare dhe kulturore nga Dibra e Madhe, si dhe mbi hartimin e një programi për të përcaktuar numrin total të popullsisë dibrane në Tiranë, ardhur nga vjeshta e 1913 e deri sot.

Menjëherë pas këtij takimi, shoqata i është drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë me një kërkesë për miratimin e një sheshi në njësinë administrative nr.3, (lagja dibranëve) për ngritjen e obeliskut/pllakatë, kushtuar komunitetit dibran në Tiranë si dhe mikëpritjes që familjet tiranase i bënë qytetarëve dibrane ardhur në shtatorin e 1913, si pasojë e genocidit serb.

Fushë-Bulqizë, banorët e katër fshatrave në protestë për mbrojtjen e pyjeve

Dhjetra banorë të katër fshatrave në Fushë-Bulqizë, kanë protestuar gjatë muajit tetor në mbrojtje të pyjeve. Protesta e tyre është zhvilluar para zyrave të njësisë administrative Fushë-Bulqizë, në bashkinë Bulqizë. Banorët kundërshtojnë hapjen e një rruge automobilistike që një firmë tenderuese po ndërton për pastrim-sistemim të pyjeve në këtë zonë. Ndërkohë që firma ka nisur punën për hapjen e rrugës automobilistike drejt këtyre pyjeve, banorët janë "pushtuar" nga hamendësimet se po ju merren pyjet, ndaj dhe e para gjë që kanë kundërshtuar, ka qenë ndërtimi i rrugës. Banorët kundërshtojnë ndërtimin e rrugës, pasi ata dyshojnë se firma tenderuese nuk do të pastrojë e sistemojë pyjet sipas objektit të tenderit, por do të shfrytëzojë lëndën drusore për shtylla miniere dhe dru zjarri, proçese këto që janë objekt i liçensimit të kësaj firme.

Sipas kryeplakut të fshatit Dushaj, Lahim Deda, firma po punon ilegalisht, pasi në asnjë rast nuk e ka bërë transparente liçencën për shfrytëzimin e pyjeve tona. Në të tilla kushte, kur firma nuk bën transparente lejen e marrë për ndërhyrje në ndërtimin e rrugës automobilistike, ne dyshojmë se një gjë e tillë bëhet për shfrytëzimin e pyjeve tona dhe jo për pastrim-sistemimin e tyre. Dyshimet tona, vijon kryeplaku, rriten ndjeshëm kur firma e nis punën me ndërtimin e rrugës automobilistike, e cila çon në hyrjen e makinave në këto pyje, të cilat përdoren për transportin e lëndës drusore. Në dijeninë time firma e ka marrë liçencën për pastrim pyjesh pa hapje rruge. Ndaj nxitimi i firmës për hapjen e rrugës, na bën të dyshojmë se kjo bëhet për shfrytëzimin e lëndës drusore. Shqetësimin e banorëve e kemi përcjllë me anë të letrave që kemi dërguar pranë institucioneve shtetërore vendore dhe qendrore, por deri më tani asnjë përgjigje nuk



kemi marrë. Ne po protestojmë, por askush nuk po na dëgjon. Vetëm Prefektja e Qarkut të Dibrës, Donika Hyseni, vijon në fjalën e tij kryeplaku, deri më tani, i ka konsideruar të drejta protestat tona në mbrojtje të pyjeve. Banorët akuzojnë se firma hajdutëshe, fshehtas, duan të shfrytëzojnë pyjet tona, por nuk do ti lejojmë të marrin pasurinë tonë. Shteti duhet të na mbrojë, por deri më tani nuk është bërë asnjë ndërhyrje.

Banorët janë të revoltuar pasi ndërhyrjen e firmës e konsiderojnë të paligjëshme. Ndërkohë thonë ata, dy janë pasuritë tona që na mbajnë të mbërthyer me vendlidjet; - pyjet dhe uji. -Mendo tani kur të dyja këto pasuri duan të na i marrin. Pasi po na prenë pyjet, na pritet edhe uji i pijshëm, pasi ata shkojnë bashkë. -Atëherë përse duhet të rrijmë këtu ne, thonë banorët. – Le të ikim pra nga sytë këmbët, të kërkojmë edhe ne si shumë të tjerë azil në Gjermani, apo diku tjetër, pasi s'kemi çtë bëjmë më këtu, thotë Artani një i ri nga fshati Koçaj.

Banorët e kundërshtojnë ndërtimin e rrugës, pasi dyshojnë se kjo bëhet që firma të shfrytëzojë pyllin ilegalisht. Misteri dhe dyshimi mbi këtë tendër, thotë kryeplaku i fshatit Koçaj, Qemal Stafa, shtohen dukshëm kur në një shkresë zyrtare është përdorur edhe një firmë dhe vulë e imja si kryeplak, që gjoja unë në emër të fshatit kam rënë dakord për ndërtimin e kësaj rruge, gjë të cilën unë e denoncoj publikisht se nuk është firma dhe vula ime.

Protestuesit shprehen të vendosur se nuk do të lejojnë që pyjet në zonën e tyre të shfrytëzohen hajdutshe, pasi ditë e natë, thonë ata, ne do jemi në mbrojtje të tyre, kjo për faktin e thjeshtë se jeta jonë e fëmijëve tonë dhe brezave që do vijnë lidhet me këto pyje. Prerja e tyre në lë pa ujë dhe pa ujë nuk ka jetë, shprehen njëzëri banorët. Ndaj nëse protestat tona do të vijojnë të bien në vesh të shurdhët, si deri më tani, ne do t'i përshkallëzojmë ato deri në bllokim të rrugës nacionale.

Dy protestat e zhvilluara nga banorët, kanë qenë të qeta dhe nën vëzhgimin korrekt të policisë.

Lh



Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një kontribut vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

***Merr versionin* PDF ose kopjen print**
duke kontribuar vetëm me 50 lekë/muaj

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME
të ndryshme për biznese dhe individë.

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën
RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë zyrtarë për **PESHKOPINË** dhe **DIBRËN E MADHE**.
Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

Redaksia

Rruga e Arbërit nr. 114

veprimtari

Zhvillohet për 10 vite me radhë panairi “Festa e të vjelave”

Prodhimet bujqësore *më cilësore* *dhe* **më pranë konsumatorit**

Nga **OSMAN XHILI**

Dhjetë vjet që nga tetori i vitit 2005. Dhjetë vjet, qëkur drejtori i atëhershëm i bujqësisë në Dibër, Maksim Hajrullai, bashkë me stafin e tij, vendosi të organizojë një panair bujqësor në qytetin e Peshkopisë. Ishin para një sprove që do t’u jepte apo do t’u ulte pikë, për nga mënyra si do organizohej. A do të vinin fermerët në panair, a do të kishte vizitorë, cilat do të ishin mbresat? Po koha, si do të ishte?

Po në të vërtetë çdo gjë shkoi mirë dhe i kaloi pritshmëritë. Produkte të shumta të ekspozuara, vizitorë të shumtë, përshëndetje miqsh nga larg e nga afër dhe bindja se kishte filluar një aktivitet që kurrë s’do të ndalej. Më pas u ndryshuan stafe, u ndryshuan drejtorë, por dhe ministra u ndryshuan, vetëm një gjë mbeti e pandryshuar, panairi. Mbeti ajo vazhdë, ai amanet, që grupet ia linin njëri-tjetrit.

Ky vit ishte i dhjeti. Pa buxhet nga shteti ishte disi e vështirë. Nuk ishte i planifikuar dhe e detyruar. Mund dhe të mos e bënim. Më lehtë do të ishte, më rehat. Por drejtori, Novrus Jashari, bashkë me stafin, u angazhuan me një përkushtim maksimal. Ekonomist nga profesioni, ai i përcaktoi gjërat deri në detaje, shpenzimet, ftesat e miqve, banderat, pozicionet e fermerëve. Vërtet nuk kishte buxhet nga ministria, por kishim plot miq e shokë ,institucione, organizata, shoqata e fondacione, që dhanë bujarisht ndihmën e tyre. Nuk ndihmonin thjesht drejtorinë e bujqësisë, por ndihmonin fermerët, promovonin bujqësinë e Dibrës, vlerat dhe dinjitetin e Dibrës mbarë.

Dhe pse pak kohë në krye të qarkut Dibër, kryetari, Hajri Laçi, e prezanton veten si dashamirës dhe kontribues në evente të tilla. Ai ishte si të thuash sponsori gjeneral i panairit. Jo pak kontribuan fondacionet FAFI, ADAD, CNVP, si dhe Ismail Beka i projektit Giz.

Pothuaj të gjitha gjërat ishin llogaritur me kujdes, por njëra jo, koha. Ajo nuk ishte njerëzore, ishte hyjnore. Sinoptikanët parashikonin ditë të tëra me reshje dhe kjo do të thoshte dështim. Të gjithë ato përpjekje shumëzoheshin me zero dhe gjithë prodhimi do të rezultonte i tillë. Një natë para, kur miqtë shkuan të flenë rehat pas një darke të organizuar, dhe shiu vazhdonte të bjerë me gjyma, drejtor Novruzi mbledh dhe njëherë stafin për të diskutuar shpejt dy variante rezervë, në rast se të nesërmen do të kishte shi të dendur. Në fakt, ajo që quhej e nesërmja, ishin vetëm disa orë kohë. Por, që të dy këto variante nuk kishin as gjysmën e vlerës të asaj që dëshironim, me një kohë normale. Nuk na mbetej tjetër veç të lusnim Zotin që të bënte një mrekulli të nesërmen, ashtu si vetëm Ai di dhe mund t’i bëjë.

Vërtet mrekullia ndodhi. Shiu u këput si me dorë, retë u davaritën dhe u tërhoqën maleve dhe doli një diell që, edhe pse nuk ngrohte shumë, ishte i mjaftueshëm. Mbi 150 fermerë kishin mbushur të dy anët e bulevardit që herët në mëngjes. Blerim Dibra, Qerim Kadriu, Fitim Majmari, Agron Neziri dhe gjithë pjesa tjetër e stafit ishin përpjekur fort, që asgjë të mos u mungojë pjesëmarrësve. Nuk ishte e nevojshme të shkoje në fshatra e komuna për të parë. Të gjithë fermerët



Produkte të shumta të ekspozuara, vizitorë të shumtë, përshëndetje miqsh nga larg e nga afër dhe bindja se kishte filluar një aktivitet që kurrë s’do të ndalej. Më pas u ndryshuan stafe, u ndryshuan drejtorë, por dhe ministra u ndryshuan, vetëm një gjë mbeti e pandryshuar, panairi. Mbeti ajo vazhdë, ai amanet, që grupet ia linin njëri-tjetrit.

e të gjithë produktet kishin ardhur aty. Shumë shokë e miq nga afër e larg. Kishte ardhur për të përshëndetur e uruar pjesëmarrësit, zv. ministri i Bujqësisë, Gjokë Jaku. Bashkë me të, kryetarët e bashkive, Dibër e Bulqizë, Shukri Xhelili dhe Milaim Damzi. Kishin ardhur drejtorët e bujqësisë së Lezhës, Durrësit, Beratit, Korçës, Kukësit, me një pjesë të stafeve të tyre. Që të gjithë ishin në të njëjtin mendim, në të njejtin konkluzion. Mënyra e organizimit, cilësia dhe vlera e produkteve ishin në shkallën më të lartë. Tonet jo shumë të larta të muzikës popullore, vallet karakteristike dibrane të luajtura mjeshtërisht nga djem e vajza të talentuar dhe një grup tjetër të rinjsh me numra cirku, sikur e plotësonin akoma më shumë dekorin e kësaj feste.

Ndoshta molla dominonte, në lloje e madhësi të ndryshme, ngjyra e shije të veçanta. Kishte Starking, Golden, Gran smith, Gala, Renetë e plot varietete të tjera. Fermerë të qeshur, të lumtur e krenarë për atë çfarë kanë arritur. Disa kanë prodhuar 100 kuintalë, disa të tjerë 200 kuintalë, kurse Veip Salkurti, Dan Seiti, Premtim Agolli, Zenel Kaja, Qatip Doda, Medin e Bilbil Kryemadhi shkojnë nga 300 deri në 1000 kuintalë mollë, të prodhuar në fermat e tyre. Prodhimet e këtij viti kanë qenë vërtet shumë cilësore, pa kromë, pa kalbëzim dhe me të gjitha parametrat që i kërkon tregu dhe konsumatori.

Jo vetëm molla, por në panair ishte i pranishëm dhe lëngu i mollës i prodhuar nga Veip Salkurti, falë një subvencioni të A.ZH,B.R.- së dhe shtetit shqiptar, si dhe bashkëpunimit me një kompani franceze, me shumë eksperiencë në sferën e agro-përpunimit. Në të ardhmen, me siguri do të kemi dhe lëngun e qershisë, vishnjës, dardhës, ftoit, por dhe të domates, manaferrës e të tjera si këto. Le të jetë ky dhe një moment reflektimi për ato gabime të pafalshme që bënë dibranët në atë fillim tranzicioni, duke prerë blloqe me pemë frutore, duke shkatërruar fabrikën e përpunimit të frutave, që ishte ndër më të mirat në Ballkan, me një gamë prodhimesh që eksportoheshin në shumë vende të Europës.

Në çdo 5 – 6 fermerë, njëri prej tyre duhej të ishte bletar. Ja tek i sheh me vazo dhe kavanoza me mjaltë, ngjyra e të cilit varion dhe sipas llojit të kullotës. Sot qarku i Dibrës prodhon 134 ton mjaltë, të një lloji shumë cilësor e kurues, falë një bimësie që rrallë rrethe e kanë të tillë. Nuk mund të mungonte në panair Haxhi Miftari i Maqellarës, që mbarështon 400 koshere me bletë, Ismet Koltraka i Kastriotit, Arian Zogu i Zerqanit dhe shumë të tjerë. Ata janë mjeshtra jo vetëm të prodhimit të mjaltit, por dhe të qumështit të bletës, të dyllit, të nënprodukteve të tjera, duke e shndërruar këtë sektor në një industri të vërtetë.

Disa fermerë të tjerë kanë veshur bluza e kapuçë të bardhë. Këto futen te sfera e agro-përpunimit, pasi prodhojnë gjizë e lloje të ndryshme djathërash. Aty takon haxhi Elez Cibakun, që sjell djathin e përpunuar në bjeshkët e Gramës së Korabit. Ka mbushur të tetëdhjetat, por lëviz e punon si një djalë i ri. Nuk mundet t’u përgjigjet kërkesave të shumta. Nuk i ka mbetur më gjë për të shitur. Vetëm të shesë shpirtin e tij bujar dhe të marrë që tani kërkesat për vitin tjetër.

Pak më tej është Sakip Ngota dhe ky një baxhier me shumë eksperiencë. Ka kohë që Sakipi ka hapur baxhon dhe një dyqan në qytet, ku tregton produkte cilësore, që plotësojnë e kënaqin shijet e konsumatorëve.

Më tej akoma një tjetër, Lulzim Piku, nga Maqëllara. Ai ka punuar rreth 20 vite në një fabrikë qumështi, në Itali dhe ka mësuar të punojë rreth 12 lloje djathërash. Dëshiron të ngrejë një fabrikë të mirëfilltë qumështi, si ajo që vizitoi në Prilep të Maqedonisë, duke ndihmuar kështu veten e familjen e tij, por dhe qindra fermerë me lopë dhen e dhi, që do të gjenin një strehë për të dorëzuar qumështin e përmirësuar ndjeshëm të ardhurat e familjes.

Kanë ardhur në panair grupi i arrorëve që drejtohet nga Hamit Salkurti. Ata janë shumë dhe akoma më shumë do të bëhen në të ardhmen, si për të treguar se rrethi ynë ka kushte të mrekullueshme për arrën, lajthinë, gështenjën. Po ashtu na nderojnë grupe grash nga fshatra të ndryshëm me produkte të përpunuara fshati. Anila Xhumbulla, drejtuesja e tyre, ka besimin e plotë se në të ardhmen ato mund të jenë një faktor i rëndësishëm për të shtuar të ardhurat në familjet e tyre.

Kështu zgjaten e zgjaten vargjet e fermerëve në panair me ftonj të verdhë që kundërmojnë aromë të mirë të Urim Tukës, nga Melani, me kunguj të bardhë , të mëdhenj, që duan net dimri për t’i konsumuar, fasule me kokërr mbi mesatare që do fare pak kohë për t’u zier, me qepë e hudhra me thelpinj të mëdhenj, me vlera të larta kurative. Ka vite që në panair ekspozohen në një tavolinë të veçantë produktet autoktone të Dibrës. Molla e Vilës, molla e Radoveshit, dardha e Gurit dhe ajo Meliçanke, qepa e Melanit, fasulja e Reshanit, speci i Gjoricës, sikur i japin kolorit këtij eventi të rëndësishëm. Por është shumë e pakët ekspozimi i tyre njëherë në vit, pasi duhet një punë studimore dhe me një subvencion të veçantë, që këto vlera të rralla të ardhur nga shekujt të mos na zhduken e t’u themi brezave, ne kishim dikur...

Gati po afronte dreka. Ca pika shiu rrëshqitën në fytyrat e njerëzve, por tani gjërat po shkonin drejt mbylljes. Sërish falenderuam Zotin që na mundësoi këtë aktivitet të bukur dhe u shpërndamë duke bërë një betim në heshtje se duhet punuar më fort për Dibrën e dibranët.





oda dibrane

Zhvillohet në Dibër dhe Peshkopi edicioni i 21-të i Odës Dibrane.
Marrin pjesë grupe nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Oda Dibrane, *festivali i ritit dhe traditës*

Oda Dibrane vjen këtë herë në Dibër të Madhe dhe Peshkopi në edicionin e 21-të të saj. Ditët e Odës sjellin në qytet një festë të jashtëzakonshme. Këtë tetor, në odën dibrane janë grupe grupet folklorike jo vetëm nga vendi, por edhe nga Kosova dhe Maqedonia, Shqipërisë, duke sjellë me vete copëza folklorike të krahinave përkatëse, me një stil krejt të veçantë të valles humoristike, këngës, ritit dhe alegorisë.

Veli Vraniçi, organizatori i festivalit, thotë se ka një presion të jashtëzakonshëm për të marrë pjesë në Odën Dibrane nga grupe të ndryshme, por vështirësitë financiare të organizimin nuk e bëjnë të mundur që të gjithëve t'u realizohet dëshira.

Këtë vit, nata e parë e festivalit zhvillohet në Dibër të Madhe në Pallatin e Sportit. Më herët, në shëtitoren e sapondërtuar të qytetit do të parakalojnë grupet e ardhura, duke prezantuar jo vetëm këngën dhe vallen, por edhe kostumet e tyre tradicionalë. Më pas, për dy net me radhë konkurrimi do të vazhdojë në Pallatin e Kulturës në Peshkopi.

Oda Dibrane është një veprimtari e nisur si bashkëpunim mes Peshkopisë, si qendër e rëndësishme administrative e kulturore dhe Shoqërive Kulturore artistike të shqiptarëve në Maqedoni. Kjo veprimtari artistike me përmasa mbarëkombëtare zhvillohet në qytetin e Peshkopisë edhe për arsye simbolike. Duke qenë një qytet afër kufijve politikë përfaqëson një trevë lidhëse të kulturës shpirtërore të krahinave të ndryshme, u krijon mundësinë grupeve të mbajnë gjallë këngën dhe vallen shqipe që të mos e harrojnë atë.

Që në fillimet e veta të para, ky bashkëpunim ishte shumë i rëndësishëm. Peshkopia krijonte mundësinë për organizimin e një evenimenti të madh kulturor, duke tentuar ta kthente qytetin në një pikë referimi për grupet artistike të shqiptarëve matanë kufijve me mundësi të pakta për një jetë aktive.

ODA, QËLLIMET DHE PËRFITIMET

Festivali ka për qëllim të bashkojë artistët shqiptarë kudo që ndodhen, pavarësisht kufijve, me idenë që "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e "Odës Shqiptare", me një origjinalitet që synon të rizgjojë vlerat e papërsëritshme të kulturës dibrane. Ky festival, i kthyer tashmë ne traditë, veç të gjithash, rrit në Dibër turizmin kulturor, të mbuluar prej vitesh nga pluhuri i harresës.

Oda dibrane simbolizon dhomën e pritjes dhe përcjelljes së mikut, është simbol i mbajtjes së besës dhe bujarisë, trimërisë dhe qëndrueshmërisë, aty ku bëheshin kuvende, shkruheshin kanune, ndaheshin gëzime e hidhërime, aty ku këndonte dasma e qante morti. Aty ku mençuria ishte ulur këmbëkryq, ku ironia nxirrte në pah mençurinë e pamatë dibrane. Jo më kot ka mbetur një fjalë e urtë dibrane, së cilës i tremben të gjithë ato që s'e njohin Dibrën: "Kur të shkosh në odën dibrane, merr më vete një metër, një kandar dhe një kunj". Natyrë e tillë i është dhënë pak a shumë dhe festivali, ndaj konkurrentët vijnë të përgatitur mirë.

Veli Vraniçi thotë se Oda Dibrane ka pasur disa objektiva dhe qëllime, dhe në këtë edicion, mund të themi se një pjesë e tyre janë realizuar..

"Festivali mbarëkombëtar "ODA DIBRANE" si qëllim të parë kishte të bashkonte artistët shqiptarë, pavarësisht nga kufijtë në një "odë", me idenë se "ODA DIBRANE" do të jetë mikpritëse e "ODËS SHQIPTARE".", thotë Vraniçi. "Oda kishte qëllim të ishte një takim specifik,origjinal në llojin e vet jo vetëm në Shqipëri, por dhe më gjerë. Të ishte takim i këngës dhe valles popullore humoristike, ritit, lojërave popullore dhe alegorisë. Qëllimi i tij ishte t'i rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, t'i sjellë në kohë dhe t'i bëjë të asimilueshme për shikuesit".

Në këtë festival paraqiten rite të lashta si dhe vegla karakteristike muzikore. Ky festival krijon mundësinë për një rizbulim të tyre.

"Ky festival të ishte festival i traditës dhe, duke qenë i përvitshëm, t'u japë mundësi grupeve dhe



Ditët e Odës Dibrane sjellin në qytet një festë të jashtëzakonshme. Këtë tetor, në odën dibrane janë grupe grupet folklorike jo vetëm nga vendi, por edhe nga Kosova dhe Maqedonia, Shqipërisë, duke sjellë me vete copëza folklorike të krahinave përkatëse...

trevave të ndryshme të kërkojnë, zbulojnë dhe paraqesin vlerat karakteristike të tyre në këtë fushë", thotë Drejtori Artistik i Festivalit.

"Festivali gjallëron jetën kulturore dhe artistike në qytetin e Peshkopisë, si një qytet me infrastrukturë dhe jetë të gjallë kulturore të spikatur. Në këtë kuptim përfitues do të ishin vetë qytetarët dibranë që u krijohet mundësia të shijojnë këtë pasuri të pafund të kulturës kombëtare", thekson ai.

Për sa i përket përfitimeve që vijnë nga ky festival, Vraniçi thotë se "janë grupet dhe shoqëritë kulturore artistike të shqiptarëve matanë kufijve, që në kuadër të pjesëmarrjes në këtë festival mbajnë gjallë dhe ruajnë traditat e folkut popullor të zonës. Por, përfitimi më i madhe është shkëmbimi i vlerave kulturore, zakoneve, traditave dhe krahasimi i tyre nga studiuesit dhe vetë artistët popullorë, që në një farë mënyre ritregojnë lashtësinë e popujve të tyre. Arti miqëson njerëzit e vëllazëron zemrat. Si rrjedhoje, ky komunikim me këngë e valle do të ishte përfitimi më i madh në marrëdhëniet mes njeri-tjetrit.

Vraniçi vlerëson edhe punën e bashkëpunëtorëve dhe donatorëve të festivalit, pa të cilët ky festival rrezikohej të organizohej çdo vit.

"Arti ka një veçori. Asgjë nuk realizohet vetëm. Bazë ka punën kolektive. Çdo krijim apo aktivitet kërkon mundin e djersen e shumë artistëve, specialistëve e bashkëpunëtorëve. Edhe festivali Oda Dibrane kërkon angazhimin e shumë njerëzve. Për hir të së vërtetës ky aktivitet ka patur magjinë të mbledhë ajkën e artistëve e specialistëve dibranë, shqiptarë, të shqiptarëve të Maqedonisë e Kosovës, e më gjere", thekson ai.

Vlerësime për Festivalin

"Ky festival përmbledh mikpritjen dibrane, përmbledh bujarinë dibrane, përmbledh kulturën e lartë dibrane, përmbledh njerëzit e palodhur të kulturës nga Dibra, por dhe nga krahina e qytete të tjera të vendit.

Në një vlerësim të tij për festivalin, Bujar Leskaj, ish ministër i Kulturës, thotë: "Ky aktivitet është i veçantë, jo vetëm se është unik, por ky aktivitet është një model se si duhet të zhvillohet dhe në qytete e në krahina të tjera të veçanta, duke marrë specifika të caktuar të kulturës tonë kombëtare. Kultura jonë kombëtare, pasuritë e kulturës tonë kombëtare janë si pasuritë e një deti të pafund, janë pasuritë e një lumi të rrëmbyer, janë pasuritë e maleve, të fushave tona, janë pasuritë e atyre njerëzve që kanë lëvruar me sukses në vite e vite, çka na bën ne të ndjehemi shqiptarë, por do të përmendja me një përkushtim, me një veneracion të veçantë ata artistë popullorë, të cilët në këto 20-25 vite të vështira tranzicioni, kanë ditur ta lëvrojnë, ta kultivojnë, ta mbrojnë e të japin mesazhe të qarta për krejt brezin e ri", thekson ai.

Prof. Zef Çoba, kompozitor i njohur, shkruan në një vlerësim të tij për Odën, se ajo "në shkallë kombëtare pasuron me origjinalitet larminë e evenimenteve artistike që zhvillohen në vendin tonë, duke evidentuar pasurinë e botës së madhe shpirtërore e artistike, mendimin kombëtar të farkëtuar në kudhrën e historisë që ka kaluar vendi dhe populli ynë, në rrjedhjen e viteve e të shekujve.

Oda bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë e studiues nga të gjitha trevat shqiptare, për të promovuar brenda profilit të "Odës Dibrane" një mozaik të pasur, vlerat më të zgjedhura e origjinale të trashëgimisë kulturoro – artistike, folklorike. Oda pasuron jetën kulturore - artistike të qytetit të Peshkopisë, duke argëtuar publikun e nderuar dhe duke edukuar brezat e rinj me thellësinë e mendimit të "shkollës së Dibrës", mikpritjes e bujarisë, artit fin të fjalës, të këngës e të valles dibrane.

"Oda dibrane tashmë është bërë sinonim i pasurisë shpirtërore të një kombi të tërë, shkruan

Arian Sukniqi, koreograf. Padyshim që ky është një Festival shumë origjinal në llojin e vet, i cili ndër të tjera ka synuar dhe synon të rizgjojë edhe vlerat e papërsëritshme të trashëgimisë sonë shpirtërore, duke paraqitur rite të lashta dhe vegla karakteristike muzikore, të mikpritjes tradicionale që dibranët ju bëjnë të ftuarve në odën karakteristike të tyre, si dhe të promovimit të vlerave turistike të qytetit tuaj e zonave për rreth tij, duke e kthyer këtë veprimtari në festë të madhe të kulturës dhe qytetarisë dibrane, por dhe të turizmit kulturor".

"Oda dibrane" është një veprimtari që ka dhënë një kontribut të çmuar për kulturën dhe traditën shqiptare. ajo mbetet një aktivitet me karakter të veçantë Kombëtar në ruajtjen e folklorit dhe transmetimin e mesazhit tek brezat e rinj për rolin dhe rëndësinë e folklorit në identitetin e një kombi, thotë Ermir Dizdari - mjeshtër i madh. Unë kam marrë pjesë shumë herë në këtë veprimtari, duke pasur vlerësimet më të larta, përshtypjet, emocionet, për mënyrën e organizimit, gjeografishtrirjen e grupeve pjesëmarrëse, mikpritjen, korrektësinë, profesionalizmin, prezantimin dhe propagandimin. Në të gjitha këto aspekte "Oda Dibrane" mbetet një visar në gjerdanin e artë të folklorit dhe të përhapjes së kulturës shqiptare", - shkruan Dizdari një vit më parë, me rastin e 20 vjetorit të festivalit.

Korresp. Rr. Arbërit

Shënim: Një raport special për zhvillimin e kësaj veprimtarie do t'ju njohim në numrat e ardhshëm.

Agron TUFA - Poezi



KAFSHA APO FANTAZMA?

Është pjesa ime e kafshës që më mban njeri.
Nuk rrojmë si hije këtij dheu
ndonëse hije kthehemi. Herëdokur...
Prej së tërës nuk vdes vetëm pjesa,
ai substrat fluid që shumëzohet me spore
n'eterin hakërryes të një kujtese përndjekëse.
Kështu do t'i bartim n'amëshim,
                në disqe fluturuese
fantazmat ngashënjyese të pengjeve.

Djaloshi që ka nis me u ba engjëll
s'është pos se mitra e një varri të ardhshëm ajror
me një ushtri fantazmash kryengritëse.
Herët a vonë, ata do shpërthejnë,
ata do mësyjnë
me babëzinë dhe urinë
për hajet e harlisura tokësore.
Mua më mban njeri pjesa ime e kafshës.

Tërë jeta ime kalon në shërbim të saj,
si shkabës së përrallës. I vetëm jam
me urinë e kafshës përbrenda, rrethuar
prej hordhive inkuizitive të moralit
që sokëllin, kërcënon. Nganjëherë
hordhia më avitet miqësisht. Më ofron
shkopin dhe kulaçin. Hera-herë ia dal
t'ia shuaj urinë Kafshës (atëbotë
fundërroj në një paqe fashitëse,
sikur prej meje sapo janë shkarkuar
tonelata zhavorri të zi). Po kafsha
zgjohet prore me një uri të re. Therëse.
Pickuese. Kërkon ekzistencë të paqtë
nën shantazh. Kërkon të veproj. Ia zë
frymën, gojën e çapëlyer, shkep mish nga vetja-
tërë Pemën e Dijes e rrëzoj përtokë...
Mandej vjen vakti i pijeve: verëra të rubinta,
nektar, ambroz... Mandej, prapë,
me ninulla që çelin si farëra dykotiledone
e vë sërish kafshën në gjumë. Kështu
i jap vetes kohë me u gatitë kur kafsha të zgjohet.

Po kur mor Zot do të lodhet,
të bjerë e alivanosur, në ditët e saj të mbrame
kafsha
e tok me të dhe unë?
O, deri atëherë,
gjallë kanë me ma ngrënë zotin dyshimet...

Po sikur unë të vdes dhe kafsha të mbijetojë -
kush do ta ushqejë kafshën e gjorë?
Po sikur të vdesë kafsha,
a do t'ia dal vallë me ushqye
një lukuni të babëzitun me fantazma?
Ku mendohesh kaq gjatë, ngatërrohen të tana
dhe vesh s'ke me e marrë: kush të mban njeri -
kafsha apo fantazma?

qershor 2013

KLLAPIA E JETËS NË KLLAPA

I

Çfarë nevoje, çfarë trysnie na shtrëngon
t'i ikim klimës së shpirtit tonë?
I kemi ikur njëherë... i kemi ikur gjithmonë
duke e shpërngulur veten larg nga ajo zonë,
nga droja se do t'na mpijë përfytyrimin...
dhe kjo ka ngjarë (pak a shumë) me thëllimin
e një mëngjesi të përgjumur, kur vetveten
e kapëm përshkitazi me vdekjen dhe mbetëm
me depon e akullit, që s'ka stinë ta shkrijë,
ndërsa vdekja çau tutje - flaurì,
me cijatjen e fortë të gomave në asfaltin e lagur,
si të zhvoshkte vrazhdë pasthirrmën e zvargur:
"O Zot...!". Mandej, e rrokëm të tërën me gjithsej;
kuptuam se s'jemi veç frigoriferë të mëdhej...
frigoriferë, që zhvendosemi nëpër fasha urbane
në legjenden e stinëve që mashtrojnë ksoane.

II

Veç prekja me vdekjen s'e nxori dot huq
mëllenjën në degë, semaforin e kuq,
realitetin me shtresa alibish të trasha -
tërë jetën tonë të ndryrë në kllapa.
Nuk rritemi ne! Kilometrazhi ynë rritet,
i një jete në koma, që s'e përmendin vitet,
si një fjali viskoze e derdhur në dyll,
që shpesh dhe kllapën nuk arrin ta mbyllë...
E kotë domethënia... nuk gjendet shkencë
të kapë pezullitë mbi retiçencë...
Mbretëron hamendja... fillimi i një fraze,
premtim për vazhdim, kjarim i një faze
që nxiton të mbytet në amullin' e vet
dhe tërë terr' i botës brenda kllapash zbret.
Ç'kuptim kemi bartur? Frigoriferë shëtitës...!
Kur vdekja në sup, me terrin përndritës
na ceku në rrënjët e fryta-tuberozë -
cit alibi e ëndrra... cila narkozë
na kishte mpirë aq, sa vetë amshimi
prej nesh më nuk shkepi asnjë xixë kuptimi?
E largët ajo kohë... e largët, si në mite,
si fidani i brishtë kur sefte nxori sythe
dhe sytë nuk ia shqitëm, derisa shpërtheu
në lule e fruta, që i kalbi dheu...
Por vrapi i kohës kapërcyer paska
mbi ne, që u rrekëm, ngujuar në kllapa
dhe tani, pa shih: si mysafir i vonë
degët po trokasin në dritaren tonë...

Vallë ku kemi qenë? Tërë kohës brenda
mallkuar në kllapat që hapte axhenda,
në kllapa të rrumbullta, në kllapa katrore,
në rrathë viciozë, lëvizje rrethore,
në rrethrrotullim, tek i fshinim gjurmët
obsesionit tonë - mendimit të ngulmët -
zinxhirit të fakteve, bojës së përvojave,
dikush rob i shkaqeve, dikush i pasojave...

28 shkurt 2014

MARSHI I VDEKJES

Ky vend popullohet më shumë me të vdekur;
Me të vdekur të lashtë, me të vdekur të rinj:
Janë të vdekur qytetesh me brengë të thekur-
Dhe të vdekur fusharakë e të vdekur - barinj.
Një popull të vdekurish gëlon kësoane;
Të vdekur qyshkuri, të vdekur tani...
Çfarë i mban gjallë vallë, çfarë kambane
I mbledh dhe i derdh nëpër rrugë mizëri?
Të vdekurit ngatërrohen pa prâ midis vedit...
Po kush këtë makth do mundë ta zgjidhë vallë?
Vdes ngapak dhe shpresa tek të vdekurit e shtetit -
Më shumë gjysmëvdekur, se sa gjysmëgjallë.
Të vdekurit e lashtë nuk gjejnë dot paqe
Nga të vdekurit mbi dhe, që ngrenë pallate
Mbi eshtra fëmijësh, mbi plazmën e ardhme,
Mbi truallin që zhytet përditë në mëkate.
Dhe ngrenë rebelimin të vdekurit e vjetër,
Braktisin qimitret, mallkojnë me tërbim
Të vdekurit e rinj, bastardë, kokëngjeshur,
Dhe kthehen qimitresh të pangushëllim.
Ky marsh i të vdekurve nuk paska të sosur,
Me shenjat e tyre, me këngët, me shkrimet,
Që shuhen, rishkruhen dhe mbesin vulosur
Prej bëmave të tyre, gjithsej, vetëm krimet...

Të vdekurit tanë, s'e dinë që kanë vdekur
Dhe s'gjendet i gjallë vdekësinë t'u provojë;
Kësoane të gjallët kanë ngrirë të mekur
Nën grushtin e vdekjes që kthen në rrënojë
Lotët, kujtimet, atë shpresë të pakët
Që gjallë mbet dëshirash në urna, saksi...
Të gjallët tash janë, ah, kurme të vakët
Kufomash të gjalla, nxjerrë në liri...

AUDIENCA

Në paradhomë, tej yjesh, atje, në paradhomë,
në pjatat e porcelanta polare,
cullak prita engjëjt, dhe mora një ftohmë
në pritje të engjëjve... që nuk erdhën fare.
Mes lëngate më lanë të pres në amshim...
Po ky shpirt që doli, s'ka më trup të dytë,
andaj zgjat lëngata... agoni pambarim,
me sytë ngrirë pezull në infinit...
Këtë gjendje ndërmjeti s'e kisha përfytyruar;
kujt ndodhur s'i ka, po as mua më parë;
me ç'përvojë të re më paskan ndëshkuar
ngecur midis kllapash në itinerar?

04. 02. 2014

JUBILARE

Vjet pesëmbëdhjetë më parë, çoi Zoti një ag
që rrëshkiti si gjarpër prej trupit tim -
sall lëkurën duke më lënë peng - lëkurën,
të tillë, të thatë, elastike -
lëkurë gjarpri pothuaj...
Dërrmuar nga festa
e fundvitit, qyteti qe shndërruar në varrezë.
E prej një varreze të tillë mora rrugët me ag
përmes lagjesh, si katastrofa të një lufte kimike;
as zhurma, as makina, as qen e as mace -
përshkova sheshe të zbrazëta pa frymë të gjallë
me ndjesinë e pashqitshme, se isha i mbijetuari i fundit.
Por kohë më vonë, nga skaji tjetër i një ure
u dha përballë e mbijetuara tjetër: femra
që kisha adhuruar, që kisha blasfemuar
me vite e vite, e sigurisht, veçse në ëndërrime...
"Ah, sa skematike, o Zot! U takuam në mes të urës" - tha,
dhe i buzëqeshën bishtat e syve. S'kishte mbetur tjetër,
veç të përqafoheshim me sozinë time të mbijetuar.
Ajo vinte nga skaji tjetër i qytetit dhe ashtu si unë,
nuk kishte ndeshur as kafshë, as makina, as frymë njeriu...
Ishim të ngazëllyer, si prej një triumfi të përbashkët.
"Shenjë e mirë - tha - me njeriun e parë që takon
ditën e parë të vitit. A mos kjo diç do të thotë?"
"Kush po e pengon, - thashë, - kush po e pengon të thotë..."
Ecëm përdore, duke e lënë pas qytetin, si një varrezë
që priste të shpërgjumte fantazmat. Më saktë,
ia mbajtëm drejt pyllit të mumosur, tek liqeni.
Në mol u puthëm, pa demonstruar virtuozitet.
Derisa lindi dielli. Mandej u kthyem në qytet
të pinim kafe me fantazmat, që tash e parë, e kishin
populluar gjallërisht varrezën e tyre të zhurmshme.
Mandej, si mendoni ju? U ndamë! U harruam!
Nuk e di pse e humba atë femër.
Nuk e di pse s'e vazhdova magjinë.
Nuk e di as ku gjendet ajo tani...
Me kë? Çfarë po bën? Pse s'më kërkoi?

Po për vete ndjej një peshë dheu mbi shpinë.

31 dhjetor 2013

miniature

Shkrimtari i fshatit tonë

Asokohe më pati përpirë kureshtja për shkrimtarin e fshatit tonë. Nuk kishte botuar ndonjë libër dhe, me sa duket, as kishte për të botuar ndonjëherë, sepse i përkiste një shtrese të deklasuar. Kjo shpjegonte gjithçka, por fakti që nuk kishin për t'i botuar kurrë, nuk e shkurajonte shkrimtarin tonë: ai shkruantë, siç thoshnin, vazhdimisht. E kjo ma ndizte edhe më fort imagjinatën, ndaj nuk ngopesha duke e parë... jo atë vetë, por më saktë, diç që fshihej përtej tij, apo më saktë - përthellë tij. Kishte dy sy të kaltër, tepër të mëdhenj, të mos themi të shqyer (nga habia a nga ndonjë ndjenjë tjetër), një trup të lidhur, shpatullgjerë, krahë leshatakë e muskulozë, a thua ta kishte gdhendur vetë Mikelanxhelo, ndërsa flokët, të verdha e me krrela si susta, i rrinin mbi kokë si brerore. E mban mend gjithë fshati çfarë tmerri shtinë vikamat e hakërrimat e ndërkryera të tij kur deshën t'ia qethnin me përdhunë atë kurorë kaçurrelash! Të shokuar, grupi i "të fortëve" që ia mbërriti pas propagandës fshatçe mbi shfaqjet e huaja, u shpërnda si tufë zhgabash kur pret të cofë ndonjë kafshë e plagosur.

- Epo lëre halenë, t'i mbajë vakëf, gjersa ta tërheqin rrëshqanë në Degën e Punëve të Brendshme! – tha sekretari i Partisë, një meit i mbaruar me emrin e shkurtuar "shoku Kuk".

Nuk e dinim me saktësi se çfarë shkruan shkrimtari ynë, Kiu, dhe shumë vonë mësova se emrin e kishte Haki. Kur u martua, Kiu ndërtoi një shtëpi përtrollëz me qerpiçë prej balte, disi të shmangur nga lagjja dhe shpinëkthyer fshatit. Natyrisht, shtëpinë e tij e rrethoi me gardhe të dyfishta me thupra të larta e tela, mbolli pemë në oborr dhe hapi vetë një pus. Për një farë kohe arrita të jem ndër të vetmit që lidha nja dy fije të kalbëta miqësie me Kiun, por s'ma mbante të rrija shumë gjatë vetëm për vetëm me të: sytë e tij shndrisin prej njëfarë etheje të kaltër çmendurie, bëheshin të lëngshëm nga lot djegës, por shumë shpejt ndërronin, zbuteshin, madje edhe qeshte, duke shpaluar ca dhëmbë të fortë, të mëdhenj e të rregullt, si krëhera fishekësh.

Kiu dilte rregullisht në punë bashkë me nusen e tij të re, të ardhur nga një fshat e i largët midis Dibrës dhe Kukësit, nga një familje e prekur. Gjithmonë punonin bashkë dhe gjithmonë dilnin e ktheheshin bashkë në shtëpi, gjerkur do t'i lindnin njëri pas tjetrit fëmijtë dhe Kiu të dilte në kooperativë i vetmuar, i heshtur, si një jetim. Shumë pak kujt i jepej të ndërronte ndonjë bisedë të sipërfaqshme me Kiun, edhe në ato raste, e kam ndjerë se njerëzit që shtyheshin t'i flisnin, e bënin jo nga dëshira, por o nga kureshtja e kontaktit me një të çmendur, o nga dëshira perverse për t'u tallur, sikundër kishte dhe raste që e provokonin të fliste kundra Partisë. Por, siç e thamë, Kiu ishte shkrimtar dhe nuk ua zgjaste shumë, duke u thënë shkurt: "Hajt, thyeni qafën, injorantë, hafije! S'ia ka kujt nevojën Kiu, atij i mjafton vetvetja".

E mbaj mend se si kthehej i rraskapitur nga puna bashkë me të shoqen dhe e imagjinoj tani sfidën që i bënte ai njerëzisë. Pas një dië ditë të rëndë pune, për shembull, prashitje misri ku norma me kultivator ishte 800 m katror dhe pa kultivator – 400 m. Në pushimin e drekës, pasi lahej e freskohej ndanë pusit, ndërsa gruas së tij i binte bretku duke u marrë me punë të ndryshme shtëpi, Kiu-shkrimtar, tërhiqej si një viç i ngazëllyer në njërën nga dhomat e posaçme dhe merrej me krijimtari.

Kështu bënte pranverës, verës, vjeshtës dhe akoma më fort kur zinte dëbora e dimrit. Ne gjithnjë, sa shihnim tymtarin e çatisë në shtëpinë e veçuar të të tij, thoshim: "Ja dhe Kiu atje... ndërsa ne luajmë futboll, ai shkruan". Po çfarë shkruante shkrimtari ynë, i tërhequr në shmang nga njerëzia? Për inat të kujt? Shumë kohë kam ëndërruar se Kiu i mbyllur po bënte hatanë, se njerëzit e fshatit tonë të madh do të krenoheshin me të, lapangjozët e provokatorët të plasnin nga zilia, ndërsa të tjerë që e kishin nënvleftësuar Kiun, do të vinin t'i binin ndër këmbë duke derdhur lotë të nxehtë pendimi mbi çizmet e tij të përbaltura. Dukej se heroi im shkrimtar as ia kishte ngenë se ç'mendonin të tjerët për të. Njëherë, teksa brigada e tij po hapte një kanal ujësjellësi, iu turr brigadierit me lopatë në dorë, deri sa e zuri dhe këputi në dru, duke shfryrë: "Mos guxo të marrësh nëpër gojë të parët e mi, ti, dhëmbëkrimbur, se s'ka kandar që na barabit me racën tuaj. Unë jam shkrimtar, kurse ti – qelbanik!"

Shumë kohë më vonë, familja e shkrimtarit u shpërngul, si shumë familje të tjera, por nuk qeshë interesuar se ku ishin zhvendosur. Ndoshta kishin emigruar në ndonjë shtet perëndimor tek të afërmit e arratisur.

Megjithatë rasti do ta sillte disa vite më parë, të njihesha me një "kryevepër" të Kiut. Në një shtëpi botuese jo aq të njohur, më dhuruan një libër voluminoz me autorësinë e tij, me titull të çuditshëm: *"Kryqi, Kuku dhe Kukura"*. E hapa librin sa ktheva në shtëpi, i përfshirë nga një mister i lashtë që s'më kishte lëshuar gjithë jetës. Libri ishte historik dhe përfshinte një periudhë trembëdhjetëmijë vjet para Krishtit gjer në ditët tona. Ishte një libër për fisin e tij. Po ç'mund të thoshte shkrimtari ynë Kiu për një periudhë aq të errët? Kiu vetëm me tetëvjeçare? Kiu që nuk lexonte libra? Ndërsa lexoja paragrafët, faqet, kapitujt e atij libri të vëllimshëm, mendja bridhte paralel në vitet e një varfërie dhe rraskapitjeje të madhe kur Kiu, si një luan i plagosur, tërhiqej në strofkë dhe merrej me lëpirjen e plagëve të veta. Shkruante duke iu kundërvënë gjithë njerëzisë jashtë derës së tij, hymnizonte fisin e vet të lavdishëm me bëmat e një kohe të parrokshme nga asnjë kujtesë, krijonte identitetin e tij, të ndryshëm nga masa prozaike e fshatarëve dinakë. Ja si e realizonte kundërvënien e madhe shkrimtari i fshatit tonë, Kiu, i mbyllur me vite të gjata në dhomën e tij, pas një pune rraskapitëse në kooperativë:


"...Kur erdhi në këto vise i pari i fisit tonë, Kuku, ka qenë viti 13000 para Krishtit (lëvdue qoftë!). Pati kaluar një fëmijëri jetime qysh kërthi, i braktisur nga prindër e të afërm, pasi në atë vis të Trakisë kishte kaluar një nga fiset e forta hetite dhe pati shuar me zjarr e hekur gjithë çfarë gjallonte asaj ane. Fëmija ishte më pak se dy vjeç dhe duke kërkuar bar e rrënjë për ushqim, u fut thellë në pyll. Një ditë drejt tij u avit një arushë e vogël, si një topth leshi. Kuku e përqafoi, ndërsa arusha e vogël e lëpiu në fytyrë. Gjithë paradites ata lozën bashkë, gjersa i zuri gjumi të përqafuar në lëndinë. Në mbrëmje ai e pa veten në një shpellë, duke ndjerë mbi vete vështrimin e dy syve të butë e të dhembshur. Ishte e ëma e arushës së vogël. Gjatë gjithë asaj vere e vjeshte, arusha e madhe e ushqeu Kukun me qumështin e saj, e rriti njësoj si këlyshin e vet. Kështu u rrit Kuku, mes natyrës së pakufi me mëmë-arushën dhe motër – arushën e vogël, gjersa një ditë, zëri i të parëve do ta thërriste për ripërtëritjen e genit të shuar. Sa e sa hëna, sa e sa diej këmbeu Kuku në udhëtime të gjata, gjersa mbërriti në një vend të bukur që përshkohej nga një lumë i madh: ishte fusha e Kastriotit. Kuku atëherë ishte dy metër e gjysmë i gjatë dhe me një bri në ballë. Për dy-tre ditë ai arriti të ngrinte kullën më të lartë në atë krahinë, për çka njerëzia erdhën, e përshëndetën dhe i uruan mirëseardhjen, duke e quajtur, për nder të viseve nga vinte, Kuk Traka.

Kuku ishte një njeri me fuqi mbinatyrore dhe një luftëtar i pashoq në trimëri. Thonë se fuqia e mendimeve të tij ishte aq e madhe, sa njerëzit përreth tij shihnin me sy se si shtilleshin përreth kokës së Kukut shiritat e mendimeve. Vendasit ia kishin drojen të ardhurit dhe energjisë së tij të brendshme, prandaj përpiqeshin me sa mund t'i largonin gratë dhe vajzat e tyre kur ndihej se po kalonte andejpari Kuku. Njëherë Kukut i ra rruga të kalojë nga kroi i fshatit. Gratë që mbushin enët dhe lanin u ndanë në dy rreshta për t'i hapur rrugë Kukut. Teksa kalonte midis rreshtave të tyre, Kuku ua shtiu sytë me rend nuseve, grave e vajzave të fshatit, dhe vetëm me atë vështrim, i la të gjitha me barrë...".

Libri vazhdonte në këtë frymë, gjithnjë duke u rënduar me ngjarje që vetëm historike nuk mund të ishin. Në çdo rast tjetër, do të shkulesha se qeshuri, do të zbavitesha jashtëzakonshëm, por, ndryshe nga ç'mund t'i shkaktojë kjo lexuesit të panjohur që nuk e ka njohur shkrimtarin e fshatit tonë, Kiun, unë ndjeva të më shkapetet si një bojë e zezë nëpër gjak, trishtimi. Pikëllimi prej një vepre të tillë, ngase e dija që ishte krijuar në rrethana të caktuara nga një njeri i pashkolluar që i kundërvinte gjithë botës përjashta, shkrimtarin.



AGRON TUFA
Nga hiri i të vdekurve
Ese
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-39-6
Nr. faqeve: 164
Çmimi: 700 lekë




AGRON TUFA
Thembra e Akcilit
Miniatura
Botimet M&B
ISBN: ISBN 978-9928-172-62-4
Nr. faqeve: 208
Çmimi: 800 lekë

Librat e Shaban Sinanit janë të pranishme në Panairin e Librit në Peshkopi në datat 28-31 Tetor, si dhe në Tiranë në Panairin e Librit në datat 11-15 Nëntor. Këto botime janë të Shtëpisë botuese "Naimi"

profil

Një kodik i kodikëve, por edhe i disa kodeve **të Shqiptarisë**





Autori: Shaban Sinani
Titulli: Kodikët kronografikë të Shqipërisë
(Shkrime dhe doreshkrime prej Rilindjes Evropiane deri në Rilindjen Kombëtare)
Botues: "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-109-77-4
Nr. i faqeve: 488
Çmimi: 2000 lekë

Për fat, pikërisht në kohëra të tilla (të vështira) dalin në dritë, pavarësisht se sa të dukshme bëhen, vepra me rëndësi parësore për kulturën dhe dijen e një kombi. Një libër i tillë është ***"Kodikët kronografikë të Shqipërisë"*** (*Shkrime dhe doreshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare*) i profesorit Shaban Sinani, shkencëtar i përkushtuar dhe i pajisur jo vetëm me vullnet të pazakontë, por edhe me një paanësi, të cilën do të duhej t'ia kishin zili, në mos po t'ia përvetësonin mjaft shkencëtarë *tanët*, fqinjë e më tej. Pas një përvoje shumëvjeçare në botën e hulumtimeve shkencore dhe pas mbi dhjetë vitesh punë me librin e mësipërm, kur shtrohet çështja e ecurisë dhe fatit të (dorë)shkrimeve me vlerë, autori e shpreh qartë mendimin e vet: "*Zhvillimet kulturore dhe mendore, edhe në periudhat më të rrepta, i tejkalojnë kufijtë gjeografikë, krahinorë, shtetërorë*".

Lexuesi gjendet para një vepre shkencore shumëplanëshe e të shumëfishtë, që jo vetëm fton, por edhe çon më tej paqen e hershme të paktën ndërballkanike (mes popujsh, gjuhësh, shkencash), dhe mirëkuptimin.

Prof. dr. Shaban Sinani, përkundër vështirësive të panumërta, ka kryer një punë vigane, prej *scrib*-i, duke shmangur natyrshëm konceptin materialist të hulumtimit të historisë dhe të kulturës, me një stil të kthjellët, që nuk mund të keqkuptohet e as të lerë vend për mëdyshje. Ai ka punuar në heshtje dhe përkushtim, njëlloj sikur të mbante një Kodik të Kodikëve të Shqipërisë, ku gjenden të dhëna shpesh vegimtare për Kishën si ruajtëse të Kujtesës, për vendin që zënë letërsia, historia dhe tekstologjia në kulturën e një kombi, për mënyrën si duhen hartuar e zbatuar rregullat e qeverisjes së qyteteve, nenet e vllazërive të tipit esnafor, për historinë se si një komb, shpesh i mbajtur peng mes padijës dhe idealizmit, hyn në Shkrim falë gjuhës së vet - dhe në vëmendjen e botës falë shkrimit, për rolin e pazakontë të Mërgatës në mbrujtjen dhe mbrojtjen e letërsisë, për një riperiodizim të drejtë të kësaj të fundit pas kaq kohësh etj.

Lexuesi gjendet para një vepre shkencore shumëplanëshe e të shumëfishtë, që jo vetëm fton, por edhe çon më tej paqen e hershme të paktën ndërballkanike (mes popujsh, gjuhësh, shkencash), dhe mirëkuptimin. Si ca dijetarë të sprovuar me bojën dhe gjakun e kulturës, faktet nuk bërtasin asnjëherë.

Për fat, pikërisht në kohëra të tilla (të vështira) dalin në dritë, pavarësisht se sa të dukshme bëhen, vepra me rëndësi parësore për kulturën dhe dijen e një kombi. Një libër i tillë është "Kodikët kronografikë të Shqipërisë" (Shkrime dhe doreshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare) i profesorit Shaban Sinani, shkencëtar i përkushtuar dhe i pajisur jo vetëm me vullnet të pazakontë, por edhe me një paanësi, të cilën do të duhej t'ia kishin zili, në mos po t'ia përvetësonin mjaft shkencëtarë tanët, fqinjë e më tej.

Prof. dr. Ardian Kyçyku
Bukuresht, shtator 2014

Libri "Hebrenjtë në Shqipëri - prania dhe shpëtimi" i prof. dr. Shaban Sinanit, botoi "Naimi", Tiranë 2009

Monografia e prof. dr. Shaban Sinanit "Hebrenjtë në Shqipëri-Prania dhe shpëtimi" është dorëzuar për botim në vitin 2008 dhe ka dalë në qarkullim si libër në fillim të vitit 2009. Libri ka karakterin e monografisë shkencore, me referenca në autorë, burime dhe dokumente autentike, shumica të shqiptuara për herë të parë. Monografia pothuaj e ezauron "enigmën" hebreje tek shqiptarët. Për herë të parë sqarohet edhe fati i i hebrenjve të Kosovës apo më saktë qëndrimi i kosovarëve dhe çamëve ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë. Autori tashmë është bërë pikë reference e domosdoshme në literaturën botërore dhe institucionet ndërkombëtare që trajtojnë këtë argument për rajonin e Ballkanit. Padyshim, botimi i këtij libri monografik është një kontribut madhor në kujtesën historike shqiptare.

Autorit i janë dashur afro 10 vjet punë për të realizuar këtë monografi. Libri është rreth 400 faqe.

VLERËSIME PËR LIBRIN

Nga Xhon L. Uidhers, II, Ambasador i SHBA në Shqipëri, datë 27 janar 2010, gazeta Shqip:

"Roli i Shqipërisë për të shpëtuar hebrenjtë nga tmerret e holokaustit nuk është i njohur aq sa meriton... Shqipëria mund të bëjë gjithmonë më shumë për t'i treguar botës historinë e vet të shkëlqyer për të parandaluar persekutimin e hebrenjve në tokën e saj. Disa shqiptarë janë duke bërë pikërisht këtë. Për shembull, Profesor Shaban Sinani. Punimet e tij të shumta dokumentojnë që edhe në vitet më të errëta të holokaustit, në Shqipëri ndodhi një bashkim i të gjitha kaheve politike dhe besimeve fetare – antifashistë dhe profashistë, komunistë dhe nacionalistë, myslimanë dhe të krishterë, besimtarë dhe jobesimtarë – për t'u siguruar që asnjë hebreu të strehuar në Shqipëri nuk do t'i hynte gjemb në këmbë".

Dr. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik, Prishtinë:

(botuar ne gazeten Shqip, 30 janar 2012)

Monografia "Hebrenjtë në Shqipëri - prania dhe shpëtimi" është hedhje drite mbi të vërtetën e plotë, mbi një të vërtetë që, parë në kontekstin e zhvillimeve të kohës, është unike; e cila, përveçse është dokumentuar gjithanshëm, mund të thuhet se, në saje të elokuencës që i karakterizon përgjithësisht shkrimet e Shaban Sinanit, është interpretuar mjeshtërisht. Të dhënat për strehimin dhe përgjithësisht për fatin hebrenjve në Shqipëri janë pothuajse shteruese dhe të mbështetura nga dokumente arkivore. ...Mund të thuhet me gojën plot se autori, me librin e tij, e ka ngritur një monument shkrimor për kombin shqiptar, gurët e të cilit janë dokumentet arkivore dhe të dhënat e përdorura nga burime të ndryshme.

Claire Lavoine, historiane, Paris:

Vepra e titulluar "Hebrenjtë në Shqipëri-Prania dhe shpëtimi" ("Jeës in Albania, the Presence and Salvation") , me autor prof. Shaban Sinanin, studiues, historian e etnolog, na lejon, shumëve prej nesh, të zbulojmë përbërjen dhe praninë historike të komunitetit hebre në këtë vend dhe, gjithashtu, numrin e madh të hebrenjve që gjetën strehë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, në kushtet e pushtimit fashist e nazist, me një histori që nis qysh në fillim të viteve 1930.

Falë dokumenteve të identifikuara nga autori i librit, punës kërkuese të kryer prej tij dhe dëshmive të siguruara, ky studim provon se Shqipëria ishte në atë periudhë i vetmi shtet europian që kishte hapur dyert zyrtarisht për mijëra hebrenj të shtetësive të ndryshme. ...Kopje të dokumenteve të arkivave të shtetit shqiptar u janë dorëzuar nga studiuesi Shaban Sinani autoriteteve të "Memorial Museum of Holocaust" në SHBA. Të dhënat janë autentifikuar nga dr. Vadim Altskan në gusht të vitit 2005.

Duke u mbështetur tek një dokumentacion shumë i detajuar, shpesh i pabotuar ndonjëherë, prof. Shaban Sinani ka dashur dhe tentuar t'u përgjigjet pyetjeve të gjithsecilit, dhe e arrin këtë me ndershmëri, me pasion dhe me bindjet shkencore që e karakterizojnë dhe e nderojnë.

Vepra letrare e Dritëro Agollit në studimet e Shaban Sinanit

"Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit", nga prof. dr. Shaban Sinani, e merr krijimtarinë e Agollit prej gjenezës së saj, e inkuadron atë saktësisht në epokën përkatëse, e shikon atë së brendshmi përmes analizës së imët të tekstit e paratekstit (te romanet), e dimensionon atë në rrafshin historik-krahasues me vëzhgime të sakta kulturologjike e ndërktestuale, i ftillon me sukses rrethanat e mundshme të dimensionimit e të rileximit të këtij autori në rrjedhë të kohës.

Monografia e prof. Sh. Sinanit kushtuar krijimtarisë së pasur të D. Agollit, ndonëse rrok krejt veprën e një krijuesi të palodhur, nga poezitë dhe sprovat e para, deri te drama e tij të rigjetur, është homogjenizuar me një ligjërim të rrjedhshëm.

"*Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit"* është një libër i domosdoshëm për bibliotekat tona shkollore, për punonjësit mësimdhënës dhe nxënësit e arsimit parauniversitar, për studiuesit e angazhuar, në veçanti si dhe për kureshtarët e kultivuar të letërsisë shqipe përgjithësisht. Kjo monografi i kushtohet një prej figurave më të njohura të letërsisë shqipe të gjysmëshekullit të fundit, Dritëro Agollit; figurë qendrore për shkak të krijimtarisë së tij që kap disa dhjetëvjeçarë, krijues i mirënjohur që njeh arritje kulmore thuajse në të gjitha llojet letrare ku është sprovuar, personalitet i spikatur për shkak të angazhimeve të tij të hapura publike.

Një nga studimet më të thelluar mbi romanin e Dritëro Agollit, ai i Shaban Sinanit, arrin të piketojë veçantitë kryesore të romanit "Arka e Djallit". Si fenomen rrezatimi asimetrik,



Shaban Sinani shtron jehonën e censurës dhe autocensurës krijuese në kushtet e diktaturës, - kur në fakt është shkruar romani, vitet '80, dhe në rrethanat e mungesës së saj, censurës, para lexuesve të viteve '90, kur u botua romani...

... Në këtë studim, siç thamë, më i thelli dhe më gjithëpërfshirës ku shtrohen dhe piketohen çështje zhanrore dhe poetika narrative, autori, në mbështetje të rebelimeve kanonike, përkatësisht heterogjenitetit të diskurseve, ngjashëm bie fjala edhe me kryeveprën botërore "Shpirtra të vdekur", vë në pah prurjet që sjell hapja e tillë e poetikës romanore. Ndërfutja e diskursit përsiatës, filozofik e metafizik, eseistik, e trashëgimisë shpirtërore gojore, e traditës së Orientit kulturor e shpirtëror, etj, pra, i padisiplinuar edhe nga perspektiva e ndërtekstualiteteve, përpos që sjell qasje narrative ndryshe në prozën shqipe, por, që është meritë e veçantë, e afron atë me prirjet bashkëkohore të romanit përgjithësisht...


Ndër konstatimet e mprehta, Shaban Sinani do të thotë edhe këtë për romanin "Arka e Djallit": "është i lehtë për ta lexuar por i vështirë për ta analizuar", me çfarë i parasheh atij jetë të gjatë të sigurt. Në fakt është fundi, përkatësisht pjesa e katërt e studimit që nxit, në mënyrë të pashmangshme përsiatje të veçanta. Shaban Sinani në fakt, duke pasur parasysh shumëzëshmërinë, vizionin e romanit, përfshihet nga një shqetësim i përhershëm: "Historia është e prirur për ta fshehur vetveten".

Autori: Shaban Sinani
Titulli: "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit
(Studime dhe analiza për krijimtarinë \ e D. Agollit)
Botues: "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-109-13-2
Nr. i faqeve: 216
Çmimi: 800 lekë

autorë

Xhon L. Uidhers: Punimet e shumta të Shaban Sinanit dokumentojnë që edhe në vitet më të errëta të holokaustit, në Shqipëri ndodhi një bashkim i të gjitha kaheve politike dhe besimeve fetare – antifashistë dhe profashistë, komunistë dhe nacionalistë, myslimanë dhe të krishterë, besimtarë dhe jobesimtarë – për t'u siguruar që asnjë hebreu të strehuar në Shqipëri nuk do t'i hynte gjemb në këmbë".

Zbulohen rrënjët e **etnosit shqiptar**



Etnosi shqiptar dhe eposi shqiptar janë që të dyja kategori parakombëtare, që vijnë prej kohërash shumë të hershme. Koha e formimit të etnosit shqiptar dhe koha e formimit të eposit shqiptar, "gojëdhënës kombëtare", përkojnë jo rastësisht në një kalendar krahasimtar. Studimi ka për qëllim të identifikojë këtë kushtëzim dhe të argumentojë ndikimin e formimit të vetëdijes etnike parashqiptare në krijimin e eposit legjendar shqiptar.

Ndër të tjera, në këtë libër shqyrtohet edhe "institucioni i besës" tek shqiptarët; i pranishëm në eposin legjendar, por edhe në statutet e bashkësive urbane arbërore në periudhën humaniste të fundit të Mesjetës dhe në kodet etnojuridikë të mëvonshëm; tradicionalisht i shërbyer si një albanizëm që u trashëgua si pjesë e identitetit shqiptar dhe në rrjedhë të kohërave u ballkanizua si dukuri dhënëse shqiptare. Certifikimi i një procesi të ndërlikuar psiko-gjuhësor që dëshmohet përgjatë shekujve, proces në të cilin besa rezulton në një shumëkuptimësi të paskajuar (besa si paqe, besa si fe, besa si besim, besa si bekim; besa si kod etik, besa si nyje juridike, besa si shenjë dhe vetëdije fetare etj.) e bën traditën gojore vendëse të paralelizueshme me procesin historik të formimit të popullit shqiptar.

Duke qenë i prirur drejt shtresimeve më të vjetra të epikës legjendare shqiptare, ky studim në një farë mënyre është vazhdim i monografisë "Mitologji në eposin e kreshnikëve" (2000, 2009 bis) dhe i studimeve të përfshira në librat "Kështjella e virtytit" (2001) e "Ura dhe kështjella" (2006), botime këto nga i njëjti autor.

Nga këndvështrimi i lidhjes kushtëzuese historike dhe etnologjike midis etnosit dhe eposit shqiptar shihen shumica e çështjeve të parashtruara në këtë libër, prej atyre të termave dhe emërtimeve, deri tek marrëdhëniet midis disa prej ligjërimeve më të vjetra të shqipes: ligjërimit biblik-ungjillor, ligjërimit etnografik - prozodisë popullore dhe ligjërimit etnojuridik - traditës së ligjeve të pashkruara.

Titulli: Etnos në epos
Autor: Prof. dr. Shaban Sinani
Shtëpia botuese: "Naimi"
Gjinia: Studim monografik
Nr. i faqeve: 240 faqe
Çmimi: 800 lekë/ 8 euro
ISBN: 978-9928-109-02-6

Letërsia në totalitarizëm dhe "Dosja" **e plotë për Kadarenë**

"*Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K."*, botimet "Naimi", është botimi i ri i plotësuar me dokumente e analiza të reja për veprën e shkrimtarit më të madh shqiptar I. Kadare, pasi kaluan afro 10 vjet nga botimi i vjetër nën titullin "*Një dosje për Kadarenë*" (Tiranë 2005).

Ky botim i ri u bë i nevojshëm për shkak se kishin dalë disa dokumente të reja dhe nga lexuesit e opinioni pati kërkesa që dokumentet të botoheshin të plota. Në gjendjen e re libri përmban dy pjesë. Në pjesën e parë botohet monografia "*Letërsia në totalitarizëm: I. Kadare*", një studim i nisur dhe i kryer si projekt shkencor, që ka për qëllim të paraqesë kushtëzimin kontekstual të letërsisë në shoqëritë e mbyllura, përmes rastit më të diskutueshëm gjatë dy dekadave të fundme, letërsisë së Ismail Kadaresë. Në këtë diskutim janë përfshirë dhe studiues të huaj, historianë të "*luftës së ftohtë*" dhe të totalitarizmit, përkthyes të veprës së shkrimtarit, albanologë. Studimet letrare, sido që për nga natyra dhe metodat bashkëkohore janë gjithnjë e më tekstocentriste, kur është fjala për letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, qoftë në Shqipërinë shtetërore, qoftë në Kosovë, nuk i shmangen dot kontekstit historik.

Në pjesën e dytë botohen dokumentet, të pajisura me shenjime informuese të saktësuara e të plotësuara, si dhe me referencat e burimit arkivistik, që lejojnë e lehtësojnë shfrytëzimin e tyre prej cilitdo që është i interesuar për një njohje të drejtpërdrejtë të tyre. Në këtë botim janë shtuar afërsisht 15 dokumente të reja, të cilat në kohën e botimit të parë e të dytë ishin ende nën kufizimet e Ligjit 9154 "*Për Arkivat*" ose nuk ishin identifikuar në procesin kërkimor. Nga dokumentet, nuk është hequr a shkurtuar asnjë prej atyre që kishin koleksionit të dy botimeve të para. Midis dokumenteve të shtuara, dy letra të M. Shehut për E. Hoxhën, që botohen në këtë



libër për herë të parë, janë me rëndësi parësore për të kuptuar raportet e shkrimtarit me pushtetet dhe sidomos për të verifikuar konceptin për letërsinë si çështje shtetërore.

Duke qenë një botim i llojit *dossier*, nuk është përzgjedhur a përjashtuar asnjë dokument i zbuluar dhe ndonjëherë botimi i tyre përmban edhe fragmente që s'lidhen drejtpërdrejt me argumentin e këtij libri, por thjesht përjashtojnë paragjykimet. Po ashtu, duke qenë se gjatë dy dekadave të fundme janë bërë shumë debate për vërtetësinë a pavërtetësinë e paraqitjes publike të bashkëbisedimit/debatit të intelektualëve shqiptarë në takimin me R. Alinë në gusht të vitit 1990 (në atë kohë kryetar i shtetit shqiptar), në përbërje të këtij libri botohet për herë të parë në tërësi pjesa e debateve Kadare-Alia, shoqëruar me referenca të sakta kronografike në fonodokumentin origjinal që ruhet në dy pjesë në formatimin CD në rrjetin arkivor kombëtar.

Në botimin e ri u gjykua me vend që të vihen emrat e plotë të hartuesve dhe nënshkruesve të dokumenteve, për atë pjesë që në botimet e mëpërparshme kishin mbetur të identifikuar vetëm me nistore (iniciale), kryesisht për arsye etike. Në dy botimet e mëhershme u quajt me vend "kursimi" i tyre, si një e drejtë e fundme morale që hartuesit të dokumentit t'i jepet një kohë dhe mundësi ta shpallë vetë autorësinë dhe të përligjë qëndrimet e mbajtura ose të përgjigjet për to. Botimi i dokumenteve me nënshkrimet e plota të autorëve do të dëshmojë shkallën e paimagjinueshme të demonizimit të shkrimtarit prej shkrimtarit gjatë periudhës totalitare; si dhe mund të ndikojë për mirë në debatet që hapen e rihapen në formë fushatash për qëndrimin ndaj fshehtësive të arkivave dhe sidomos ndaj dosjeve të policisë së fshehtë politike.


Autori: Shaban Sinani
Titulli: "Letërsia në totalitarizëm" dhe "Dossier K."
Gjinia: *Studim monografik dhe dokumente*
Botues (2011): "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-109-09-5
Nr. i faqeve: 480.
Çmimi: 1000 lekë

Tradita gojore si etnotekst - studime për etno-folkloristikë krahasimtare"

Të tre librat e prof. Shaban Sinanit: "Mitologji në eposin e kreshnikëve", "Etnos në epos" dhe tashmë "Tradita gojore si etnotekst" (botimet "Naimi") janë një triptik mbi rrënjët e etnosit shqiptar, duke dhuruar kështu një korpus të dhënash, informatash, dëshmish, kodesh të etnosit e kulturës shqiptare, të cilat zbardhen, analizohen, krahasohen dhe zbërthehen dhe formësojnë në konkluzion vetëdijen mbi origjinën dhe identitetin kombëtar të iliro-arbër-shqiptarëve, madje duke e bërë këtë përdallim, dhe kjo e bën shumë interesant kërkimin e tij shkencor, përmes krahasimit me etnoset e tjerë në Ballkan e më gjerë.

Nuk është nevoja për t'u munduar shumë për ta shpjeguar këtë vlerë të librit. Si çdo vepër e këtij autori, për shkak të qartësisë që i jep kompetenca e lartë profesionale në fushën përkatëse, lënda e ofruar përftohet dhe thithet me lehtësi. Do të mjaftonte vetëm disa nga titujt e përmbajtjes së lëndës së librit "Tradita gojore si etnotekst- studime për etno-folkloristikë krahasimtare" për të nxjerrë edhe vlerat e tij:

1. "Great Code" në traditën gojore popullore shqiptare
2. Ligjërimi ungjillor dhe kodet etnojuridikë të shqiptarëve
3. Prania kulturore hebraike në traditën shqiptare
4. Eposi shqiptar dhe eposi pers: vështrim krahasues
5. Nga fqinjësia apo prejardhja: rreth bashkëpërkimeve ndërballkanike
6. Etnonimet e tjetrit në eposin shqiptar
7. Eposi i shqiptarëve dhe eposi i sllavëve të jugut: vështrim krahasues përmes emërtimeve
8. Qyprillinjtë në eposin shqiptar dhe në eposin boshnjak
13. Folklori shqiptar në vështrimin e të huajve
14. Eurokultura dhe identiteti europian i shqiptarëve



Autori: Shaban Sinani
Titulli: Tradita gojore si etnotekst: studime për etno-folkloristikë krahasimtare
Gjinia: Studim monografik
Botues: "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-109-22-4
Nr. i faqeve: 372
Çmimi: 1000 lekë.

Krahasimet e traditës gojore, në atë shkallë sa ekzistonin para botimit të këtij libri, kanë pasur si pikë reference kryesisht kulturat klasike greke e romake, si dhe folklorin e popujve të sllavëve të jugut. Mungonin vështrimet krahasuese për kultura të tjera të mëdha të antikitetit, si ajo hebraike dhe perse. Mungonin po aq krahasimet me mitologjinë biblike dhe ligjërimin ungjillor. Nuk kishim krahasime të traditave gojore të popullsive pakicë kulturore në Shqipëri, qoftë dhe në pikëpamje të dallimeve etnotipike (popullsi ndenjëtare - popullsi shtegimtare: rasti i folklorit të romëve); qoftë në pikëpamjen e identifikimit historik të vetes (sllavët e Prespës, grupime sllavishtfolësish të tjerë); qoftë në pikëpamje të hierarkive kulturore (rasti i bashkësive dygjuhëshe, si Himara); qoftë në pikëpamje të rolit homogjenizues - heterogjenizues të dukurisë.

Krahasimi i dukurive etnofolklorike përbën një interesim prej më se dy dekadash në kërkimet e prof. Shaban Sinanit. Duke ditur se ka qenë në traditën e shkollës shqiptare të albanologjisë njohja dhe studimi i traditave gojore të popujve fqinje, me sa duket qëllimisht, autori ofron me shumicë informacion dhe bibliografi, në mënyrë që pak a shumë libri të shërbejë jo vetëm për njohje e informim, edhe për të aftësuar e nxitur kërkimin e lirë. Gjithashtu kjo është arsyeja pse shumë emërtime, terma, idioma lehtësisht të receptueshme, janë dhënë dhe në gjuhët dhe alfabetet e burimit.

E di ti si është krijuar bota? Më parë ishte Adami. Pastaj erdhi Eva. Pastaj erdhën fëmijët. Pastaj fëmijët e fëmijëve të tyre. pastaj fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të tyre.... fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve...
Pastaj erdhi dikush dhe ua vuri kufijtë në mes. I bëri pikë e pesë!
Bota nuk është menduar kështu, o Zotni!



Eqrem Basha lindi në Dibër më 1948. Në letrat shqipe debutoi në vitin 1971 me vëllimin me tregime "Shëtitje nëpër mjegull". Po këtë vit botoi dhe librin me poezi "Opuset e maestros". Pasuan dhjetë libra me poezi, katër me tregime dhe tri romane.

Në vitin 1999 prestigjiozja frënge "Fayard" botoi librin me tregime "Les ombres de la nuit", nga një përmbledhje me poezi dolën në serbisht, polonisht (Seyni) dhe anglisht (Nju Jork). Tregimet dhe esetë e Bashës janë prezantuar në revista e botime të veçanta në Francë, Gjermani, SHBA, Austri, Zvicër, Bullgari, etj., ndërsa poezia është përkthyer në shumicën e gjuhëve të Europës, por edhe në arabisht, hebraisht, japonisht, esperanto etj. Është paraqitur në shumë festivale të poezisë, në panaire libri, manifestime kulturore, në mbrëmje autoriale, debate e performanca artistike. Basha është marrë dhe me përkthime.

Puna e gjatë në televizion e ka orientuar tek skenari, është marrë me ese e kritikë të artit figurativ. Ka punuar e bashkëpunuar në gazeta, revista e periodikë të ndryshëm.

LIBRAT E BOTUAR

- Shëtitje nëpër mjegull, tregime, Rilindja, Prishtinë, 1971.
- Opuset e maestros, poezi, Bota e Re, Prishtinë, 1971.
- Stacionet e fisnikëve, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1972.
- Polip-ptikon, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1974 (ribotuar nga Rilindja më 1980).
- Yjedet, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1977.
- Mëngjesi i një pasditeje, tregime, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- Atleti i ëndrrave të bardha, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- Udha qumështore, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Brymë në zemër, poezi e zgjedhur, Rilindja, Prishtinë, 1989.
- Poezi, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.
- Marshi i kërmillit, tregime, Dukagjini, Pejë, 1994 (Çmimi "Hivzi Sulejmani").
- Zogu i zi, poezi, Flaka, Shkup, 1995, (Çmimi i Mitingut të Poezisë, Gjakovë)
- Dyert e heshtjes, roman, Dukagjini, Pejë 2001.
- Alpinisti, roman, Dukagjini, Pejë 2004. (Ribotuar në kolanën Letërsia shqiptare në Maqedoni, me parathënien e Ali Aliut, Mikena, Manastir, 2008).
- Doktrina e të menduarit vetëm, poezi e zgjedhur, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Meny ballkanike, poezi e zgjedhur, Toena, Tiranë, 2006.
- Shtëpia e mallit, tregime, Ideart, Tiranë, 2009.
- Lakorjka e Ik'sit, roman, (Çmimi "Azem Shkreli" për vepën më të mire në prozë për vitin 2011), Botimet Koha, Prishtinë, 2011.
- Varrë, roman, Botimet Koha, Prishtinë, 20012.

Filmografia

- Kulla (film televiziv)|Kulla (1991) (TV)
- Migjeni (film televiziv)|Migjeni (1990)
- Bashkësia lokale (1988) (TV)
- Lulepjeshkat e dashurisë (1988) (TV)
- Mixha Ramë (1985) (TV)
- Tre vetë kapërcejn malin (1981) (TV)
- E tërë jeta për një ditë (1980) (TV)
- Epoka para gjyqit (1978) (TV)
- Rropullari (1978) (TV)

Skenare

- Proka (1984)
- Pehlivanët (1975) (TV)

Zija e bukës

Kur dimri zgjatej e forca shterej, kur rrethi shtrëngohej e në mbylleshin në oborrin tonë, ku as gurit nuk kishe ç't'i shtrydhje më, atëherë shihnim vetëm sy të uritur të carrokëve që nguliteshin në duart e zbrazëta dhe na plaste zemra. Thyheshim si kashtë e tharë para argumentit më dëshpërues të arsyes së të qenit në atë vend dh enë atë kohë.

Siç të thashë, regjimi i kufijve vinte e egërsohej aq shumë sa nuk arrinim t'i mbillnim e t'i korrnim arat. Nuk mund të vilnim as vreshtat, as pemët. Atëherë toka mbetej e djerrë, mbulohej me fier e ferra dhe shndërrohej në golle e istikame për stërvitjen e ushtrisë. Në vend të kallinjve të misrit, ajo mbushej me barot e fishekë, në vend të këmbëve tona të zbathura e të kujdesshme për të mos këputur landrën e kungullit a të bostanit, shkelej e rrihej me thundra e çizme të hekurta.

E ç'mund të bënim ne, të mbyllur në karantinë, përveç se të shpiknim shkathtësitë e radhës për të mbetur gjallë pa ia marrë erën bukës? Të duket e pabesueshme, o njeri, se kështu janë vuajtjet tona aty ku ndahen botët dhe ku nuk mund t'i japësh një pikë ujë fqinjit, ku çdo lëvizje a shenjë gjallërie shihet nga gryka e pushkës. Ti je i dyshimtë që ku lind në rrezen e kufirit, sepse rritesh me qëllime për ta thyer dhe për të vrapuar tek gjysma jote, e mbetur në atë anë. Prandaj të mbajnë në nishan, t'i numërojnë hapat dhe matin kafshatën. Je i dyshimtë se ushtron të natyrshmen, instinktin për të jetuar e për të mbijetuar edhe kur bie shi e rrebesh e të vjen balta deri në fyt, edhe kur fryn murlani e t'i mbulon sytë bora, edhe kur të çahet toka më dysh para këmbëve.


Ne rrojmë me natyrën, denbabaden dhe ia dimë teket, ashtu siç ia njohim dhe bujarinë. Po të ishim vetëm ne dhe ajo, nuk do ta njihnim zinë e bukës, sepse natyra është pafundësisht e begatshme. Edhe të duket se nuk të jep mundësi ta zbutësh e ta kultivosh. Zija na pllakoste dhe herë të tjera kur nëa mbylleshin rrugët e kërkimit, shtigjet e furnizimit, dhiaret e ekzistencës sonë në kohë të egra. Por ne dinim ta kapërcenim, arrinim ta përballonim. Ka rrënjë që hahen, ka gjethe që zihen, hithra e barishte që gatuhen, ka zogj të qiellit e të tokës... Po ç't'i bësh dimrit e borës kur mbulon çdo gjë dhe s'lë as ilaç mbi sipërfaqe? Eeee, se nuk i kemi provuar të gjitha! Ne e vëmë gjarprin në shishe. Jemi mjeshtër të zahiresë për ditët e zisë. Në hatullat e nxira, përveç barit e jonxhës së bagëtive, ka gjithmonë rezerva që e shndërrojnë ujin e kazanit të varur në çengelin e oxhakut në supë të nxehtë dhe të shijshme për kalamajtë.

Po si mbetet gjallë, do të pyesësh ti, o Bujar, si mund të rrojë njeriu me dhëmbë në dhé, me rrënjë e barishte! Provoje që ta kuptosh! Jetoje, të mos e harrosh! Është e pabesueshme qëndresa e atij që ia kanë vënë hendekun në derë të shtëpisë. Siç është e pabesueshme jeta e eremitit në shpellën e gurit, ajo e akrepit në rërën e shkretëtirës, e zog pinguinit në akujt shekullorë. Në kohë të tilla nuk ke ku të mbështetesh e kujt t'i kërkosh ndihmë. Kufiri është i mallkuar, të gjithë i shmangen. As karvanet e shkretëtirës nuk marrin rrugën pranë tij. Biles edhe kafsha e egër i bën bisht shtegut të tij e lëre më tregtarët e zanatçinjtë. Vetmia aty është e plotë, heshtja është më e thellë se vdekja.

Por njeriu është më i fortë se guri.

Guri ka qenë dhe është gjithnjë afër nesh. Nuk e vëmë vetëm në themel të shtëpisë, por edhe te oxhaku edhe nën kokë. Gurin e kemi në bark dhe e tresim me lëngjet e urisë. Sa herë përmendej shkathtësia e mbijetesës, e kishim zakon të thoshim se ne nxjerrim tëlyen prej guri. Andaj mësoheshim aq lehtë të rronim edhe në gurishte, edhe në ranishte.

Megjithatë, më e zeza e të zezave, ishte zija e bukës, kur dimri zgjatej e forca shterej, kur rrethi shtrëngohej e ne mbylleshim në oborrin tonë, ku as gurit nuk kishe ç't'i shtrydhje më. Atëherë shihnim vetëm sytë e uritur të carrokëve që nguliteshin në duart e zbrazëta dhe na plaste



zemra, e humbnim vullnetin për të qëndruar. Thyheshim si kashtë e tharë para argumentit më dëshpërues të arsyes të të qenit në atë vend dhe në atë kohë: kruanim magjet, mblidhnim myshkun e puseve të thella ku ruanim verës rezervat e ushqimit, ndiqnim pëllumbat e egër që futeshin nën kulmet e thata, me shpresë se do të gjenin një kokërr misër, që hatullat tona nuk e kishin parë kushedi prej kurësh.

Zija e bukës ishte dhembje që nuk tregohej, dëshmi që s'përmendej as atëherë kur mendonim se e kishim një fije bollëku dhe përpiqeshim të harronim vuajtjet e mjerimin. Zija e bukës ishte ndjenja më e thellë e pafuqisë para gojëve të uritura të carrokëve she sprova më e ashpër e kufirit të durimit tonë. Çuditërisht, atëherë çdo gjë rreth nesh thahej, as strehët nuk piknin, as bari nuk rritej, edhe rrënjët zhvisheshin degët e pemëve shterpa. Shikonim nga qielli, jo për të kërkuar shpëtimin e Perëndisë që na kishte harruar, por për ta lutur për një pikë shi, qoftë dhe për një rrufe shpëtimtare.

Zija e bukës na hante e na thante si kanceri i padukshëm. Ajo futej në mishrat tanë të zaifët duke thithur lëngjet e jetës, për t'i shndërruar binatë e përkulura në skelete të vyshkur dhe pa jetë.

Derisa gjithë të zezat e tjera mund të mbaheshin larg kureshtjes së fëmijëve, mungesa e bukës nuk kishte si të fshihej. Sytë e tyre të mëdhenj e të dalë jashtë në fytyrat e mpira dhe thirrjet e ngrira për bukë na çarmatosnin, ndaj nuk kishim më fuqi t'i mashtronim, sepse çdo gjë ishte përpara: duart e magjet e thata, shpresat edhe më të pakta dhe premtimet bosh. Ne nuk kishim ç't'i thoshim as vetes. Çdo gjë që mund të shpiknim tashmë ishte shpikur, çdo ushqim që do të ofronim, tashmë ishte zhdukur. Nuk kishte një ngushëllim, të paktën ne nuk e njihnim, për nënën që i shtrydhte kot gjirin e tharë foshnjes që i qante në prehër, për mullisin që kruante më kot, për të satën herë, gurët që kishin harruar erën e grurit, thekrës, elbit a tërshërës. Ne ishim të pafuqishëm dhe e shikonim në sy vdekjen nga uria, më të gjatën dhe më të tmerrshmen që ka njohur njerëzia, pa pasur dhe pa ditur asnjë melhem, asnjë shpëtim, njësoj si të jesh në mes të detit e të shohësh si të vetmin shpëtim kiçin e anijes që fundoset.

Po e përsëris, o Besnik i heshtur i Zotit, nuk ishte se nuk kishim ditur të jetonim me skamjen dhe të përballonim krizat e bukës që përsëriteshin me intervale të shpeshta dhe këmbëngulëse. Ne e njihnim jetën dhe ia dilnim gjithmonë të përballeshim me të ligat sa herë që na përplaseshin në kurriz. Shpirti ynë ishte si ai lisi shekullor që ka parë parakalimet e të gjithë ushtrive, kohët e vapës tharëse dhe akullit therës. Zemrën e kishim si të tijën, me njëmijë varrë e të çara, me rrathë të moshës e të vuajtjes. Kur e pret dhe e shikon, ajo të rrëfen histori të trishtueshme, të pabesueshme. Të duket sikur thahet çdo vjeshtë. Por lisi qëndron në këmbë edhe kur e rreh bora, edhe kur e ter vapa, edhe kur i bien gjethet dhe e mbulon acari. E di që nuk ka sesi të vonojë, do të vijë pranvera e do t'i ngjallë sërish lëngjet e trungut e të degëve, për të marrë jetë e për të çelur sythe, për t'u veshur me gjallëri e gjelbërim në një stinë që është e ngrohtë dhe premtuese për të gjithë.

Ashtu ngroheshim dhe ne, gjithnjë me uzdajë për një stinë të ngrohtë që do të vinte patjetër, duke fshehur thellë në hambarët e thatë farat e mbjelljeve pranverore, që i ruanim si sytë e ballit, të mësuar t'i kultivonim e t'i përtërinim brez pas brezi, që të mos birreshin kurrë. Ato ishin farat e ekzistencës, farat e shpresës së madhe që do të na mbushnin arat me drithë e bereqet.

Derisa pritnim shenjat e para të shtendosjes dhe paralajmërimin e stinës së mbjelljeve, derisa rronim me shpresë se ajo ditë do të vinte, nuk ankoheshim e nuk bëzanim, edhe nëse përditë përsëritej e njëjta meny e skamjes, përshesh me ujë valë, përshesh me ujë të ftohtë, patate të bëra bukë, patate që lyejnë tiganin në vend të vajit, hithra, uthullishta, gjethe qepësh, preshi, jonxhe, bungur me gjeth lajthie, gjethe bliri, labot i egër, ceklla, kulumbri, thana, manaferra, larva, skraja, kërpudha, myshqe, liken, alga, rrënjë, lëvore... Derisa shenjë e begatisë ishin gjithmonë buka e misrit, e elbit, e patates, e gështenjave... qumështi, gjiza e djathti nga dy cicat e dhisë së vetme, uthull nga mani i oborrit, trahana, pekmezi, nardeni i thanave e pestili i kumbullave, turshi të kripura e të ëmbla, domate të pabëra, dardha të egra e të buta, fik i papjekur...

Të gjitha i kemi duruar dhe do t'i duronim po të mos vinte dorë mbi vegjëlinë kjo zi e pamëshirshme dhe e pakrahasueshme me një tjetër. Aty të këputej uzdaja, të thyheshin leqet e të zbutej kurrizi. Ne vetë e kemi lëkurën të trashë dhe ashtin të fortë, s'na bën gjë uria. Kemi këmbë prej hekuri e shpinë deveje që e mban një gjysmë ditë thesin, duke u mjaftuar me një pikë dhallë a një kore misri. Po ç't'i bësh foshnjës, o lum miku, foshnjës së brishtë që ka fulqinjtë e njomë të tëmblit dhe i përgjaken nga korja. Kur e sheh si vuan, si thahet e bëhet dushk, kot i këndon durimit e qëndresës, se e gjithë sakrifica për atë kërthi, për atë filiz që ke mbjellë në arën tënde për ta mbajtur gjallë lozën e fisit, duket bosh para gjirit që s'pik. Nuk vjen qumështi në të thatë.

Aty u dogja dhe unë, o udhëtar, dhe humba gjithë çka kisha. Nuk pata më pse të jetoja dhe nuk gjeja arsye për të rrahur tokën e thatë me shkop fillikat vetëm në këtë botë. Prandaj i vura derës së madhe drynin, u fala me varret dhe mora botën në sy, të shkoj e të shoh atje ku nuk ka më kufi.

Për gjithë këto që i the po largohesh, o Udhëtar?

Ika se nuk mbet kush, o Zotni.

Po ti qenke mbushur mall pa ia kthyer shpinën vatanit. Gjithë këtë zjarrmi që paske për atë patkua, s'do ta përballosh duke ikur.

E sheh këtë varrë? S'e sheh, s'e sheh se është brenda. Nuk duket nga jashtë. Është shumë e thellë. Ja, këtu më djeg, në kraharor. Këtu kanë hyrë thikat dhe kanë çarë damarë, kanë gërryer kocka. Kjo sëmbon sa herë ndërron moti. E moti ndërron shpesh se jemi në tokën ku përplasen erërat e ndeshen rrugët e furtunave. Unë të thashë se nuk e kam të lehtë, se sot e tutje nuk do të jem ky që njohe.

A nuk të duket se i jep të drejtë kufirit që të ka ndarë e harrë?

E di ti si është krijuar bota? Më parë ishte Adami. Pastaj erdhi Eva. Pastaj erdhën fëmijët. Pastaj fëmijët e fëmijëve të tyre. pastaj fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të tyre.... fëmijët e fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve të fëmijëve...


Pastaj erdhi dikush dhe ua vuri kufijtë në mes. I bëri pikë e pesë!


Bota nuk është menduar kështu, o Zotni!

Shkëputur nga libri "Varrë"
i autorit Eqrem Basha
Prishtinë, 2011-2012

profil

Librat e Xhafer Martinit mund t'i gjeni ne Panairin e Librit ne Peshkopi 28-31 tetor 2015
ose ne Panairin e Librit ne Tirane ne Pallatin e Kongreseve, date 11-15 nentor 2015.












Vdekja e Kanunit



Kanunet kanë dy vdekje: njera është kur ato shkruhen, hidhen në letër dhe fiksohen me një pamje shkrimore. Tjetra vdekje është kur ato pushojnë veprimtarinë e tyre, kur nuk përdoren më për qëllimin për të cilin janë krijuar. Por, ndërsa vdekja e parë, është e menjëhershme, vdekja e dytë është e ngadaltë. Po të shprehemi me figurë, sapo një kanun të bëhet libër, ai nuk është më i shtrirë në kohë dhe hapësirë, nuk është më pronë e të gjithëve dhe i askujt, por është zvogëluar, deformuar, njëtrajtësuar sa e mban në duar. Ai nuk e ka më frymëmarrjen e dikurshme, vrullin, dinamizmin, dhe pse jo, edhe demonizmin e dikurshëm. Ai nuk ka, mbi të gjitha, lirinë që ka pasur.Tani ai rri në duar të tua, mbi tryezë i bindur ose në raftin e bibliotekës i varuar prej teje, i ndrojtur dhe i rrëgjuar dhe shikon "rrobat" që i kanë veshur, "kostumin" që i kanë prerë, kostum i cili mund të mos i vijë tamam ose të mos i pëlqejë ngjyra, stofi, prerja e qepja etj. Kuptohet lehtë ku e kam fjalën: një kanun, kur mblidhet e kodifikohet, bëhet shumë punë, nganjëherë e talentuar, harxhohet shumë kohë, forca intelektuale, morale, shpirtërore e fizike, por kjo nuk do të thotë se puna është bërë siç duhet.

Gjithnjë në mbledhjen dhe kodifikimin e një kanuni ka një diferencë, nganjëherë jo e vogël, midis asaj që ka qenë dhe asaj që ka dalë në libër. Por edhe sikur kjo punë të jetë e shkëlqyer, pa asnjë të metë, fakti që Kanuni hyri në libër, e bën atë libër si të gjithë të tjerët, mbasi merr fund tradita gojore, forma e vetme me të cilën ai ka jetuar në shekuj.

Shaban Sinani në lidhje me këtë proces bën një konstatim shumë të saktë: "Për fat të keq, jo vetëm në rrethet parashkencore, por edhe në ato shkencore, në mënyrën e shqyrtimit të traditës etnojuridike vazhdon të shpërfillej një prej ligjeve themelore të shkencës së antropologjisë: fuqia e traditave gojore (rite, magji, rregulla, rende) pushon së vepruari pasi ato tejshkruhen, shfaqen si ligjërim i shkruar. Këtë e pati kuptuar ndër të parët gjuhëtari E. Çabej, i cili, qysh në vitin 1936, kur shkroi librin "Elementet e gjuhësisë dhe të literaturës shqipe", veprën më të rëndësishme të At Shtjefën Gjeçovit, "Kanunin e Lekë Dukagjinit", e trajtoi thjesht si një vepër letrare, sikurse veproi më vonë G.Schiro (J.), me "Storia della letteratura albanese", botuar në Milano më 1959". 224)

Sh.Sinani e çon më tej mendimin e tij: "Në vitin 1933, kur "Kanuni i Lekë Dukagjinit" u botua prej françeskanëve, realisht pushteti i tij etnojuridik vdiq. Karikatura e së drejtës së pashkruar është ngujimi i sotëm i fëmijëve dhe grave-"ndores" dhe privilegjet e saj". 225) Ky është një përfundim i drejtë. Vdekja e kanunit si libër është realizuar.

Por vdekja tjetër, që është ajo e mospërdorimit, është tjetër gjë. Kanunet, në kuptimin e mospërdorimit, moszbatimit, vdesin pjesë-pjesë, ndonjë institucion vdes i pari, kurse të tjerët jetojnë më gjatë, por natyrisht, nuk funksionojnë me kapacitetet e dikurshme. Për shembull, instituti i gjakmarrjes vdes i pari, për dy arsye: e para: ky institut ka të bëjë me krimin ndaj personit, me jetën e njeriut, për mbrojtjen e të cilës shteti shfaq fuqinë dhe ashpërsinë më të madhe. Të paktën kështu duhet të jetë, se, siç po shikojmë, në vendin tonë jeta nuk është e sigurtë. Por le të merremi me normalen. Është ngritur një sistem drejtësie, gjykatat, që merren me dënimin e krimeve, sidomos me dënimin e krimeve ndaj jetës së njeriut. Janë disa llojë gjykatash, ku punojnë me qindra njerëz të shkolluar që paguhen me paret e popullit për të dhënë drejtësi. Zyrtarisht Kanuni ka dalë në mënyrë absolute jashtë përdorimit. Ai, zyrtarisht, ka vdekur plotësisht. Gjakmarrja si institucion vdes i pari, mbasi nuk mund të ketë dy të drejta paralele: njera me kanun, tjetra me ligj. Nëse një njeri vret një tjetër, tani vrasësi dënohet nga ligjet e shtetit. Kjo është e përgjithshmja dhe kështu duhet të ndodhë, pavarësisht nga shmangiet dhe dobësitë. Ka edhe raste që vrasësi, dënohet një herë nga ligjet e shtetit me burg, dhe, mbasi kryen dënimin, ai vritet nga familja e viktimës. Ky nuk është normalitet. Ky është absurditet. Nuk mund të dënohet dhe ndëshkohet njeriu dy herë për të njejtin krim. Por kjo nuk ka si mos të ndodhë, kur sistemi gjyqësor, që përfaqëson shtetin, e dënon me pak vite burg vrasësin, i cili, jo vetëm nuk ka sjellë asnjë llojë pendese, por edhe kapërdiset si triumfator.

Por, edhe pse është krijuar shteti, me gjithë sistemin e drejtësisë, ka ndonjë institut të kanunit që vazhdon të mbijetojë dhe të kryejë ndonjë farë funksioni pozitiv edhe në ditët tona. Ky është instituti i pajtimit që vazhdon të përdoret në popull për të zgjidhur konflikte të vogla dhe të mëdha, për të cilat njerëzit nuk kanë qejf t'u drejtohen gjykatave. Pajtimet e rralla plot zhurmë dhe bujë që bëjnë disa shoqata, janë sa për të justifikuar paratë që marrin nga burime të ndryshme. Pajtimet e vërteta, të shpeshta dhe me rezultate pozitive janë ato që janë kryer duke respektuar rregullat e Kanunit, ndonëse infrastruktura e Pajtimit si Institut tani nuk është e plotë. Kështu, si shembull, kur midis vëllezërve, fisit ndodhin konflikte ku duhet ndërhyrja e të tretëve, ata janë të prirur t'i zgjidhin vetë, pa iu drejtuar gjykatave, edhe pse duan të ruajnë intimitetin, por edhe pse nuk kanë besim tek gjykatat. Pajtimet kanë një diapazon të gjerë, duke filluar që nga fyerjet, grindjet për tokat, kufijt,vijat e ujit, shtëpitë, trojet, bjeshkët e deri tek konfliktet më të rënda që prekin nderin, dinjitetin dhe jetën e njeriut. Tani vendin e Pleqëve që jepnin drejtësi, në funksion të institutit të pajtimit, e kryejnë miqtë dhe dashamirët që i kanë njësoj palët e konfliktuara. Në vitet e sistemit demokratik, me pushtet ende të dobët, me ligje ende të pazëvendësuara për t'u quajtur vërtet demokratike, me gjykatës pa arsim solid (*Shkolla e Plepave*), pa përvojë, por edhe pa ndërgjegje e të politizuar, instituti i pajtimit ka vepruar dhe ka dhënë rezultate pozitive. Po kështu sipas kanunit dhe jo sipas ligjit janë zgjidhur ndarjet e pasurisë së tundshme dhe të patundshme midis njerëzve, mënyra e shpërblimit për tokat që u ziheshin pronarëve, madje edhe ligji për Tokën në shumë krahina ka vepruar sipas Kanunit që toka është e trashëgueshme e jo sipas ligjit që nxori shteti me anë të Kuvendit Popullor. Në Dibër është në fuqi edhe sot e kësaj dite Ligji i Trashëgimisë së Tokës. Po kështu është vepruar edhe në Mirditë, siç na jep plot të dhëna me cilësi shkrimi dhe interpretimi Profesorja e Universitetit të Kembrixhit, zonja Clarissa de Waal në librin e aj "Shqipëria pas rënies së komunizmit"(Tiranë,2009). Profesorja tregon që Kanuni u shtri në tërë jetën e popullit dhe kjo konsiderohej një gjë mjaft positive përderisa ligjet e shtetit ose nuk ekzistonin ose nuk ishin vepruese. Secili fshatar shkoi në tokën e vet dhe përgjithësisht nuk kanë ndodhur ngatërresa me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë. Nuk ishte e lehtë ta ndaje tokën mes pronarëve të ligjshëm, sepse kufijtë gjatë dyzet vjetëve të sistemit kooperativist ishin zhdukur, vendi ishte transformuar aq shumë sa nuk dukeshin më vijat, kanalet, shtigjet, mejat, gurët që shërbenin si kufinj natyrorë. Pemët, si orientuese, ishin prerë me kohë. Në shumë raste pleqve, duke u betuar më parë se do të flisnin në emër të Zotit, iu desh përfytyronin kufijtë e pronat, t'i ndanin ato me hamendje dhe në mënyrë të përafërt, por njerëzit u besuan se edhe ata ishin betuar se do ta linin në kujtesën dhe në ndjenjën e tyre të drejtësisë. Në sistemin kooperativist disa fshatarë kishin ngritur shtëpi në tokat e pronarëve të tjerë, dhe një gjë të tillë e kishin bërë me lejen e pushtetit të asaj kohe. Në Mirditë, sipas të dhënave të profesores që sapo përmendëm, kjo gjendje u kalua me mjaft vështirësi, nganjëherë edhe me dhimbje, kurse në Dibër pati fare pak probleme. Dibra i doli para kaosit. Në zonën e Dardhës, një nga vatrat e njohura të gjakmarrjes së hershme, u mblodh një kuvend i madh që prodhoi *Itifakun* e mosnjohjes së gjakmarrjes dhe ndalimin e plotë të riciklimit të saj në jetën e malësorëve, pavarësisht nga dobësia ose shembja e shtetit. Itifaku u njoh nga gjithë Dibra dhe u pranua pa hezitim. Zgjidhja me durim e mosmarrëveshjeve të reja dhe harresa e plot e mosmarrëveshjeve të vjetra qe baza filozofike nga u nisën malësorët e Dibrës për të marrë nga Kanuni vetëm ato anë që do t'u sillnin dobi. Ja, pra, pse Kanuni edhe i vdekur, "u ngrit nga varri" për t'u shërbyer njerëzve që e krijuan.

Kanuni gjatë periudhës së tranzicionit u ka shërbyer njerëzve edhe për të kryer disa punë të përbashkëta, si: hapja e udhëve, ndërtimi i urave të thjeshta, kryerjen e punëve të tjera që kërkojnë forca të bashkuara. Nga këto që thamë del se Kanuni nuk ka vdekur plotësisht edhe në aspektin që bëmë të njohur. Nuk ka asgjë të keqe, përkundrazi shumë të mirë, që këto rudimente të tyre të shfrytëzohen herë pas here atje ku është e mundur. Edhe nxjerrja e ligjeve të reja, sidomos hartimi i kushtetutës, duhej të mbante shumë parasysh ligjet që janë nxjerrë dhe kanë funksionuar nga Kanuni. Gazetari amerikan, siç e kemi përmendur më lart, merr si shembull madhështie dhe mrekullie vetëm ligjin për Mas-Median, por sa të tillë ka Kanuni?!

Megjithatë, ne Kanunin tashmë nuk e duam dhe e nderojmë për këto përftesa që përmendëm, por si monument madhështor të popullit tonë, që ka të bëjë jo vetëm me përfshirjen në të të historisë së popullit tonë, por edhe të gjuhës, dokeve, zakoneve, traditave, kulturës materiale e shpirtërore, dhe të gjithë atyre veçorive specifike që e dallojnë kombin shqiptar nga kombet e tjerë.Kanuni është jeta. Megjithatë, një shoqëri moderne evropiane bashkëkohore është ajo që nuk mbart në jetën e vetë asnjë gjurmë të Kanunit.

(Shkëputur nga libri "Kanun")



Bisedë me piktorin Zaim Elezi - Zaya, para hapjes së ekspozitës së tij personale në Peshkopi në datat 28-31 tetor 2015.



Kthim në vendlindje me mallin për Zuren...

Zaim Elezi - i njohur me emrin artistik Zaya, është lindur në Melan, Dibër në vitin 1958. Në vitin 1983 ka mbaruar studimet e larta në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas ka punuar piktor filmi në TVSH; skenograf i teatrit profesionist, Peshkopi; mësues në shkollën e mesme artistike, Peshkopi, etj.

Punimet e tij në pikturë janë paraqitur në ekspozitat kolektive të mbajtura në Peshkopi, Tiranë, Prishtinë etj., që nga viti 1984 e në vazhdim. Në vitin 2004 ka hapur një ekspozitë personale në Qendrën Botërore të Tregtisë në Gjenevë, Zvicër, e pasuar kjo edhe me një tjetër në Universitetin Populllor të Gjenevës e po ashtu edhe në ekspozitën kolektive në Annemasë të Francës me autorë vendas, francezë. Shumë piktura të tij janë pjesë e koleksionistëve me famë në Francë, Kanada, Angli, Zvicër, Amerikë. Gjithashtu, dashamirës të pikturës në Shqipëri mbajnë në koleksionet e tyre piktura të firmosura nga "Zaya".

Më datat 28-31 tetor 2015, ai kthehet në vendlindje me një ekspozitë personale të titulluar "Kthim në vendlindje". Titulli duket si nostalgjik, por piktori i njohur Qamil Prizreni thotë në lidhje me këtë ekspozitë se "nuk është problem nostalgjie apo lokalizmi, por vepra e Zayas, kudo që të ekspozohet, ka vetëm një emër që quhet "Art". Lidhur me ekspozitën dhe karrierën artistike, ne zhvilluam një bisedë, para se Zaya të "ngarkonte" pikturat në makinën e tij dhe të nisej për Peshkopi.

- Që nga viti i mbrapshtë 1997, kur jeni larguar nga Dibra, ju riktheheni në Peshkopi për herë të parë me një ekspozitë personale në pikturë. Si ndjehet Zaim Elezi?

Në krye të herës më duhet të pohoj me plot gojën: kthehem me emocion të veçantë. Sinqerisht kjo situatë nuk është se e kisha menduar të ishte kaq e ngarkuar emocionalisht, por ja që kështu po i përjetoj ditët e përgatitjes së ekspozitës.

Me sa duket, përgjegjësia është e njëjtë në çdo sallë apo event, është pesha e eventit. Por mund të thuhet edhe diçka tjetër; emri im është jo shumë i njohur në Dibrën e sotme, nëse i referohemi lëvizjeve të mëdha të emigracionit dhe të migracionit. Në mënyrë gati masive qyteti i Peshkopisë është zëvendësuar si popullatë, kanë ardhur banorë të rinj, ndoshta unë gabohem kur them se emri im nuk ju thotë ndonjë gjë banorëve të rinj të Peshkopisë, ndaj mendoj se nuk më njohin.

Këto vite të munguara qytetit tim dhe qytetarëve të mi kanë efekt, por dhe më ngarkojnë me përgjegjësi dhe emocion. Edhe nëse ju kam munguar, shpirtërisht kam qenë pranë tyre, kjo shprehet edhe në shumë tema dhe motive të veprave të mia.

Natyrisht, kjo ka ardhur natyrshëm në veprën time dhe jo si një detyrim, por e kam ndjerë dhe e kam bërë krejt natyrshëm. Në respekt të së vërtetës, largimi im nga Peshkopia nuk ka qenë kurrë dhe për asnjë moment ikje, por vetëm një largim për një jetë në një mjedis më të madh, aq të domosdoshëm për një krijues. Gjithë këto vite e kam pasur kokën pas, si i thonë fjalës, ndaj shpesh çmallem me vendin tim duke shkelur në viset e tia të mrekullueshme e përkëdhelëse.

Kthehem të jap hesap, llogari para qytetarëve të mi, të jap xhevap për "premtimet" e mbajtura apo të pambajtura, ani pse jo të bëra publike kur u largova në '97 e mbrapshtë. Më beso se në gjithë këto vite e kam menduar se bijtë duhet të japin hesap, të japin llogari se ku ishin gjithë këto kohë, ku humbën që nuk u bënë të gjallë e në rast se nuk i ke të justifikuara vitet e munguara, vitet e ndarjes apo të distancës, nuk mund të kthehesh në vendlindje...

- Pse e titulloni "Kthim në vendlindje"?

E kam menduar këtë emërtim të ekspozitës time gjatë. Unë, siç më sipër e përmenda, çmallem me vendlindjen, vij shpesh, por kthim, në analizën time, ka një tjetër kuptim, ka një dimension tjetër. Unë kthehem si piktor dhe krijues, jo si banor dhe si çdo banor i Peshkopisë dhe Dibrës. Kthehem të jap hesap, llogari para qytetarëve të mi, të jap xhevap për "premtimet" e mbajtura apo të pambajtura, ani pse jo të bëra publike kur u largova në '97 e mbrapshtë. Më beso se në gjithë këto vite e kam menduar se bijtë duhet të japin hesap, të japin llogari se ku ishin gjithë këto kohë, ku humbën që nuk u bënë të gjallë e në rast se nuk i ke të justifikuara vitet e munguara, vitet e ndarjes apo të distancës, nuk mund të kthehesh në vendlindje. Nuk mund të kthehesh se nuk të bën kush vend dhe kanë të drejtë jo vetëm të rinjtë që nuk të kanë njohur, por as të vjetrit, se ke humbur gjurmët, shenjat. E në veprën time ka mall dhe vendlindje në secilën syresh, ka lëng, aromë prej saj edhe kur subjekti ka qenë një tjetër vend. Për këtë të siguroj. Shpresoj të ma bëjnë një "vend", pasi të shohin ekspozitën!

Por, në fakt, duhet thënë: paça lënë vend që edhe me punën e bërë në vitet e munguara të më bëjnë një vend!..

- Pikturat e ekspozuara çfarë mesazhesh përcjellin?

Sigurisht që veprat e kanë një mesazh dhe ky është DASHURI DHE SINQERITET në të gjitha tablotë. Ka shumë ajër në to, shumë freski, ku mundimet e përditshme nuk na e lejojnë t'i shohim e shijojmë, ndaj unë kthej sytë te shikuesit pikërisht në këto ndjesi, në peizazhe dhe lirikë, shumë lirikë që populli ynë i ka me shumicë në vargje e rite, por jo në jetën e përditshme.

Për më tepër, të shijojnë shikuesit dhe t'i sitin ato që merren me art.

cyan magenta yellow black

intervistë



...Veprat e kanë një mesazh dhe ky është DASHURI DHE SINQERITET në të gjitha tablotë. Ka shumë ajër në to, shumë freski, ku mundimet e përditshme nuk na e lejojnë t'i shohim e shijojmë, ndaj unë kthej sytë te shikuesit pikërisht në këto ndjesi, në peizazhe dhe lirikë, shumë lirikë, që populli ynë i ka me shumicë në vargje e rite, por jo në jetën e përditshme.

- Shumë piktura tuajat janë në galeri dhe koleksione private në vend dhe në botë. Si ndjehet Zaya për këtë fakt. Ose çfarë do të thotë për një piktor kur vepra e tij i ikën nga duart?

E kemi me dy anë këtë ndjesi, si medalja. Sigurisht, që ndjesia kur një vepër jotja pëlqehet dhe blihet është emocionalisht dhe materialisht bukur. Por unë nuk e kam përjetuar si një shitje, blerjen e një vepre timen, por si një ndarje, e ndarja dhemb. Ndarja është plagë. Me një fjalë, dibrani e ka thënë bukur këtë gjendje: "Këtu më dhemb e këtu më djeg".

Më vjen ndërmend një histori me një amerikane, një grua e vjetër, që ishte e atashuar tek Instituti i Medias në Tiranë. Erdhi një ditë në studio para ca vitesh dhe po shihte me interes çdo kuadër. Unë nuk e njihja fare. I vë gishti një tabloje të vogël. Në tablo një plakë e vjetër si amerikania, mbledhur kokën me shami të bardhë e me bofçë me pika përpara. Buzëqeshte plaka në rreze të diellit dhe gjithë kënaqësi tërhiqte lopën e shtëpisë nga pas. Në sfond rrugë e disa shtëpi të fshatit.

- *Më pëlqen, foli amerikania.*

- *Edhe mua, - ia ktheva unë.*

- *Sa kushton, - nxiti bisedën ajo. I thashë një çmim sigurisht.*

- *Shtrenjtë, - ma ktheu ajo.*

Unë nuk fola.

Ajo: - Ka ndonjë ulje?

- *Po, - i thashë, por shumën do ta them vetëm nëse e blen.*

- *Ok, - ma ktheu, do e blej.*

Ia thashë çmimin. I rrudhi turinjtë.

- *Është shtrenjtë, - më tha amerikania.*

Nuk i ktheva përgjigje dhe vendosa të mos e vazhdoj bisedën. Amerikania hidhet:

- *Si titullohet tabloja?*

Realisht, nuk kisha menduar ndonjë titull, por e thirra tablonë në emrin e plakës, Zures, personazhit të cilit i isha referuar.

- *Unë e dua Zuren, - ia priti ajo.*

- *Edhe unë, - ia ktheva flakë për flakë. - Dhe ti zonjë duhet të paguash të më ndash mua nga Zurja, pasi unë nuk mund ta di sa kushton piktura.*

Heshti.

- *Sa bukur ma the, - foli amerikania, - shumë bukur. Ke të drejtë, - dhe nxori lekët dhe më ndau nga Zuria... Zuria është në Amerikë sot.*

- Vepra juaj "Beteja e Skënderbeut", ekspozuar dikur në Muzeun Historik të Sinës është zhdukur. Kjo është një temë që do ta shtjellojmë më hollësisht herë tjetër, por këtë radhë desha t'ju pyes se si ndjehet një piktor kur vepra e tij ka humbur?

Më ke çuar shumë larg. Nuk di asgjë për fatin e saj. Veprat janë si bijat, si fëmijët. Lutem si prindi vetëm të jetë shëndoshë dhe pastë ra në një derë të mirë, ku t'ia dinë vlerën.

- Këtë herë ju nuk riktheheni vetëm, por edhe me një koloni piktorësh të njohur. Dmth, nuk është një kthim për një ekspozitë personale, por një kthim me miq? Çfarë mund të na thoni për këtë?

Në fakt, ky është kthimi më i bukur që mund të ndodhë. Kurrë nuk e kisha menduar. Jam mrekullisht i llastuar nga miku im i mirë Bujar Karoshi, i cili e bëri të mundur këtë lloj kthimi. Ai mundësoi shpenzimet e kësaj kolonie me një ngrohtësi të jashtëzakonshme dhe me një thjeshtësi të paimitueshme, të papërsëritëshme.

E kemi me dy anë këtë ndjesi si medalja. Sigurisht që ndjesia kur një vepër jotja pëlqehet dhe blihet është emocionalisht dhe materialisht bukur. Por unë nuk e kam përjetuar si një shitje, blerjen e një vepre timen, por si një ndarje, e ndarja dhemb. Ndarja është plagë. Me një fjalë dibrani e ka thënë bukur këtë gjendje: "Këtu më dhemb e këtu më djeg".

Kishim kohë që e bluanim një aktivitet të tillë. Bujari këmbënguli se duhej të ishte pjesë e kthimit dhe e ekspozitës, pjesë e Panairit të Librit që Botimet M&B e organizojnë për të dytin vit në Peshkopi, lezetuar edhe me Odën Dibrane që do të zhvillohet po në të njëjtat data.

Me fjalë të tjera, mirënjohje pa fund Bujarit, që bën të mundur që në këtë koloni të jenë të tillë emra e personalitete si Zef Shoshi, "Piktor i Popullit", një artist madh i Artit Pamor Shqiptar, kontribues shumë i rëndësishëm i tij. Zef Shoshi me individualitetin e tij të veçantë, mjeshtër i portretit dhe kompozimit, shkurt një mjeshtër i madh.

Mustafa Arapi një ndër më të spikaturit mjeshtër të peizazhit, atmosferës së pangjashme e të papërsëritshme nga njëri në tjetrin, apo vizatimeve mjeshtërore dhe të ndjera.

Ikbale Kalaja, ndër më interesantet në përcjelljen e masave të kundërta ngjyrore e herë-herë të lagështa, sikur të freskëta e të sapolindura, i përcjell me një sinqeritet çarmatosës në telajo. Një zë krejt i veçantë dhe i admirueshëm.

Leoni Çika, si një mjeshtër i drithërimës së dritëhijes dhe i toneve të lehta e të pangjashme, njohës i mirë i tablosë qytetëse.

Zef Shoshi, "Piktor i Popullit", një artist madh i Artit Pamor Shqiptar, kontribues shumë i rëndësishëm i tij. Zef Shoshi me individualitetin e tij të veçantë, mjeshtër i portretit dhe kompozimit, shkurt një mjeshtër i madh.

Mustafa Arapi një ndër më të spikaturit mjeshtër të peizazhit, atmosferës së pangjashme e të papërsëritshme nga njëri në tjetrin, apo vizatimeve mjeshtërore dhe të ndjera.

Ikbale Kalaja ndër më interesantet që përcjelljen e masave të kundërta ngjyrore, e herë herë të lagështa sikur të freskëta e të sapolindura, i përcjell me një sinqeritet çarmatosës në telajo. Një zë krejt i veçantë dhe i admirueshëm.

Leoni Çika, si një mjeshtër i drithërimës së dritëhijes dhe i toneve të lehta e të pangjashme, njohës i mirë i talosë qytetëse.

Pjetër Marku, artist që përjashton vitet duke na ofruar një krijimtari plot ngjyrë e tis fëmijëror, që nuk hiqet lehtë nga mendja.

Marjana Goxhabelliu me zhdërvjelltësinë e penelatës e plotësinë ngjyrore gjithë bollëk e pakursim derdhur në masa të mëdha e të shkathëta volumore.

Mjeshtri dibran Hamdi Kaci me një paletë delikate e një formë e masa abstrakte herë-herë dhe sugjestionues. I veçuar për elegancën e ngjyrës e më tej.

Flamur dhe Avni Sala Sala, po ashtu, me një brushë gjithë besim dhe eksperiencë që materializon situata dhe emocione të shpërndara me kursim dhe mjeshtëri.

Dritan Bocku, një i ri me talent, që përcjell traditën familjare, me ngjyra dhe kompozicione bashkëkohore.

Dhe me e reja Ina Elezi, me energji të pashprehura dhe ende të pathëna, por krejt individuale dhe me origjinalitet të theksuar artistik.

Më ke çuar shumë larg. Nuk di asgjë për fatin e saj. Veprat janë si bijat, si fëmijët. Lutem si prindi vetëm të jetë shëndoshë dhe past ra në një derë të mirë, ku t`ja dijnë vlerën.

Pjetër Marku, artist që përjashton vitet, duke na ofruar një krijimtari plot ngjyrë e tis fëmijëror, që nuk hiqet lehtë nga mendja.

Marjana Goxhabelliu, me zhdërvjelltësinë e penelatës e plotësinë ngjyrore gjithë bollëk e pakursim derdhur në masa të mëdha e të shkathëta volumore.

Mjeshtri dibran Hamdi Kaci, me një paletë delikate e një formë e masë abstrakte herë-herë dhe sugjestionues. I veçuar për elegancën e ngjyrës e më tej.

Flamur Sala po ashtu, me një brush gjithë besim dhe eksperiencë, që materializon situata dhe emocione të shpërndara me kursim dhe mjeshtëri.

Dhe më e reja Ina Elezi, me energji të pashprehura dhe ende të pathëna, por krejt individuale dhe me origjinalitet të theksuar artistik.

Në të vërtetë janë emra të mëdhej dhe ne i kemi quajtur miq, pasi prezenca e tyre në grup është një rast jo i shpeshtë në Peshkopi. Shpresoj ta bëjmë të njohur Dibrën, vlerat e saj, te këta njerëz të rëndësishëm.

- Ju sapo keni themeluar Shoqatën e Artistëve të Artit Pamor "PamArt". Cfarë do të thotë kjo nismë e re për Ju?

Eh, shoqata është një organizëm i cili do të vërë në lëvizje ingranazhet e shtetit dhe shoqërisë të cilat mezi lëvizin për hir të së vërtetës. Por jemi ende në fillimet e krijimit të saj. Një rol jo të vogël ka edhe Shoqata në këtë aktivitet, në bashkëpunim me Botimet M&B.

- Këto ditë është edhe Oda Dibrane, sa mendoni është në ndihmë të artistëve ky aktivitet i vlerave burimore jo vetëm të Dibrës?

Për hir të së vërtetës Oda është edhe një mundësi më tepër për atmosferën që krijon ajo në qytet dhe për pasojë te vetë artistët, mendoj se do të shërbejë si një rast i mrekullueshëm për të vizatuar e pikturuar portete e kostume të mahnitshme të trevave shqiptare brenda dhe jashtë kufijve. Një vlerë e shtuar kjo për qytetin dhe krijimtarinë e piktorëve.

Bisedoi: **Hysen Uka**

Rruga e Arbërit nr. 114

Librin “Dritë nga errësira” mund ta gjeni
në Panairin e Librit në Peshkopi 28-31 tetor 2015

recensë

Halil Teodori, *ngarendja vullnetmirë e një kumti rrëfimtar*

Nga **ALBERT VATAJ**



Qasjet e kësodorshme artistike, si në romanin “Dritë nga errësira”, të Halil Teodorit, përkojnë me ngulmimin përnga kumti dhe rrëfimtaria. Më shumë se kah dimensioni estetik, kahja si shërbesë rrëfimtare, ngulmon thelbësoren e këtij romani. Ngarendje për t’i bërë karshillëk dy dimensioneve, gojtarisë së kallëzimit,shpesh në narrativ, ka pru një lloj artifici jashtëletrar. Kujdesi për formën, më shumë se sa për brendinë, ka ngas nër ne një masë marrafrymëse të letërsisë që priret në kryeherën e vet nga përnga trukimi. Më së shumti, kjo letërsi është lëndë e mbrujtur mirë e kundrimit dhe konstatimit, e qëmtimit dhe e larushimit të situatave dhe shpërfaqjes së personazheve. Në romanin e Halil Teodorit, “Dritë nga errësira” është e rëndësishme rrëfenja, “me zemër në dorë”. Si për autorin, ashtu edhe për gjithsekënd, përvojat jetësore, janë të atilla, përnga larushia dhe shumforma, sa mjafton t’i ndjesh për t’i kumtuar botnisht, dhe ata janë vetiu një kapërthim i epërm artistik. Udhërrëfimi i gjendjeve në këtë roman, yshten për të patur stacionin e rrugëtimit, një kujtim.Një fotografi e një të afërmi, e cila ka ndjekur ashtu e kyçur në një korrnizë të drunjtë, hap pas hapi, bashkë me fatin tënd, ngado që ti ke ikur. Dhe një ditë, jo ndryshe nga gjithë të tjerat, ajo vendos të flasë me gojën tëndë. Vendos të rrëfejë gjithçka dhe pa droje, o sot, o kurrë. Të duhet vetëm të bindesh. S’ka kohë për të pritur. “Dritë nga errësira”, tekembramja është e mbarsur nga përmasat e një kushtrimi, i cili tuj gufu nga përvojat jetësore e personazheve, të vendosur në një kënd të së tërës tragjedike, në një realitet dramatik, ku luhet mizorisht me fatet e individit të tufëzuar. Në këtë qasje autori nëpërmjet personazheve dhe karaktereve, situatave dhe ngjarjeve dëshmon dhe nuk nguron t’i kumtojë tançka atë e ka mbrujt, me fondamentin e shpirtit. Udha nëpër shtigjet e garrametshme nuk bëhet pengesë, që ky përrua i majisun nga stuhitë, të lëshohet përposhtë turravrap, me poterë. Autori, përkimin e situatave e shkrin me personazhet, të cilët në diktaturë, të gjithë janë fatkeq. Armiku është i përbashkët. Trauma dhe krrakëdhima e dhëmbëve, gjithashtu ngjajnë. Lënda emocionale është e shkrifët, tek-tuk ajo ngjishet fort duke marrë forma solide, shpesh tëpashpërbëshme, të padeshifrueshme. Gjithseqysh, ky është njeriu i kodifikuar sipas një rregulli që gjehet i shumëfishuar në individin standard, që përfaqëson tiparin kryesor të tërë shoqërisë së kohës së tij.Parakalimi që i bën autori jetës së personazheve i ngjajnë ritmikës së shpërfaqjes së episodeve në celuloid. Gjithçka mund të ngjasë nga faqja në faqe. Duket se karakteret e përcjellë në këtë roman, janë të përpunuar gjenetikisht, për të perceptuar çdo të papritur, si pritshmëri. Mëgjithatë situatat dhe ngërthimi i ngjarjeve kanë pothuaj gjithseçka, jo dhe aq të parathënë, se sa të njëllojtë. Nëse ata kacavirren në rrëpirën e thikat të idilit për të ndryshuar, kjo ngase dhe jeta e tyre qaset të shpërfaqet e tillë, krejt papritur udhët e tyre bashkohen. Honi ku gremisen të gjitha qasjet është pikëtakimi, është zgavra ku fatet e tyre bashkohen. E rishtaz ata provojnë përsëri. Përsëri përpiqen, anipse shpërblesa është e parathënë. Ata i bashkon honi, nga ku dhe janë startet e tyre. Rropatja është as më shumë e as më pak, veçse një orvatje drejt një shtegu, që gjithnjë është një dhe i vetëm.

Ndoshta është koha që kanë vendosur të jetojnë, mënyra e jetës që kanë vendosur të bëjnë, ose për të cilën janë programuar, ajo që përcaktojnë qartazi, se çfarë kanë parashikuar orakujt për ta. Ndryshe, thjeshtë ata binden si në një hipnozë. Dhe kështu është dhe kurrqysh tjetër. Halil Teodori në romanin e tij, në qendër ka gjithnjë personazhin protagonist. Ka pikmbështetjen arkimediane ngaku lëviz gjithçka, ngase gjithseçka ndodh gjithseqysh në të dhe përreth tij. Kjo referencë është thjeshtë një vetvete, që dirigjon gjithë këtë trupë aktorësh-personazhe.

Është Uni dhe Esi i këtij personazhi në tërësinë e vet që ushqen, deri edhe me formësimin e situatave dhe ndodhive, galerinë e tërë të emrave dhe ngasjeve emocionale. Destinomi për të përshkuar përgjatë gjithë jetës Golgotën, është fatthënia që u ka vënë përpara vetëm një alternative, kryqëzimin. Bashkë me shenjtnimin ata përcjellin mesazhin e fortë, se liria mbetet ngulmi vetëmohues, përpjekja ngallnjimtare mbi despotizmin. Ata përpiqen. Është pikërisht kjo trajtesë, ky ngjurim që tipizon identitetin e personazheve që luajnë në një skenë të vetme, Shqipërinë e viteve të diktaturës komuniste. Autori në “Dritë nga errësira” nuk shmang qoftë edhe detajet,në dukje të parëndësishme për ti kumtuar. Pas çdo cingërime ai parasheh fillesën, zanafillën e një ngjarje, një situate, agravimi i të cilave përvijon në një ashpërsim të terrenit, acarim të kushteve atmosferikë, ku ngarendin shtigjet e gjarpërimit të karakterit të personazheve. Ajo që e bën ngulmues këtë përpjekje të Halil Teodorit për të parë dritë në errësirë është kauza vullnetmirë që vetiu motivon deri në fund, si personazhin qendror, ashtu dhe gjithë galerinë e personazheve të tjerë.

“Dritë nga errësira” është një yshtje e autorit për të kumtuar dhe kuvenduar, dhe këtë ai qaset ta gostit në odën e madhe të breznive, si dëshmim i një mbamendje të gjatë dhe drithëruese.

Për të ndërtuar të ardhmen duhet lexuar e kaluara

Nga **ENGJËLL CELIBASHI**

Libri “Dritë nga Errësira” i Halil Teodorit tregon një pjesë te jetës së një familje patriotike shqipetare, në veri lindje të Shqipërise – Diber, e cila ka hequr te” zintë e ullirit”, gjatë regjimit diktatorial të periudhës 1945-1990. Në roman trgohet se si fatkeqesishtë familja Gjokaj, mori mjaft plagë, perjetojë dramën, jetojë mes privimeve sociale, perbuzjes shoqërore, intrigave dhe mllefeve politike, dhe përjetojë ç’gënjime nga më të ndryshmet të asaj shoqërie.

Të them të vërtetën personazhi i Romanit më ka bërë pershtypje qysh në kapitullin e parë, ndaj kujtova vuajtjet qe kam kaluar unë dhe familja ime ne diktaturë.

Ne ndergjegjjen time, ekziston një kujtim I gjallë I asaj periudhe, por romani “Dritë nga Errësira” I autorit Halil Teodori, shkruhet në të njejten kohe kur njerzit e thjeshte e sidomos rinia shqipetare vazhdon ende ti bëje vetes pyetje te këtilla, si : - Ç’farë ka ndodhur në të vërtet në shoqerinë shqipetare gjatë 50 viteve të diktaturës? Si qe e mundur që ai sistem arriti që me anë të luftës së klasave ti ndaj aq thellsishtë njerzit duke hyrë deri në familjen shqipëtare? Përse disa njerzë të atijë sistemi nuk kanë edhe sot aspak pendesë, por purkundrazi vazhdojnë të kenë akoma nostalgji për atë sistem? Cila qe llogjika totalitare e transformimit të shoqerise dhe individit?

Si qenë të konceptuara dhe si funksiononin strukturst e mekanizmave totalitare si: propaganda,policia sekrete, sigurimi i shtetit, spiunët me dhe pa pagesë, dhe ushtrimi i ideologjisë së terrorit, frikës dhe i persekutimit?.

Une jam në gjendje të vlersoj nje liber si” Dritë nga Errësira” të Halil Teodorit, në veçanti, apo për shkrimet e analizat që i bëhen kësaj të kaluare tragjike, se jeta ime ka qenë pjesë e saj dhe vuajtjet e kohes i kam perjetuar vetë mbi kurriz.

Gjithë jetën time kam qenë i persekutuar politik për arsye se babai im Sami Celibashi ishte kundër vendosjes së diktaturës komuniste në shqiperi dhe për ketë është pushkatuar nga Enver Hoxha në vitin 1946 si kryetar i grupit “Bashkimi Demokratik” që kërkoi të veproi si opozita e parë antikomuniste.

Kam ikur nga shqiperia dhe emigruar ne Amerikë qe prej vitit 2001 në një moshë relativisht jo te re sidomos për ta filluar jetën nga fillimi, por relativishte i formuar që te merrja dhe të trasmetoja me veten time një portret te qarte te gjendjes sociale, shoqërore ekonomike dhe politike të vendit nga i cili u largova dhe ku kalova gjithë jetën time në burgjet e diktaturës dhe kampet e përqendrimit.

Ajo që vura re ishte se autori e ka trajtuar në mënyrë të detajuar luftën e klasave dhe vuajtjet që kanë existuar në atë kohë. Në një farë mënyre kjo gjuhë më ktheu dhe mua prapa në kohë për të rikujtuar të kaluarën time.

Në qendër të romanit është historia e një familje tipike te pasur shqiptare nga zona verilindore.

Por kur lexoj romanin kujtoj vuajtjet e familjes sime. Isha jo me shume se dhjetë vjeç kur mu pushkatua babai. Ai ka qenë intelektual dhe që ka kontribuar shumë për çeshtjen kombëtare. Kishte mbaruar për drejtesi në Perendim por diktaturës dhe diktatorit nuk i pelqenin njerzit e shkolluar. Në Tiranë ku ndodhej familja ime babai kishte vepruar si një rol model.

Familja ime ishte pjesë e njërës ndër strukturat drejtuese më të denjta që kishte deri në atë kohë vendi ynë. Prona sipas autorit është në qendër të koncepteve jetësore të njeriut, në qendrërn e instiktit jetesore te tijë dhe pa të njeriu nuk mund ta konceptoi jetën dhe të krijojë një vizion të jetës për të ardhmen. Kush më mirë mund ta menaxhoi pronën sesa pronari i saj? Kujt i djeg më tepër për mbarvajtjen, ecurinë dhe prosporitetin e pronenës sesa pronarit të saj?

Zhvillimi i pronës është barometri i mbarvajtjes së shoqerisë njerzore. Pa pronën nuk ka baze njerzore , nancionalizëm dhe pa elitën intelektuale që menaxhon këtë pronë nuk ka asnjë lloj nacionalizmi, dhe pa nacionalizëm nuk ka komb i tipit modern që të jemi të familjarizuar siç e kemi mësuar në librat moderne të shkollës.

Fatkeqesishtë të gjitha këto që u përmendën u realizuan në Shqiperi nga një regjim Sllavo-Komunist që u instalua pas luftës së dytë botërore dhe që kishte për qellim pikrishte nëpërkëmbjen dhe shkatrrimin e kombit shqipetarë.

Sllavo-Komunizmi e ktheu Shqiperinë në pronë të të gjithëve dhe të asnjërit në të njëjtën kohë, konceptin e Zotit dhe të Atdheut e zëvendësoi me partinë një emër asnjëanës që është i pa pranushëm e që mund të ndryshoi në kohë dhe të kthehet në vegël drejtuse te një grupi apo individi. Ky regjim erdhi në fillim me triska dhe perfundoi me tallona. Bëri që njeriut të ndershëm punetorë me iniciativë dhe i përkushtuar për të ecur përpara të mos i hapej rruga sepse ne krye të institucionve dhe digastereve drejtuese të jetës së përditshme do të infiltronin njerzë që ishin jo të aftë, servilë dhe immoral që për të mbuluar paaftësitë dhe të metat e tyre shkonin deri aty sa merrnin dhe shkatrronin jetë të tëra njerzish. Ky regjim e shkatrroi shqipetarin si materialishtë dhe moralishtë, i përkembi nderin dhe personalitetin dhe reputacionin e mirë qe kishte gëzuar më përpara në botë. Ky system i dështuar që u experimentua në shqipëri i hoqi asaj dalngadalë lëngun e jetës duke e transformuar në një trung të thatë në mes të një pylli të gjelbërt dhe plot me ujë. Këtë pejsazh paraqet edhe kopertina e këtijë romani.

Thjeshtë duke lexuar këtë roman mua me del komplet parasysh, mu ringjall në kujtesën time koha e kaluar me vështëristë e hidhura ekonomike të saj, me atmosferën e zymtë politike dhe ideologjike që ajo impunonte në mendjen dhe psikologjinë e njerëzve, çensura dhe frika se mos bëra ndonj gjë gabim ose thashe ndonjë gjë që s’shkon më ka ndjekur kudo gjate gjithë jetes sime. Kuptohet se ku ka njerzë ka edhe jetë dhe pavarsisht se sa e vështirë dhe e zymtë bëhet ajo, ku ka jetë ka edhe gëzime dhe momente të bukura që janë mekanizma të cilat asnjë dorë e hekurt njerzore nuk mund ti kontrollojë dhe frenojë dot sepse këto janë mekanizma që e bëjne jetën të shkoi në vazhdimsi dhe janë vetëm në dorën e krijusit të jetës. Edhe ne terrenet ne kushte më të egra klimaterike në tokë jeta do të triumfoi në një formë apo në një tjetër. Kjo është ideja pse autori e ka quajtu “Dritë nga Errësira”.

Duke lexuar këtë roman për jetën e Familjes se Ilirit ne nuk lexojmë thjeshtë pë tragjedinë e një familje fisnike nacionaliste dhe tradicionale shqipëtare por për tragjedinë e gjithë Shqipërisë në përgjithsi që ra viktimë e një sistemi Stalinist diktatorial që ishte bazuar në ide të pa qena dhe që u udhëhoq nga njerzë të pa aftë dhe mizorë. Kanë kaluar gati dy dekada që kurë komunizmi ka rënë por gjurmët që ai ka lënë prapa janë të thella në mëndjen dhe psilkologjinë e njerzve. Dhe ketu une dua te theksoi, ku qëndron thelbi i romanit që ka frymën e një rflektimi ndaj së kaluarës e që shfaqet që në faqet e para të tijë ku autori theksonse : Për të ndërtuar të ardhmen duhet lexuar e kaluara.

botime

Edhe romani “Pëllumbat e rrugës” ngre problematikat e mprehta individuale, shoqërore e metafizike, të cilat jepen përmes një *karnavalizmi* tabloid, të dhembshëm, por të shëndetshëm. Janë sëmundjet tona, të një shqërie që u ngrit nga koma socio-ideologjike dhe rend për t’u vetrealizuar me paranojat psikopatologjike të megallomanisë apo kompleksеve të thella inferiore; një panair i ekzistencën tonë ku ekspozohen simptomat e sëmundjeve vdekjeprurëse.

Ekzistenca shoqërore si **panair** dhe **karnaval**

Nga **AGRON TUFA**


Pëllumbat e rrugës është romani më i fundit i prozatorit tonë të njohur, Ramiz Gjini. I mëshojmë fjalës “të njohur”, jo në atë drejtim shpërdorues, sikundër keqkuptohet veprat e autorëve të përkëdhelur nga kompanitë multimediatike. Megjithëse romani i tij “Bibollasit” u shpall romani më i mirë i vitit 2009 dhe fitoi çmimin “Petro Marko”, Ramiz Gjini është një emër i ngulitur mirë vetëm në rrethet elitare të letërsisë, pasi parapëlqen punën e heshtur, larg bujës së përkohshme të promovimeve.


Ngjitja e tij letrare ka filluar në fund të viteve ‘90 dhe ka vazhduar deri më sot me një dyzinë vëllimesh me tregime (“Dush varrezesh”, “Këpucët e tjerëve mbi trotuar”, “Mendjet e njerëzve”, “Tregimet e Bibollit”, “Tregime në hije”), duke u prezantuar stilin e tij konçiz, dialogun e shkathët, të gjallë e dinamik, dhe metaforizmin përplot nënkuptime.

Romani më i fundit “Pëllumbat e rrugës”, vjen si përmbyllje trilogjisë groteske mbi një vend imagjinar sa edhe real, Bibollin, një provincë në Shqipërinë postkomuniste, po aq edhe kryeqytet i paradokseve, paranojës dhe megallomanisë, të përfaqësuara nga romanet “Rrëketë” (2007) dhe “Bibollasit” (2009). Pjesa e tretë e trilogjisë “Pëllumbat e rrugës”, është në të njëjtin stil grotesk, të njëjtët personazhe, të njëjtin topos, por në shkallë më të avancuar të sëmundjeve të postkomunizmit.

Romani ka disa pika të forta të tij, siç kemi bindjen, dhe pikë e fortë para së gjithash është uniteti, kompaktësia e linjës së rrëfimit ironik mbi Tushin dhe Lushen në sfondin e panairit grotesk të Bibollit gjithë personazhë *simulakër*, që përfaqësojnë instancat shoqërore e shpirtërore të kësaj topike të njohur tashmë edhe në dy romanet e mëparshme të autorit.

Të mbeten në mendje dialogjet ironike e me rimë nga idila pornografike e Tushit dhe Lushes, shpikja e gjuhës së onomatopeve, si siteme shenjore orientuese midis njerëzores dhe kafshërores. Autori ka rrokur me një theks





Romani më i fundit “Pëllumbat e rrugës”, vjen si përmbyllje trilogjisë groteske mbi një vend imagjinar sa edhe real, Bibollin, një provincë në Shqipërinë postkomuniste, po aq edhe kryeqytet i paradokseve, paranojës dhe megallomanisë, të përfaqësuara nga romanet “Rrëketë” (2007) dhe “Bibollasit” (2009).

Pjesa e tretë e trilogjisë “Pëllumbat e rrugës”, është në të njëjtin stil grotesk, të njëjtët personazhe, të njëjtin topos, por në shkallë më të avancuar të sëmundjeve të postkomunizmit.

të dyfishtë parodik aspektet diziologjike, që shkaktojnë një humor girgullues, një komicitet gogolian, për sa, siç dihet, që nga përkufizimet e Aristotelit, ekzistojnë dy zhanre: tragjedia, që përftohet si rezultat i kontradiksionit të Frymës dhe komedia, që përftohet si pëplasje kontradiktore e përmasës fiziologjike. Në romanin “Pellumat” e rrugës”, Ramiz Gjini ka mpleksur me shkathtësi e virtuozitet këto dy elementë, që prodhojnë situata të vazhdueshme tragjikomike, si në rastin e dashurisë, e cila duhet të kalojë përmes sprovës së epshit fiziologjik, si në rastet e tjera, kur përsonazhet përfaqësojnë, apo simulojnë “ide të larta”. Komizmi dhe ironia fuqizohen e kalojnë në grotesk të kulluar me faqet e përshkrimit të promovimit letrar të Aushit, ndërsa pika më kulmore dhe artistikisht më e veçantë është aventura deheroike e ringjalljes së shpirtrave me djegie në hundë. Është mënyra më e mirë e përmbylljes së një trilogjie mbi Bibollin me këtë roman. Lexohet me ëndje deri në fund, pa humbur interesin dhe kurreshtjen dhe në këtë pikëpamje shkon në harmoni me titullin “Pëllumbat e rrugës”, ku konotacioni ‘Pëllubat”, si gjë e urtë, e butë, paqësosore, përtallet dhe përbën paradoks me përkatësinë e tyre “rrugën”.

Dihet se ‘rruga”, “e rrugës”, të ngjall përfytyrimin e diçkaje që ka dalë duarsh, ka dalë nga kontrolli, shënon ligjet e egra të arbitraritetit, abuzimit, karakterit spontan e të pavarur. Në letërsinë tonë të sotme, bashkëkohore, nuk kemi ndeshur ende me nje projekt të përmbyllur suksesshëm të një trilogjie të romanit grotesk, siç janë tre romanet e Ramiz Gjinit.

Edhe romani “Pëllumbat e rrugës” ngre problematikat e mprehta individuale, shoqërore e metafizike, të cilat jepen përmes një *karnavalizmi* tabloid, të dhembshëm, por të shëndetshëm. Janë sëmundjet tona, të një shqërie që u ngrit nga koma socio-ideologjike dhe rend për t’u vetrealizuar me paranojat psikopatologjike të megallomanisë apo kompleksеve të thella inferiore; një panair i ekzistencën tonë ku ekspozohen simptomat e sëmundjeve vdekjeprurëse.

Grotesku i Ramiz Gjinit ngjit, para së gjithash, se është realizuar me sens elegant artistik, me një ironi e parodi që nërthen në flagrancë intimën dhe shoqëroren, duke hequr velin për shpalosjen e një perspektive të qorrsokakut, me bjerrjen e vlerave njerëzore.

Dhe është pikërisht kjo veti e transfiguruar artistikisht, që të fut në meditime të ngrysura, përmes një buzagazitë trishtë për konstruktin mendor e shpirtëror të bashkëkohësit tonë në raportet e tij etike me të tria rrafshet kohore: të shkuarën, të tashmën dhe projeksionin e së nesërmes.

Stil dhe **finesë**, **mrekulli** e prozës së shkurtër

Nga **AGIM BAÇI**

Një lëvizje dore, aq sa për të pulitur sytë. Por më pas, e gjithë qenia jote, mjafton të rrotullohet rreth atij çasti. Të tilla vijnë tregimet e Ramiz Gjinit, si një shigjetë, drejt e te Njeriu, i cili më pas duhet t’i bëjë vend brenda vetes gjithë atyre çasteve që e kërkojnë atë kudoqoftë ai. Gjini ka ndezur “kandilin letrar”, duke sjellë disa tregime që të mbajnë gjatë në melodinë e tyre, sepse e gjithë muzika kërkon shpirtin njerëzor, kërkon atë çfarë na shkakton lëvizjet tona të brendshme për të njohur vetveten, që na tërheq e na ndal përballë vetes dhe përballë tjetrit.

“Ne kishim të gjithë një kokë së bashku dhe e donim njëri-tjetrin ashtu siç e donte secili veten. Mendimet na puqeshin mrekullisht dhe flisnim të njëjtat gjëra njëherësh. Madje, ne shikonim të njëjtat ëndrra, dhe, kur ndodhte që i rrëfenim mëngjeseve, korrigjonim njëri-tjetrin për detaje të vogla që na shpëtonin pa i kallzuar. Ne i tregonim ato edhe pse e dinim, që të gjithë bashkë kishim parë të njëjtën ëndërr. E bënim këtë, thjeshtë, sepse ashtu na pëlqente. (Shkëputur nga tregimi “Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël”, përmbledhja “Rrëfime në hije”, f. 9)

Stuhia dhe fëshfëritja qëndrojnë bashkë, në një frymë, duke ardhur përmes një stili elegant, ku asgjë nuk qëndron tepër, e ku duket se fundi e fillimi janë thjesht për të ndalur takimin me tregimin



e radhës, por jo për meditimin që ai nis të krijojë në kokën tonë. Ka humor e ironi, por në asnjë çast dorëzim për jetën. Kur Lef Kuka, personazhi i tregimit “Frika”, nis e kupton se mospërballja në çastin e duhur kish shënuar vdekjen e tij më parë se të mbyllë sytë, është vonë. E për çfarë na duhet guximi nëse nuk mundëm ta përdornim atëherë kur ajo na u kërkua? Veçse të mbyllim sytë e të pranojmë që ajo, vdekja tjetër, e trupit, të vijë sa më parë, ashtu siç lutet personazhi i tij që pas mosguximit pa se kishte ikur nga kjo botë. Pas tij, personazhe të tjerë vijnë e trokasin në imagjinatë, për të ndërtuar njeriun, atë që s’ka rëndësi se ku jeton – në Tiranë, Nju Jork, Nju Dehli, Toldeo, apo në një fshat të Dibrës ku Elbaroza (personazh i tregimit “Dërgesa e Zotit”) mbetet hija e asaj apo atij që kemi dashur të qëndrojë krah nesh pafundësisht.

Mes së pamundurës për të ikur për më tej dhe së shkuarës mbeten gjithnjë labirinthe që kërkojnë përgjigje. Luis Medina, një personazh i përsëritur, është ai që kërkon ta ndalë kohën përmes dashurisë. E di që ajo është e vetmja kohë që mundet të mbetet ashtu siç e kemi dashur dhe e vetmja që na pranon ndonjëherë siç jemi kur trokasim në derën e saj.

“Tashmë që gjallnimi më ka lënë dhe drita e jetës ka ngelur si ajo xixa që sapo ka filluar t’i dalë fjolla e hollë e tymit, kam nisur t’i mas gjërat me një logjikë universale; ngase vdekja nuk më erdhi në kohën e duhur, ia kam kthyer asaj shpinën me zemërim e shpërfillje të plotë. Me aq frymë sa më ka mbetur, kam nisur çapitjen rrugës nga kam ardhur duke shkelur nëpër kohë gjurmëve që kam lënë”. (Shkëputur nga tregimi “Posta që sjell era”, përmbledhja “Rrëfime në hije”, f.20)

Loja me vdekjen, kujtesën, dashurinë, frikën, vijnë përmes një loje që të sjell ndërmend tregimtarët e ashtit, ata që kanë ditur edhe ta lexojnë por edhe ta porosisin “rrugën e njeriut”. Një vetëironi me një finesë Gjini e ndërton me shkrimtarin, në tregimin “Kur heronjtë flenë”, duke sjellë përballjen me botën “përmes shkopit kokës” – një metaforë e gjithë realitetit, të cilit duhet t’ia gjejmë anën që e rrok njerëzoren, atë që duhet të themi me zë të lartë për të tjerët e që ta mbajmë mend për veten.

“Ana Luigji”, personazh i tregimit me të njëjtin titull, sjell fytyrën që lë frika ndaj asaj që kemi paragjykuar, që ka lënë shenjën e së keqes e që na merr frymën edhe kur kërkojnë të na thonë se “ishte thjesht shaka”.

Ndërkohë që dashuria vjen e “nxjerr të shkuarën e paharruar”, si një mace e zezë, te tregimi “Gruaja e huaj”. Më pas “Ara e pakorrur”, “Shpirti i shtëpisë së vjetër”, “Lule në varrezë”, “Plagë lulezonje” vijnë e plotësojnë atë grafikë të rëndësishme mes botëve, duke e kërkuar atë që na duhet, që nuk fshihet as pas qepallës së mbyllur e as pas kohës së grisur në kalendarët e varur në mure.

Këto e një galeri personazhesh e skenash që të mbeten në mendje, për stilin dhe finesën, e sjellin Gjinin përmes 19 tregimeve me një forcë të jashtëzakonshme në mrekullinë e prozës së shkurtër. Aspak për të mbetur “rrëfime në hije.

Rruga e Arbërit nr. 114

Librat e Abdurahim Ashikut do të jenë të pranishëm
në Panairin e Librit në Peshkopi

emigracion

Në Rodos **mes dibranësh** e rrëfenjave me kolosë **të lashtë e të rinj**...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Rodosin me RYANAIR, një linjë ajrore me rregullin që të mos kesh me vete veçse një valixhe të vogël me rreth 10 kilogram peshë apo një çantë të përmasave mesatare, e kap për më pak se një orë me një kosto vetëm 10 euro plus se sa me tragetin që nisur nga Pireu arrin pas 21 orësh.

E vlen... Madje je me fat...

Veçse disa sende vetjake me gjatësi mbi 100 milimetra duhet të mos i marrësh me vete por t'i blesh atje ku shkon se sigurimi i aeroportit t'i hedh në kosh. Kështu më ndodhi mua me pastën e dhëmbëve dhe shishen e kolonjës dhe Natashës me tubetet e plazhit...

Frika se mos digjesh të bën t'i frysh fort kosit...

Jetojmë në një kohë kur hija që nuk na ndahet na duket ISIS...

Avioni, pas hovit mbi tokë u ngjit si zog mbi re. Re pupëlore siç i quajnë meteorologët që padashur nga zgjojnë nga thellësia e shpirtit, poezinë e vargjet rrjedhin si në kroje malesh mbërthyer poshtë e lartë pesë vijave me hieroglifët e çuditshme notash muzikore...

Tek xhami i avionit "zgjata" dorën të kap puplat e reve, t'i shtyjë pak majtas apo djathtas për të zhveshur vellon që mbulon ishujt, për të fiksuar pamjen e ishujve që nga larg, nga lart, më ngjajnë si farë e hedhur nga një dorë shpërndarësi të pastërvitur ugaresh të lashtë.

Androsin, Tinosin e Sirosin i dallova mes puplash "pulëbardhash". I dallova sepse kam qenë jo njëherë, kam mall e dashuri për njerëzit, për punën e tyre, veçanërisht për përkushtimin e tyre që t'u mësojnë fëmijëve të shkruajnë, lexojnë, e këndojnë në shqipen e nënës. Kjo në sajë të përkushtimit të çuditshëm atdhetar të mësuese Vera Shkurtit për të cilën kam shkruar se si i mblodhi 73 fëmijë të Tinosit për t'u mësuar ndarë në dy grupe, të shtunave dhe të dielave gjuhën e bukur shqipe dhe të enjteve kalon detin, për të bërë të njëjtën gjë me fëmijët e krye ishullit të Cikladeve, Sirosin, të njëjtën vepër rilindëse. Kemi bërë edhe një film dokumentar për Verën, film që i mungon pamja ajrore, hapësira midis dy ishujve. Këtë pamje e futa në shpirt...

Të tjerët më vijnë një nga një si thëngjij në prushin e ishujve të Egjeut deri në brigjet e Anadollit...


...Keas, Kithnos, Paros, Argos, Naksos, Amorgos, Astipalia, Kos, Tilos, Kerata...

Për ishullin e Kosit kisha lexuar, herët, para viteve nëntëdhjetë një roman emri i të cilit më ka ngelë midis emrave të librave të tjerë në bibliotekën e jetës sime në Shqipëri...

Për ishujt tjerë veçse kisha dëgjuar...

Pas rreth një orë fluturimi në vellon e reve u shfaq si një balenë stërmadhe ishulli i Rodosit.

Nga larg më tërhoqi gjelbërimi, një ngjyrë intensive që nuk e kisha parë në ishujt e Egjeut, aroma e të cilit do të më mbushte për pesë ditë mushkëritë.



Nuk u përmbajta. Nga dritarja e vogël e avionit bëra disa shkrepje në tërë gjatësinë e ishullit dhe, gradualisht me uljen e avionit në pjesë që mi merrnin e mi fiksonin pamjet...

Në ato lartësi, në atë shpejtësi lëvizjeje, me një aparat fotografik amator nuk mund të merrja më shumë se sa zbehtësi, mjegullim...

Në ditët në vijim në gji të ishullit, në gjoksin e lashtësisë, të së shkuarës dhe të së sotmes do të fiksoja e do të fiksohesha në kujtime të bukura...

MATULA BEACH HOTEL...

Një ulje e butë në një aeroport ku, siç do ta jetonim për pesë ditë, avionët uleshin e ngriheshin gati në çdo dhjetë - pesëmbëdhjetë minuta, avionë të vegjël e të mëdhenj që vinin nga të gjitha vendet e Evropës e të botës, bartës njerëzish që kërshërinë e tyre për legjendat dhe realitetet e kohës donin ta shuanin...

Zgjodhëm udhëtimin me taksi, udhëtimi më i sigurt kur je në një vend që nuk e njeh. Kthimin do ta bënim me linjën e urbanit Rodos-Aeroport, tashmë me një kulturë njohjeje modeste.

Hoteli ishte shumë pranë aeroportit...

Një hotel modest me tre yje por me një shërbim që meriton pesë yje. Një kënd i qetë në bregdetin verior të ishullit. Një pishinë, një gjelbërim intensiv bari për të cilin kujdesej një shqiptar...

Më poshtë një hotel i madh, i zhurmshëm, me salla të mëdha ngrënie e turistë që mbanin në



dorën e djathtë një byzylyk me numra e germa që flisnin në gjuhën e tyre...

Matula Beach ishte i përzgjedhuri i OAEDH-it këtë vit për kinonikoturizmo, turizëm social. Një e drejtë e çdo të punësuari për të pushuar një herë në dy vjet, pesë ditë, me shpenzime të shtetit. Një pagesë vetëm 60 euro për dy vetë...

Greqia, edhe pse në krizë, pas tre vjet ndërprerje, iu kthye traditës...

NJAZI ZEBI NGA USHTELENCA E DIBRËS

Rodosi, në mëngjesin e parë të jetës sime atje, më erdhi me rrezet e një drite që përtej rrezeve të diellit më solli rrezet e një miku dhe miqësie që të mbetet në shpirt përjetë...

Erdhi në ikonën e një dibrani, një ushtelencasi, krah për krah brezhdanasve të mi që tokat i ndan një gardh, një purent me kulemana a një meje are me kurorën e lartë të një arre, gështenje, ftoji, thane, pjergulle...dhe poshtë me një fushë të bukur, nga më të bukurat e vendlindjes sime, shelgjishtet dhe vërririshtet që me një hapje degësh të hedhin dallgëve të pastra të Drinit tonë...

Veshur me një kostum të bardhë, këpucë të bardha e borsalinë me të njëjtën ngjyrë, me një këmishë kopsat e së cilës mbylleshin në qafë nga një kollare kokëvogël më vjen Njazi Zebi, kavak i drejtë...

Ishte hera e dytë që takohesha me Njaziun.

E kisha takuar për herë të parë në Athinë mbi



një karrocë invalidi në qendër të Omonias...

Në Dibër nuk e kisha takuar, ndonëse ai kish pirë kafe e kish ngrënë bukë të ndorë me gjizë e vezë me tëlyen nga duart e nënës sime që e mbante në kujtesë e e përcillte me gojë si një gjë të bukur në takimet e jetës së tij me njerëz...

Me shumë njerëz, bashkënxënës të tij në shkollën tetëvjeçare të Brezhdanit e nxënës e kolegë në shkollën e mesme në Lunarë të Katër Grykëve të Murrës...

Një ditë më parë, më 6 korrik 2014, ndërsa nisej me traget nga Rodosi, ai më shkruante nga



adresa e tij në face book...

Tungjatjeta! Do t'ju tregoj një ngjarje që do çuditesh.

E bëj për parapërgatitje.

Isha në Peshkopi, vajta edhe të shoh një shok dhe të hamë bukë ke Bajraktari, në pazar poshtë.

Brenda, kur hyra, në tavolinën e dytë nga penxheret, ishte ulur Luan Fiqiri Begu. Jemi birazela.U kënaqa që e pashë.Me gëzim u turra ta takoj e përqafoj.

Ai më përshëndeti nxehtë, por nga vendi s'luajti.

Unë më i madh, kisha emigruar, po dhe pleqtë birazela nga ana ime më të mëdhenj. Ai s'luajti ndërkohë që unë hyra. Më ngeli qejfi sa u bëra pishman se e ta kova.

U ula,si me më pas ngrënë magjari bukën.

Kam një të metë që kur më duket se kam të drejtë me hynë mizat.

Kur në të djathtë pashë dy shkopinj të sakatit në tokë u drodha.

"Ç'i ke ata shkopinj?" - e pyeta

"Ah, or birazel, jam paralizuar ka..."

Se desha veten,nuk desha si ta sjell muhabetin. Nejse e rregullova...

Në se gjendemi afër, mos u çudit.

Jam mbi katër rrota karroce, ανάπηρου (invalid).

Lëvizi lirshëm. Ia kam marrëdorën...

...Në pesë ditë qëndrime dhe udhëtimesh nëpër ishullin e Rodosit, madje edhe në kalimin nga kontinenti evropian në atë aziatik, Njazi Zebin do ta kisha pranë.

Kallauz të tillë në udhëtim nëpër një vend të panjohur, përshkrues të gjallë të natyrës, vendeve, njerëzve, bukurisë dhe dhimbjes mërgimtare, vështirë, në mos e pamundur të gjesh...

Njazi Zebi na mori si fëmijë për dore për të zbuluar bukurinë njerëzore të mërgimtarit në një ishull të largët të Egjeut, vetëm "një pash" larg kontinentit tjetër

LINDOSI DHE...HURDHË MUHURRI...!!!


...Lindosi është një vend i bukur, një vend ku nuk mund të mos udhëtosh drejt tij, të rrokësh me sy gjirin e bukur e të ngjitesh si në Leqet e Valit të Martaneshit zigzagëve...


E ndërsa ngjiteshim me hapa të lodhshëm Njaziu ma mori kujtesën ta përcjellë të përpjetës plot dredha të Hurdhë Muhurrit...

Një ngjitje me kokën pas...


Vijon në numrin e ardhshëm

Athinë, maj 2015






Librat e Naim Berishës mund t'i gjeni ne Panairin e Librit ne Peshkopi 28-31 tetor 2015
ose ne Panairin e Librit ne Tirane ne Pallatin e Kongreseve, date 11-15 nentor 2015.













Muhurri dhe Shqipëria në 100 këngët e mia

Nga **NAIM BERISHA**

"MUHURRI DHE SHQIPERIA, NE 100 KENGET E MIA" është libri i një vështrimi më të gjërë panoramik mbi vëndlindjen time, MUHURRIN dhe gjithe atdheun tim te dashur, SHQIPERINE, përmes këngëve epiko-lirike, që i bëjnë jehonë historisë dhe të sotmes së tij, nje qind këngë, të zgjedhura nga tre qind të tilla, të cilat i kam krijuar kohë pas kohe, përgjatë gjithë jetës sime të deritashme.

Libri hapet me ciklin "Për ju këndoj" titulli i albumit tim të parë, që përbëhet nga dhjetë këngë të krijuara nga ana ime, si tekstet dhe melodité, njëherësh, janë të kënduara po nga unë, orkestruar nga kompozitori i shquar, EDMOND ZHULALI, produkt i shtëpisë diskografike "ELRODI MUZIKE", Tirane 2011. Nga dhjetë këngët e albumit tim të parë "Për ju këndoj" album i cili është në treg si në Shqipëri dhe jashtë saj, vetëm tri këngë janë bërë, deri më tani, vidioklipe, të cilët, edhe këto, janë realizuar nga shtëpia diskografike e sipërpërmëndur.

Më tej, mendoj se me interes është cikli "ARBERIA ", ku përfshihen këngë epiko-lirike të një atdhedashurie të zjarrtë, siç janë ato për flamurin, për Skenderbeun, për Shqipërinë, etj. Pastaj vjen cikli "MUHURRI NE KENGE", me epikën dhe lirikën, të cilat jam rrekur t'i interpretoj nën fokusin e një drite të re bashkëkohore. Dhe, më në fund, librin e përmbyll cikli " TEKSTE PER KENGE TE MUZIKES SE LEHTE", në të cilin përfshihen njëzet e pese poezi, të cilave ua kam shkruar dhe muzikën, por që, ende, s'i kam publikuar .

Përmes këtij libri me këngë,kryesisht, për vëndlindjen time, MUHURRIN, por edhe për DIBREN dhe gjithë SHQIPERINE, kam dashur dhe dua të përjetësoj bëmat, traditën e luftës së drejtë e vetëmohuese të popullit tone në shekuj për liri, flamur, gjuhë e çlirim kombëtar. Në focus, kryesisht, është MUHURRI, i cili, mendoj se është lënë, disi, jo krejt pa qëllim, në hije dhe harresë. Kjo,herët e vonë, them se ka ardhur nga xhelozia, cmira dhe zilia për të, si dhe për njerëzit më në zë të tij, të cilëve, (respektivisht në kohë të tyre) zor se mund t'u gjesh ekuivalentë gjetkë.

Si njëri prej Nënte Maleve më prestigjiozë të Dibrës, Muhurri ka një histori për t'i pasur zilinë. Muhurraket jane autoktonë në trevën e tyre qysh në lashtësi. Mjafton të përmëndim toponimet e njohura të antikitetit, si: "Gjyteza", "Kodra e Gjytezes", "Majëgjyteza", "Shmitrat e Gjytetit" , "Hurdheqytezë", e tjerë, në Hurdhe-Muhurr, si dhe " MASREKAT" , "SHGJERTHI", "MARANICAT", "KRONI I GJYTETIT" "mal ii Shënmrisë", e tjere, në Fushë-Muhurr. Populli i Muhurrit ka bërë luftëra legjendare, historikisht, kundër armiqve më të egër të këtij kombi, si kundër



turqve, sërbit, nemces, malazesëve, bullgarëve, italianëve, gjermanëve, etj, por, asnjëherë, nuk u fol dhe nuk u shkruajtë për të. Ai ka gëluar, historikisht, nga këngët e veta, që i kanë bërë jehonë luftës dhe qëndresës së tij kundër rrebesheve të jashtme dhe të brendshme, por, asnjëherë, kënget e tij nuk e panë dimensionin kombëtar, madje, as atë vendor.

Muhurrakët, herët e vonë, janë shquajtur në Dibër e më gjërë, për burrëri, bujari, trimëri të pashoqe e, sidomos, për urtësi e mënçuri, por askush nuk iu "këndoi " atyre, kur në gjthë Dibrën, këngë, ditirambe dhe pandigjirike thureshin pa pra, në mënyrë të përsëritur, deri edhe për njerëz të dyshimtë e të pabereqetë.

Ja si glorifikohet kryekreshniku i Muhurrit, Dine Hoxha, në këngën e vjetër muhurrake, "NUK DI MUHURRI ME U KORIT", (këngë e cila asnjëherë s'i kaloi kufijtë e Muhurrit) teksa u flet luftetarëve muhurrakë përpara se të nisë beteja me pushtuesit serbë.

-Degjoni vllazën muhurrakë
Sërbi po na shkel në prag
Sot o kurrë të derdhim gjak ....

Dhe, më tej, për t'u shpërfaqur figurën e Skenderbeut si një burim të pashtershëm frymëzimi për luftën që do të ndizej vetëm pas pak, ai me fantazi dhe finesë të pazakontë, iu kujton muhurrakëve se vendlindja e tyre është vëndorigjina e Skenderbeut:

"... Se Masrekat tona
S'pari, herët, qëmotit
Kanë qënë troje të Kastriotit
Vonë u shtri në Shgjerdh e Sinë

Ku dhe lindi Gjergji ynë ... (është fjala për Masrekat dhe Shgjerdhin në Fushëmuhurr)

Pra, të bëjmë gajret
T'luftojmë me nder
Dhe trimëri si dikur
Skenderbeun kemi fener
Skenderbeun kemi flamur!

Dine Hoxha e dinte këtë të vërtetë historike se "Masrekat" janë vëndorigjina e parë e Kastriotëve, e dinte nga pararendësit e tij. Gojë me gojë e brez pas brezi kishte ardhë kjo e vertetë e pakontestueshme gjer në ditë të sodit, e vërtetë e madhe, që bën krenar çdo muhurrak.

Meqë ra fjala, mund të them se nuk di ndonjë studiues dibran, që në studimet e tij, ta këtë përmendur këtë të vërtetë historike, qoftë dhe kalimthi, kur studiues të huaj, jo rrallë, e kanë cituar emrin e tij duke i shtuar përcaktorin "Masreka" (përcaktorin me drejtim, siç quhet në sintaksën tone gjuhësore) GJERGJ KASTRIOT MASREKA(U), (emër i marrë nga plangu nga vinte, pra, nga Masrekat e Muhurrit, fjalë që në shqip do të thotë "mbas lumit" dhe, vërtet, ato janë mbas lumit "Murra", toponim i gjallë historik i lashtësisë, vëndbanim ilirësh deri në mesjetë, vënd që po ta shohësh edhe me syrin e një ushtaraku,të bindë, ngase është i mbrojtur me kodra ose, më saktë, me male të vegjël nga të gjitha anët, me lumin, bjeshkën, krojet, livadhet, gurrat e burimet, me tokën bujqësore, fare pranë ose, siç thuhet në kësi rastesh në të folmen krahinore, pra, të trevës së Muhurrit, përakollës ...)


Historiografia dibrane, si me thënë, nuk ka dashur dhe, ende, nuk do që "t'i vijë" Dibrës dhe Shqiperisë ndonjë e mirë nga Muhurri. Ndryshe si mund të shpjegohet që asnjë studiues dibran nuk përmënd as kalimthi (përveç ç'thamë më sipër) as dy emrat e dy vëllëzërve legjendarë Dhimitër dhe Nikollë Berisha, dy djemtë e vetëm të motrës së madhe të Gjon Kastriotit, MADHES, dy bashkëmoshatarët, dy kushërinjtë e parë të heroit tanë Kombëtar, dy gjeneralët e Skenderbeut, "ndihmën e të cilëve,- siç thotë Barleti dhe Noli,-Skenderbeu e kishte të dëndur dhe të shënuar". Çfarë cinizmi ndaj Muhurrit dhe, njëherësh, ndaj BERISHVE të MUHURRIT, të cilët, në të vërtetë, janë të vetmit në Dibër, të njohur me fakte historike, si pasues te drejtpërdrejtë të gjakut mbretëror Skenderbegian. S'po zgjatem këtu, sepse dy vëllëzërit BERISHA në fjalë, si një rast unikal në periodën më të ndritur të historisë shqiptare, siç është ajo skenderbegiane, më në fund, patjetër që kërkojnë një libër më vete.


Dibra do të ishte shumë më e përparuar, po të mos e kishin munduar aq rrekshëm të ashtuquajturat, dibranizma, përndryshe "izmat e zeza"! Një (ar)mik ka shkruar, tani vonë, si shumë të tjerë më herët, në një libër paçavuresh, "se Berisha i Muhurrit e tradhtoi Skenderbeun dhe ky e nëmi atë, që të mos bëhet kurrë as tri shpi ...". Paçavurëshkruesi, duke menduar se po e diskrediton Berishën, njëherësh, dhe Muhurrin, pa dashje, e ngre atë aq lart ashtu siç, në të vërtetë, ai e meriton."Gojëdhëna,- shkruan ky (ar)miku më tej, - e pranon se Berisha i Muhurrit, vërtet, qe byrazer i Heroit Kombetar, (pra, me lidhje gjaku"NB") por ky, më në fund, e tradhton Skenderbeun" . I themi këtij (ar)mikut, se po ta kishte tradhtuar Berisha Skenderbeun, atëherë Berisha jo vetëm që s'do të ishte sot mbi njezët shtëpi, (ku shtatë prej të cilave janë vetëm në Londër) por nuk do të ekzistonte asnjë Berishë i Muhurrit në faqe të dheut, sepse Skenderbeu do ta kishte zhdukur, vrarë, burgosur a internuar Berishën, siç pati bërë me të tjerë të afërt, si përshembull me djalin e vëllait, me Hamzë Kastriotin. Por rrjedha e ngjarjeve tregon të kundërtën, siç e ka pohuar dhe vetë Skenderbeu, se Berisha qe, gjithmonë, fort besnik i Tij. Për të injoruar paçevurëshkruesin, le të sjellim një pasazh të Historisë së Skenderbeut shkruar nga Barleti e përsëritur në ligjeratë të drejtë nga Noli:


"Nga dëshpërimi për rënien e Beratit, Skenderbeut, (i cili, nderkaq, po kthehej nga Tepelena ku kish vizituar punimet në ndërtimin e atjeshëm të një kalaje,NB) iu ça buza e poshtme dhe po i pikonte gjak. Si të mos mjaftonte kjo humbje e madhe, sakaq, mori lajmin se kishte tradhtuar dhe Moisiu i Dibrës. Dhëntë Zoti, tha Skenderbeu, të mos këtë tradhtuar gjithë ushtria dibrane. Por kur bariti fluturimthi në Dibër, pa se ushtria dibrane ishte po aq besnike sa dhe më parë, nën komandën e dy vëllezërve, Dhimitër dhe Nikollë Berisha".


Çfarë cmire! Kur mendon se Nikollë Berisha ishte njeri nga tëtë gjeneralët e Skenderbeut, (përkrah Moisi Golemit dhe të tjerëve), të cilët u morën peng në Vajkal nga Ballaban Pasha, tradhtari shqiptar me damkë të zezë që i printe ushtrisë turke dhe Sulltani , siç dihet botërisht, i ropi të tetë të gjallë, i bëri copë-copë dhe copat e mishit të tyre ua hodhi qenve të Stambollit!

Pa folur pastaj për Dhimitrin, vëllanë e madh të NiKOLLE BERISHES, i cili, sidomos, pas fundit të tmerrshëm tragjik të vëllait, NIKOLLES, pati shkëlqyer më shumë se më parë, në çdo betejë Skenderbegiane dhe qe shpallur vazhdimisht nga Skenderbeu si "kryefitonjësi i disa viktorjeve të mëdha". Këto të vërteta, përveç paçevurëshkruesit në fjalë, nuk i dinë dhe të tjerë që s'kanë haberin rreth MARIN BARLETIT, FAN S.NOLIT si dhe historianëve të huaj, të cilët edhe këta, njësoj si Barleti dhe Noli, i përshkruajnë Berishët si njerez shumë të afërt të Skenderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij. Sa mirë, them me vete, nganjëherë, që Barleti dhe Noli nuk kanë qënë dibranë!
















"Të lutem trembu sonte për mua"

Edmond Hasani ndryshe nga rrjedha e botimeve tradicionale, preferon që botimin e tij ta publikojë së pari në Amazon.com.

Libri "Të lutem trembu sonte për mua" gjendet që nga 17 tetori në faqen online të Amazon për një çmim prej 7.20 USD.

Libri është një përmbledhje me rrëfime groteske që përmes frikës, dashurisë, sarkazmës dhe humorit të hollë e çojnë lexuesin në labirinthet më absurde të fateve njerëzore. Një amalgamë e përvojave personale të narratorit me pjesën e padukshme të psiqikës njerëzore për të cilën ne gabimisht mendojmë se nuk ekziston.

Për lexuesit në Shqipëri libri do të dalë shumë shpejt nga shtypi, ndërsa për ata që shfrytëzojnë Amazon për blerjet online mund ta bëjnë atë që nga ky çast, mjafton të klikoni në linkun e mëposhtëm:

http://www.amazon.com/LUTEM-TREMBU-SONTE-PER-MUA/dp/1518647324

"Urtësi nga Bulqiza"


Nga **DESTAN RAMA**

Tek po lexoja librin "Urtësi nga Bulqiza" të autorit Jorgo Kola, që mua më pëlqen ta quaj profesor, pasi ka dhënë një kontribut të madh në arsim si mësues në shkollën e mesme të minierave në Bulqizë, po ashtu ka edhe një veprimtari mjaft të pasur letrare dhe shkencore, ndonëse profesioni i tij i mirëfilltë është ing. gjeolog. Edhe mua m'u duk vetja për momentin sikur jam në mes të popullit tim duke biseduar me të për problemet hallet, merakun a shqetësimet që ai ka pasur gjatë jetës së tij në vite, ndoshta në shekuj. Më rezultoi se ai ka pasur shumë nga këto probleme gjatë gjithë veprimtarisë jetësore, probleme dhe shqetësime nga më të ndryshme, si; për Atdheun, për jetën, punën, minierën, zanatet, fjalën, dijen, miqësinë, dashurinë, martesën, fëmijët, pleqërinë, moralin, biznesin,të drejtën,shënndetin deri edhe për politikën.

Të gjitha këto populli i fokusoi në thënie të bukura e të mençura me kuptim alegorik, i fshehu thellë brënda shpirtit të tij, i përdori ata kur ia lypi nevoja dhe i transmetoi në breza.

Profesor Jorgo Kola, si njohës i mirë i shtresave nëntokësore, por edhe njerëzore, si një psikolog i regjur, me durim, këmbëngulje, urtësi e pasion hyri thellë në shpirtin e njerëzëve, bisedoi me ta,





duke i takuar në shtëpi, në punë, në lokal e kudo, në një limit kohor prej 12 vitesh, voli ashtu siç vilet në shtresat nëntokësore, minerali i çmuar deri në 10 mijë fjalë të urta popullore.Punoi shumë me fjalën, e përpunoi atë nga ana artistike, duke i ndarë ata në kapituj të veçantë sipas përmbajtjes, në përgjigje të problemeve a shqetësimeve të cituara më sipër. Me gjithë këtë pasuri të madhe që mblodhi në shportën e tij shkroi librin: "Urtësi nga Bulqiza" dhe ia dha në dorë të gatshëm lexuesit. Ky libër përbën në vetvete një thesar me një vlerë të pallogaritshme, është një pasuri e pashtershme e brezave.


Me profesor Jorgo Kolën, që erdhi nga Gjirokastra në shkurt 1960 si ing.gjeolog, krenohet Bulqiza, familja, shoqëria dhe mëgjerë. Ai u dashurua me minierën e Bulqizës që në vitet e rinisë së tij, nuk e tradhtoi kurrë atë. Zbuloi nga nëntoka e saj thesare dhe po i jep thesare mbitokësore. Për punën e shkëlqyer të bërë si intelektual, si kuadër, si publicist, si shkrimtar është nderuar me Urdhërin e Punës të kl.III dhe Urdhërin per Shërbime të Shquara në Minierë e Gjeologji të Kl.II e të Kl.I.


MË 2008 u shpall "Qytetar Nderi i Bulqizës". Ka botuar librin: "Marrja e përpunimi i provave në minierë", më 1982, dhe tani librin: "Urtësi nga Bulqiza".Ka në plan nga studimet e tij, që edhe në të ardhmen të botojë libra të tjerë, duke sfiduar moshën. Lexuesit dhe fansat e tij i urojnë profesorit shëndet të plotë, mendim të kthjellët, majë pene të mprehtë dhe sa më shumë thesare.

Libra që mund t'i gjeni në Panairin e Libri në Peshkopi









Antologji poetike me autorë matjanë

Matit, kësaj treve me histori të lashtë, djep i kulturës dhe i artit kombëtar, që nga Pjetër Budi e brez pas brezi, nuk i ka munguar fjala poetike. Madje poezia shqipe nis me Pjetër Budin e Gurit të Bardhë të Matit.

Më 1969 është botuar, së pari Almanaku "Mati", me krijime të rrethit letrar të atëhershëm, ndërsa Antologjia e parë poetike, me krijime të periudhës kohore 1618-2003, është e vitit 2004. Këtë vit u botua Antologjia e re "Udhëtare me pranverën", përgatitur nga Hamdi Hysuka, ku zënë vend e bashkëjetojnë me krijimtarinë e tyre gjashtëdhjetë e shtatë autorë, 22 prej tyre femra.

Në këtë përmbledhje poetike spikasin breza poetësh, që nga të para viteve '90 e deri te brezat më të rinj, me prirje e formim të ndryshëm, që janë paraqitur përpara lexuesit me libra të vlerësuar me çmime letrare, si Hysni Milloshi (që nuk jeton më), Rakip Lasku, Basir Bushkashi, Hasan Huta, Sami Milloshi, bilbili i melodisë matjane Sabri Aliaj etj. Pjesë integrale e poezisë matjane janë dhe Fatmir Alimani, Naim Berisha, Kolë Ndreka, jo vetëm pse nisën krijimtarinë në trevën e Matit, por se me poezinë e tyre, me libra e tekste këngësh, pasuruan pentagramin shprehës të poezisë, duke e shndërruar Matin në një ishull të fjalës poetike. Vijojnë më tej një grupim autorësh që veçohen pas viteve '90, si Albert Nikolla, Kujtim Stana, Hamdi Hysuka, Fatmir Gjestila, Çezar Rica, Simon Kaca (që është ndarë nga jeta), Qemal Cenaj, Erina Çoku, Halit Çitozi, Anila Xhekaliu, Fatmir Neli, Lindita Doda, Jolanda Lila, Valentina Kurti, Shefqet Merra, Xhavit Gasa, Elsa Cenaj, Emrie Krosi, Adriatik Doçi, Adivie Hoxha, Fato Male etj, për të ardhur deri te botimet e para të nxënësve të shkollave të mesme të Burrelit.

Botimi i kësaj antologjie me autorë matjanë e ka dhe qëllimin e madh: vendlindjen e poetit të parë të letërsisë shqipe, pararendës i Rilindjes sonë Kombëtare, ta kthejë në një ditë të poezisë së të gjithë poetëve, festë të vërtetë poetike. Veprimtaria artistike e përvitshme "Sofra e trashëgimisë poetike", e javës së fundit të çdo muaji tetor, afirmon vlerat krijuese, i shndërron ato në veprimtari të mirëfilltë letrare mbarëkombëtare, me pjesëmarrjen e poetëve nga Mati e gjithë Shqipëria, shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi.

Në kërkim të vlerave, Antologjia "Udhëtim me pranverën", i kalon kufijtë territorialë të Matit, është bashkudhëtare kohësh dhe ka kaluar në pronësi të lexuesve.

Hamdi Hysuka

Shkëputur nga libri i Naim Plakut
"Krojet e zanave"

Dasma dibrane një spektakël i mrekullueshëm



Naim Plaku u lind në Sllatinë të Dibrës më 1940. Në vitin 1958 mbaroi shkollën e mesme të mësuesisë në qytetin e Peshkopisë dhe shërbeu si mësues në shkolla të ndryshme, ndërkohë që kishte mbaruar studimet e larta me korrespondencë për gjuhë dhe letërsi shqipe. Vitet e fundit ka punuar në shtëpinë e kulturës "Haki Stërmilli" të Peshkopisë.

Si mësues i pasionuar dhe i talentuar dha një ndihmesë të çmuar në përmirësimin e nivelit të mësimdhënies në lëndët e gjuhës e letërsisë shqipe në shkollat tetëvjeçare e të mesme në nivel kombëtar, duke botuar në periodikët pedagogjikë të kohës artikuj studimorë e trajtesa të veçanta për problemet e gjuhës letrare shqipe në shkolla. Shkolla e mesme e Sllovës, ku ai shërbeu shumë kohë, u bë një qendër e rëndësishme metodike për përhapjen e përvojës së përparuar, që u finalizua me zhvillimin e seminarit kombëtar "Gjuha letrare shqipe në shkolla" nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.

Duke qenë bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Kulturës Popullore dhe Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë ka dhënë një kontribut me vlerë në mbledhjen e studimin e folklorit letrar, të leksikut dhe dialekteve të shqipes duke botuar edhe disa artikuj në revistat "Studime filologjike", "Gjuha jonë", etj.

Për vite me radhë ka qenë i përfshirë në organizimin dhe ndërtimin e veprimtarive kulturore e artistike, duke ushqyer e ndihmuar me materiale letrare grupet artistike, folklorike, Ansamblin, Estradën e Peshkopisë, etj.

Ka botuar:

Fllad e Frullizë - Poezi, 2006

Kreshtat e Korabit - Poemë, 2006

Po të mos ishte Drini... - Urtësi dibrane, 2008.


Dasma dibrane është në tërësinë e saj një spektakël i mrekullueshëm i mbushur i tëri, për në kohë relativisht të gjatë (që nga fejesa e deri në shpërndarjen e dasmorëve), me zhvillime e rite që shoqërohen me një varg këngësh, vallesh, lodrash, zakonesh e veprimesh, që vijnë duke u rritur e që arrijnë pikën kulmore me ardhjen e nuses në shtëpi. Kjo lidhet me rëndësinë që kishte martesa për dibranin, e cila është konsideruar e trajtuar gjithnjë si një lidhje e shenjtë mes burrit e gruas, duke marrë një rëndësi të dorës së parë në jetë. Kështu mund të shpjegohet gjithë kjo krijimtari e pasur poetike e artistike, duke u trashëguar nga brezi në brez e duke u pasuruar në vazhdimësi.

Dasma në tërësi ka një zhvillim të natyrshëm, një ndërtim të detyruar brenda një kornize ritualesh të detyruara, një kompozicion të qartë artistik, që vërtiten rreth dy personazheve kryesorë, dhëndërit e nuses. Nga zona në zonë, brenda krahinës së Dibrës, ashtu si edhe në të folme dhe në etnokulturë, veshje, zakone, rite, etj., ka disa ndryshime jo thelbësore, prandaj jemi munduar që të sjellim materialin folklorik më tipik, më përgjithësues të trevës.

Dasma dibrane kalon në disa momente:

1. Forcimi, fejesa apo vlesa. Në Dibër është quajtur diku – diku edhe vlim. Fejesa bëhej me shkuesi, por parapëlqehej njohja e dy të rinjve. Shkuesi shkonte në shtëpinë e vajzës, *shpupurishte me mashë hirin e vatrës* dhe i thoshte të zotit të shtëpisë se kush e kishte dërguar atë për ta bërë mik. Shkuesi ishte personi ndërmjetës, që *këpuste fjalën* te familja e cucës, merrte nishanin, që ishte zakonisht një shami dhe e dërgonte te familja e djalit. Porsa të mbërrinte nishani, njëri nga të familjes shkrihte një pushkë, që ishte njëkohësisht dhe lajmi se i biri i kësaj familjeje zuri nuse, u fejua apo u vlua, u forcua apo që dy të rinjtë tashmë ishin ndër shenja. Shtrohej një darkë e këndohej, kërcehej e luhej në vijimësi. Tashmë vajza e djali ishin të fejuar, *se ishin ndërshenja*.

2. Dita e Çerepëve. Është një ditë që caktohej nga familja e dhëndërit, gjatë muajve të verës, meqë dasmat bëheshin zakonisht në vjeshtë. Në Qidhën, Reç-e-Dardhë, në Katër Grykë, etj., parapëlqehej që dasmat të bëheshin Ditën e Shmrisë, që binte nga fundi i muajit gusht. Ishte një traditë e kahershme, si duket, që lidhej me të kremtat e krishtera. Kjo ditë kishte ritet e veçanta që praktikoheshin më shumë nga të rinjtë e të rejat, nga mëngjesi gjer në darkë. Ata mblidheshin dhe niseshin duke kënduar e luajtur, nxirrnin në një vend të caktuar argjilin dhe me to, disa nga



gratë që ishin praktikuar në punë të tilla, përgatisnin çerepët, ku do të gatuheshin bukët e dasmës dhe topat e argjilit, ku vendoseshin tepsitë për gatimin e petëve, byrekëve, flive, etj. Pjesëmarrësve u shtrohej një drekë. Ky rit, që, siç duket, është shumë i lashtë, praktikohej gjer vonë në Ujemujë, në Zall-Dardhë, Reç, Lurë, etj.

3. Kumtëria, Oroku ose caktimi i ditës së dasmës. Kur afrohej vjeshta, bëheshin dhe përgatitjet e dy palëve për dasmë, intensifikoheshin bisedimet e marrëveshtjet mes palëve, përfundonin detyrimet që kishin ndaj njëra-tjetrës. Në disa zona si në Qidhën, Muhurr, Dardhë, etj., dasma bëhej Ditën e Shmrisë, që binte aty nga 22 e 23 gushti. Kjo ishte dita më e parapëlqyer ndër malësorët, ndërsa në fshatrat e Mbirrugës së Pazarit, në ato të Fushës (Maqellarës) dhe të Bulqizës, Gollobordës, bëheshin nga tetori e deri në mesin e janarit. Kjo kushtëzohej nga një sërë faktorësh ekonomikë, nga mbledhja e prodhimeve dhe zbritja e gjësë së gjallë prej bjeshkëve, nga kthimi i kurbetlinjve, etj. Disa javë para dasmës nga pala e dhëndërit shkonin në familjen e nuses dhe bënin bisedimet e fundit, caktonin ditën e dasmës, e cila nuk mund të lëvizte në asnjë mënyrë. Pala e nuses bënte kërkesat e fundit, që e detyronin palën e dhëndërrit t'i përmbushte, ndryshe dasma shtyhej për vitin tjetër. Kjo gjë ndodhte rrallë, se quhej turp të shtyhej dasma për pamundësi të përgatitjes nga ana e dhëndërit. Në shumë zona, sidomos në banorët e Maleve, detyrimet kanë qenë tepër të rënda, që shpeshherë sillnin rrënimin ekonomik të familjes që merrte nuse. Detyrimet ishin në të holla, në bagëti, në veshje e pajisje të tjera. Por edhe në zonat e Fushës dhe të Mbirrugës kishte plot detyrime, që, për sedër, ishin detyruar t'ia plotësonin mikut kërkesat. Prandaj, kjo marrëveshje, që bëhej në prag të dasmës, është quajtur edhe *prerje këpucësh, prerje kundrash*. Kishte plot raste, kur miqësia ishte e sinqertë, që miku mikun nuk e rëndonte dhe as nuk e ngacmonte fare, nuk e detyronte për asgjë, por e linte në mundësitë e vullnetin e tij, e linte *të lirë në dorë të mikut*.

4. Dita e Blojes. Bluarja e drithit në mulli bëhet të enjten ose të dielën e *Natës së Farës*. Caktohen një ose dy djem me prindër gjallë dhe, pasi ngarkojnë kuajt, nisen për në mulli sa të bjerë dielli i mëngjesit. Mbi samarin e kuajve vihet nga një degë e gjelbërt peme. Njëri prej tyre duhej të mbante pushkë. Ai, në të nisur, e shkepte njëherë në ajër për të ndjellur mbarësi, ndërsa gratë i përcillnin me këngë. Po kështu, me këngë i presin edhe kur kthehen nga mulliri.

5. Nata e Farës (tek dhëndëri). Nata e bojës (tek nusja). Është një ndër pikat kulmore të dasmës. Nata e Farës, quhet kështu, te dhëndëri, sepse atë natë zihej fara për të gatuar bukët e dasmës, pasi kishte mbërritur atë ditë mielli i ri i bluar, posaçërisht për këtë natë. Në shtëpinë e nuses kjo quhet *Nata e Bojës*, sepse vajza bëhet nuse, vë kanën në flokë e thonj, vë të kuq në buzë, bën tualetet e domosdoshme për një nuse, se të tilla zbukurime i privoheshin tërësisht në vajzëri. Dasmat në Dibër janë bërë gjithmonë në ditë të diela e të enjte, kështu që Nata e Farës dhe e Bojës bëheshin të enjten ose të dielën mbrëma. Këtë natë zakonisht grumbulloheshin njerëzit më të afërt të familjes, si vëllezër e motra, daja, halla, teze, kushërinj, etj., të paftuar, por me një farë detyrimi që kishin për të nisur dasmën. Pas darke grumbullohej tërë fisi, dhe, përveç riteve të shumta që praktikoheshin, ndaheshin dhe detyrat, caktohej drejtuesi i dasmës, e zonja e dasmës, që quhej *magjatore,* hyzmetçinjtë e konaqeve, akçinjtë, që do të përgatitnin ushqimin, shërbyesit e shërbyeset në konaqet e burrave e të grave, kafexhinjtë, grishtarët, pritësit e përcjellësit e dasmorëve e plot detyra të tjera deri në imtësi. E zonja e shtëpisë zinte brumin, të cilin e përziente dhëndëri me tytën e pushkës dhe e plaste diku në oborr i rrethuar nga të rinjtë moshatarë. Tregoheshin rrobat, bizhuteritë dhe çdo gjë tjetër që pala e dhëndërit kishte përgatitur për nusen, sipas detyrimeve që ishin përcaktuar *Ditën e Kumtërisë*. Tek nusja ylldisej paja dhe u tregohej të pranishmëve nga një grua ose vajzë me prindër gjallë, që vazhdonte t'u tregohej gjithë vizitorëve gjer ditën e fundit. Tek vajza-nuse, Natën e Bojës, *bëhej aheng me karar,* pra, me masë, pa teprime, sepse shprehte një ndarje nga foleja prindërore. Megjithatë, edhe është kënduar e vallëzuar, janë bërë lojëra e dëfrime, që kjo të mos ngjante me një ditë mërzie, duke krijuar për vajzën një mjedis gëzimi e hareje. Kështu i plotësohej edhe dëshira vajzës. Por këngët i kanë shprehur qartë ndjenjat e saj, ndaj kanë pasur brenda atë masë sentimentalizmi e melankolie të pranueshme.

6. Dërgimi i rrobave tek nusja. Bëhej zakonisht të nesërmen e Natës së Farës, pra tre ditë para dasmës. Në disa vende, ku miqësia ishte afër, sidomos në zonat e Fushës, kjo bëhej edhe një ditë para dasmës, pra, të shtunën ose të mërkurën në mëngjes. Qëllimi ishte që të gjykohej nëse miku i kishte plotësuar kërkesat që ishin vendosur, kur ishin *prerë këpucët*. Kjo ditë është quajtur edhe *Kumtëri*, sepse testohej miku, dhe, në rast të mungesave, ai gjobitej ose këmbëngulej derisa të plotësoheshin detyrimet. Ky moment shoqërohej me këngë nga vajzat që përcillnin kuajt e ngarkuar. Tani shumë nga këto praktika nuk përdoren, sepse zhvillimet e reja i kanë zhvlerësuar.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Si po bije nji rrem shi

Si po bije ni rrem shi, lulie, mori.
Kada rrajm se jena di,
T'i maj, lala, me shami,
S'jemi nja, por jemi di,
Bar të njomë e xhethtari.

Moj nuse, moj belhollë

O moj nuse, moj belhollë,
T'ka zgjedhë dada kixh të njomë,
Dritan agën pashalie
T'kërkon bofçen xherelie.
-Xherelie ia kam vendue,
Në maqinë ia kam përshkue,
Në maqinë e në terzi,
E kam rraftë me tel flori.

More shkuesi me openga

More shkuesi jonë me openga
E prune nishanin drejt e mrena.
More shkuesi, jonë birinxhia,
Na e solle nishanin te zotnia.
Në na paç ba nusen e mirë,
Do të japim ka nji lirë.
Po t'na sjellsh nusen e keçe,
Do të varim ka nji teneçe.

O, mori vetulldrapën

O, mori vetulldrapën,
Do t'i çojmë strajniket, [3]
A do t'japin?
-M'japin, bre Gzim aga,
Mos u ban vëner,[4]
Druni si asht dru, dilber,
Nuk pritet menjer. [5]
Lemi ato shkues, dilber,
Na ço nja tre tjerë!
Ço nja tre tjerë, dilber,
Të jenë si zabita,[6)]
T'i bijen nishanet, dilber,
Pa dalun drita,
Ço nja tre tjerë, si asllana,
T'i bijen nishanet, dilber,
Pa dalë hana.

Krisi pushka në katund

Krisi pushka në katund,
Mos m'u tremb, oj nanë, e mos u tut!
Mos m'u trem, oj bijë e babës,
Se asht pushka e Dritan agës.
Krisi pushka na duel timi
Na u forcue Dritan trimi.
Krisi pushka i duel flaka,
Na u forcue Dritan aga.

Sa openga çore, or shkues

Sa openga çore, or shkues,
Sa ditë harxhove, "
Sa riza i vdore, "
Çfar nishani solle "

Qenkę djalë jezit

- Qenke djalë jezit, o, mor djalë,
Ço fjalë e më lip, o, mor djalë,
- Fjalën ta kam çue, o, mor djalë,
Baba jot s'ka ngjue, o, mor djalë.
- Ç'far ka baba jem, o, mor djalë,
Me jaranin tem, o mor djalë.

Lidhe shaminë për rreth ballit

Lidh shaminë për rreth ballit
O, moj lulja e allit!
Çfar i begjenis djalit?
I kam begjenis bilikin,
I kam begjenis kërlikin,
I kam begjenis potinat,
I kam begjenis rregzinat,
I kam begjenis avllinë,
I kam begjenis shtëpinë.

Rruga e Arbërit nr. 114

recensë

"Alegoria e Dibrës, filozofia e shekujve" është një libër ku autori ka bërë përpjekje shteruese për të nxjerrë në pah botën magjike të popullit, ato thesare të trashëguara që në prehistorinë e largët, që u mbushën me nektar mençurie nga burrat më në zë të Dibrës, Matit e krejt trojeve etnike shqiptare.

"Nomeja e largët" i Faik Ballancës, një roman ndryshe

Nga **SPIRO GJONI**

Pasi je njohur me tregimet, novelat dhe reportazhet e Faik Ballancës, natyrisht që ke krijuar një opinion të përgjithshëm për këtë shkrimtar dhe një vlerësim të caktuar, si për të, ashtu dhe për krijimtarinë e tij. Por a është kjo e mjaftueshme dhe e plotë? Sigurisht që jo kur dihet që Faiku ka shkruar dhe një roman.

Në ç'masë kjo vepër i shton vlerat e krijimtarisë letrare të këtij autori, ç'vend zë ajo në kuadrin e gjithë veprës së Ballancës, cila është e reja që shkrimtari sjell nëpërmjet këtij romani, krahasuar me krijimtarinë e tij por, dhe më gjerë, me krijimtarinë letrare të kohës kur jetoi e krijoi: këto dhe shumë pyetje të tjera prej kohësh kanë ngacmuar e tërhequr vëmendjen tonë, duke na çuar drejt përpjekjeve për t'u dhënë një përgjigje të argumentuar, në kuadër të qasjes dhe vlerësimit tërësor të veprës së këtij shkrimtari.

Ashtu si autori edhe vepra e tij e, në rastin konkret, romani "Nomeja e largët" nuk janë të panjohur për lexuesin tonë, i cili tashmë e njeh dhe Ballancën, peripecitë dhe kuadrin e tij tragjik, por dhe tregimet e novelën që, më pas çoi në daljen në dritë të romanit, me atë mori ngjarjesh e personazhesh, të njohur e anonimë, me realitete historike e bashkëkohore dhe me të "njohurin" e "të panjohurin" Bendo.

Megjithatë është shumë pak për një roman të tillë, të mjaftohesh me përcaktimet e mësipërme. Është shumë pak pasi edhe me një lexim të vetëm, bindesh se ke të bësh me një roman ndryshe. Është i tillë jo në kuadër të krijimtarisë së Ballancës, sepse ai nuk shkroi romane të tjerë me të cilët të krahasohej, por



dhe në kuadrin e krijimtarisë në plan më të gjerë.

Nuk gabojmë nëse romanin do ta vlerësonim si një risi origjinale në fushën e prozës së gjatë, jo vetëm për periudhën kur u shkrua. Argumentimi tërësor i këtij përfundimi, sigurisht që nuk është objekt i shkrimit tonë. Megjithatë të qenit risi ose roman ndryshe ne do ta mbështesnim në tri elemente:

1. Autori në romanin e tij na ofron një material

FAIK BALLANCA (1945-1977)

Lindi dhe vdiq në Tiranë në një familje intelektuale të ardhur nga Dibra e Madhe. Pasi kreu gjimnazin dhe mbaroi Fakultetin Histori-Filologji (dega e gazetarisë), punoi gazetar e redaktor në gazetën "Zëri i Rinisë"dhe në revistën letrare "Nëntori" të LSHASH-së.

Që nga viti 1962 nisi të botonte tregimet e para dhe të përkthente e të botonte prozë nga gjermanishtja, italishtja e frëngjishtja. Edhe pse e ndërpreu krijimtarinë letrare në moshë të re, F. Ballanca arriti të krijonte individualitetin e veçantë si shkrimtar i vërtetë i mirënjohur, në sajë të kulturës së gjerë, intuitës së hollë artistike dhe skrupulozitetit krijues.

---

faktik jetësor që, me pak përjashtime, është në funksion të plotë të idesë që ai kërkon t'i transmetojë lexuesit

2. Nëpërmjet një përzgjedhjeje të përcaktuar saktë e qartë të materialit jetësor, nga dy periudha kohore të ndryshme dhe ndërthurjes së tyre në mënyrë origjinale, ai ia ka arritur të realizojë me sukses një kohezion ideor mes së shkuarës e të tashmes.

3. Në procesin përzgjedhës autori nuk mund të mos qe i vëmendshëm e i kujdesshëm ndaj personazheve si bartës e shprehës të karaktereve të caktuar, por dhe në funksion të plotë me synimet ideoartistike të romanit.

Në këtë pikë do të mjaftoheshim duke sjellë në vëmendjen e lexuesit personazhin e Bendos, i cili përfaqëson një karakter jo vetëm origjinal, por edhe unik në letrat shqipe. Mund të vendosim dhe shumë fakte e elemente të tjera, si në planin e përmbajtjes, ashtu dhe atë të formës që na e përforcojmë përherë e më shumë bindjen se kemi të bëjmë me një roman ndryshe.

E tillë është struktura kompozicionale e tij (me alternim kapitujsh klasikë dhe historish anonime) ndërthurja e të tashmes me të shkuarën (jo përmes digresioneve), mëvetësia, por dhe korrelacioni i ngjarjeve, futja si një element tepër i rëndësishëm kompozicional i një personazhi të vogël në moshë, por "të madh" në detyra e veprime, "çelës" i zbërthimit e kuptimit të veprës.

Sigurisht, të gjitha këto, por edhe të tjera të pranishme në vepër janë fakte domethënëse që e mbështesin mendimin tonë. Por, në këtë kuadër, kurrsesi nuk mund të lemë pa përmendur faktorin kryesor, atë që i dha jetë e vlera të veçanta artistike ngjarjeve që pa, dëgjoi e jetoi mes banorëve e blegtorëve të atij fshati të krahinës së Rrëzës në rrethin e Tepelenës, shkrimtarit Faik Ballanca.

Ishte Faiku që me talentin, artin dhe punën e tij nxori në dritë një vepër tejet mbresëlënëse me mesazhe të fuqishme për të djeshmen, të sotmen e të ardhmen, por dhe me cilësi të spikatura artistike. Ishte Faik Ballanca që për aq kohë sa shkroi e krijoi (dhe pse jeta e tij u ndërpre shumë shpejt) na dha vetëm art, pa rënë në asnjë rast "viktimë" e izmave e standardeve frenuese e shkatërruese të realizmit socialist.

Ishte Faiku, që siç shprehet në një shkrim të tij shkrimtari Nasi Lera, ... "kishte thënë që në tregimin e tij të parë diçka që nuk ishte thënë, diçka që përmbyste, trondiste dhe shkundte nga qelizat e trurit trajtën e pluhurosur të trajtimit uniform të një teme apo personazhi".

(Marrë nga shqiptarja.com)

"Alegoria e Dibrës", përpjekje për të nxjerrë në pah botën magjike të popullit

Nga **DUKAGJIN HATA**

Ndërsa ndjek rrugën e shkrimtarit, studiuesit dhe kulturologut Mevlud Buci gjatë këtyre njëzet e tre viteve të çlirimit të letrave tona kombëtare nga dogmatizmi dhe jashtëletrarja, nuk mund të mos kuptoj se kryefjala e kësaj krijimtarie është Dibra dhe, dashje pa dashje, faqe pas faqeje të kësaj krijimtarie të gjerë e të larmishme, shpërfaqet një botë e magjishme, plot dritëhije, me një gjuhë të denjë për podiumet më të famshme të oratorisë dhe gjykimit kolektiv. Ndaj, tok me fragmentet e librave të Mevlud Bucit, më vijnë në mendje dhe pika lidhjeje në kohë, mendje të ndritura, që e ekspozojnë Dibrën tonë në vëmendje të plotë të diturorëve.

Në vitin 1502 një i huaj, Feliks Petani, i referohet Dibrës (Dibri) si qytet me shumë banorë, dhe në atë kohë ajo njihej si një qendër e rëndësishme qytetare. Pukëvili, na bën me dije se ndryshe nga mjaft qytete të tjera, elementi sllav aty mungonte fare. Për francezin tjetër Ami Bue, populli i Dibrës është "i vyeshëm", me vlera. Por ajo që është cilësuar nga të huajt dhe vendasit si "kryeshenja e identitetit shpirtëror dibran" është e folmja "qesh e ngjesh", "qaj e qesh", e folmja me dy e më shumë kuptime, me alegori dhe shëmbëlltyra.


Autori Mevlud Buci ka kërkuar shumë në këtë lëmë të kulturës popullore, duke na përcjellë të botuar libra me vlerë në fushën e kërkimit të shpirtit dhe etnopsikikës kolektive, ku fabulat, shëmbëlltyrat, parabolat, anektodat, grimca të krijuara apo të mbledhura në gjirin e popullit, gjurmimet gjuhësore dhe letrare rreth të folmeve me dy kuptime, alegorike etj, janë pjesë e vektorit krijues dhe kulturologjik të këtij autori.

Në rrugën e Dine Hoxhës, të mbiquajturit "Dekan i Universitetit të Dibrës", "Sokrati i Dibrës", "Profesor i Alegorisë Dibrane", Haziz Ndreut, këngëtarit, folkloristit dhe kulturologut emblematik, Xhafer Martinit, i cili ka gjurmuar dhe përcjellë me një aparat të veçantë shpjegues dhe reflektiv pjesë të thesareve më të vyera të kulturës shpirtërore dibrane, Mevlud Buci është një tjetër krijues, folklorist e kulturolog me një diapazon të gjerë krijues e mbledhës të thellësive të shpirtit popullor, ku në këtë përcjellje përkushtuese, Dibra, sigurisht, mban kryet e vendit.

Ajo që e bën unikale Dibrën në gjithë këtë prurje stilemash të një të folure të veçantë, me shëmbëlltyra dhe alegori, me kode dhe nënkode të magjishme të thellësive të shpirtit është mençuria e pashembullt e dibranit, filozofia e tij sa e thellë, aq dhe pragmatiste, në përputhje me kërkesat e kohës dhe të bashkëkohësit.

Është e famshme mençuria dibrane, por ajo që quhet "alegoria dibrane", është e paarritshme në kohëhapësirën shqiptare dhe globale, është Himalaja e pazbuluar ende e një thesari të vyer, që na dëshmon gjurmët e ndritura të mendësisë kolektive dibrane që nga kohët prehistorike dhe mitologjike, deri në ditët tona. Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë diktuese, bindëse. Pjesë të këtij vektori kulturologjik ka kohë që na sjell me një përkushtim dhe përgjegjësi të madhe mbledhëse e krijuese shkrimtari dhe folkloristi Mevlud Buci, autor i njëzet e tre librave të llojeve dhe zhanreve të ndryshme letrare, ku sundon mbledhja dhe krijimi i proverbave, alegorive dhe të folmeve me ngarkesë stilistike të shumëkuptimtë. Ky autor ka mbledhur dhe krijuar me mijëra fabula, epigrame, epigrafe, satira, mijëra njësi frazeologjike, idioma dhe të folme të kodifikuara etj., përmbledhur në disa libra voluminozë dhe në qindra shkrime, ku ai shpalos seriozitetin e një studiuesi të pasionuar e skrupuloz.

Në librin "Alegoria e Dibrës, filozofia e shekujve", libër me gjurmime alegorike, Mevlud Buci përmbledh grimca, kujtesa, porosi të filozofëve popullorë të Dibrës, rrëfime të mjeshtrave popullorë të rrëfimit, bëma e ndodhi të njerëzve të mençur të kësaj treve sharmante, ku gjuha ngrihet në një kult lirie dhe qytetërimi, anektoda, sentenca etj.



Mjafton të sjellim në vëmendje të lexuesit porositë e Salë Markes: "Mos shtini pushkë në vlazni", "Mos zini nuse në gjak", "Mos bani zijafete të teprueme", "Mos jepni para me fajde", "Mos i zini tjetrit udhë kot", "Kur hyni në valle, hyni me mend e dilni me vesh" etj., për të kuptuar atë mendësi të ngulitur thellë në mendimin dhe veprimin dibran, që vjen përmes gojës së filozofëve pa shkollë të Dibrës, por që janë në lartësinë e devizave të mendjeve më të ndritura botërore të të gjitha kohërave.

Përpjekjet për të krijuar një mendim për gjuhën e kodifikuar, të cilën dijetari francez Roland Barthi e vlerëson si fillesë të asaj që ai e quan metaligjërim, të çojnë detyrimisht në odat e burrave në male, ku nuk mjafton gjuha e drejtpërdrejtë për të komunikuar, por duhet që kjo gjuhë të pajiset me "çelsa të fshehtë", të cilët mund t'i përdorin vetëm burrat e ditur dhe mendjemprehtë.

Oda e Dibrës është unikale në përdorimin e kësaj gjuhe, e cila me kohë është kthyer në një arketip mprehtësie dhe syçelësie.

Mevlud Buci e njeh me rrënjë këtë gjuhë, ka bredhur odave në male në kërkim të nektarit psiko-linguistik, ka kontaktuar me qindra persona me të cilët ka ndërtuar ura jo vetëm njerëzore, miqësie e bashkëpunimi, por dhe ura kulturologjike, duke e përdorur përvojën e tyre diturore, si "lëndë të parë" për materien e librave të tij të shumtë, që janë një përcjellje virtuoze e kulturës së thellë të shpirtit kolektiv dibran në veçanti dhe të shpirtit kolektiv kombëtar në përgjithësi.

"Alegoria e Dibrës, filozofia e shekujve" është një libër ku autori ka bërë përpjekje shteruese për të nxjerrë në pah botën magjike të popullit, ato thesare të trashëguara që në prehistorinë e largët, që u mbushën me nektar mençurie nga burrat më në zë të Dibrës, Matit e krejt trojeve etnike shqiptare.

Është një rrugë në të cilën kanë vënë gurë kilometrikë mjeshtra të folklorit dhe të kulturës sonë kombëtare, por Buci e çon më tej këtë traditë, pasi me pasionin dhe zellin e tij të admirueshëm, krijon modele arketipale kulturologjike, të denja për një studiues tepër serioz.

Gjithë kjo prurje, jo vetëm në këtë libër, por dhe në librat pararendës të Mevlud Bucit, e bëjnë atë një institucion lëvizës kulturologjik, që sjellin drejt lexuesit një botë të tejndezur pasioni, në gjurmët më të ndritura të kulturës gjuhësore, estetike dhe kulturore të trevës së Dibrës dhe të krejt kombit shqiptar.

vështrim

Deri tani Arjan Kadiu ka botuar 32 vepra artistike, shkencore dhe tekste shkollore: 10 botime shkencore, 12 vepra të letërsisë artistike dhe 10 tekste shkollore për arsimin parauniversitar dhe për atë pasuniversitar.

Një vështrim eseistik mbi krijimtarinë e Arjan Kadiut

Nga **LUTFI HANKU**

Më tërhoqën vëmendjen veprat e fundit shkencore, enciklopedike të shkrimtarit dhe studjuesit prof.dr. Arian Kadiut, "Dibra e Madhe dhe një vështrim në Dibrën e Vogël" dhe "100 vjet Pavarësi, 100 figura dibranësh". Shkrimtari i talentuar ka lindur në lagjen Dublec të Peshkopisë së Dibrës. Filloi që të shkruajë që në moshën shkollore i përkushtuar dhe me bindje optiimiste për t'u bërë shkrimtar. Mosha e njomë i ngjalli kureshtjen për të zbuluar të fshehtat e magjishme të botës së tij dhe, duke ndjerë rritjen e ndijimeve poetike. Më vonë në botën krijuese shpërthejnë si vjollca aromatike, metafora mes subjekteve që filloi t'i hedhë në letër imazhet e përftuara.

Në fëmijëri botoi në gazetën "Pionieri". Në shkollën e mesme pedagogjike ka botuar shkrime kritike. Ato vlerësoheshin nga mësuesit e shkollës dhe shokët e shoqet. Në maturë shkroi hartimin më të bukur, që mësuesit e letërsisë e paraqisnin në maturat e mëvonshme si model që duhej ndjekur.

Pas përfundimit të pedagogjikes, punoi mësues në të gjitha hallkat e sistemit arsimor. Detyrën e mësuesit e ushtroi në shkollat 8-vjeçare të Grevës e Melanit, në shkollën e mesme të Kastriotit, dhe mësues i jashtëm në pedagogjiken e qytetit të Peshkopisë. Ai mbaroi Universitetin në degën e gjuhë-letërsisë. Bashkë me Universitetin kreu njëherësh një kurs dy vjeçar gazetarie. Punoi 3 vjet gazetar dhe redaktor në gazetës "Mësuesi".

Gjyshi i tij ka shërbyer "Kadi" në Peshkopi, një burrë që përmendet ende për urtësi, mençuri natyrale dhe si falësh gjaqesh. Babai i tij ishte intelektual. Disa vite studjoi në Itali, në Napoli. .Zotëronte italishten letrare. Nëna e tij ishte bijë e fisit Hajdaraga, me origjinë nga fisi Gropaj, bashkëluftëtarë të Skënderbeut. Jetonin në Dibër të Madhe.

Bashkëpunoi me gazetën "Studenti" dhe ishte edhe redaktor i saj. Botonte në gazetën "Rinia" dhe tek "Mësuesi" ku mori emër. Shkrimet e tij, kryesisht arsimore e sociale, reportazhe e përshkrime, transmetoheshin nga Radio -Tirana.

Në Tiranë, me grupe të rinjsh intelektualë, lexonin edhe letërsi "dekadente". Edhe Ariani u etiketua "modernist", kur u zhvillua Konferenca e talenteve të reja në Korçë. Bashkë me pak të tjerë e kritikuan në raportin e saj dhe e dërguan në Peshkopi, ku punoi në Shtëpinë e Pionierit dhe në Kabinetiin Pedagogjik.

Më 1990 filloi punën shkencore në Institutin e Studimeve Pedagogjike në Tiranë, si specialist kombëtar i letërsisë. Më 2005 si u largua nga Instituti ka dhënë leksione në Fakultetin e Infermierisë, në UT. Pas gradave "kandidat i shkencave", "Doktor i shkencave" (1991,1994), më 2004 iu dha grada shkencore "Mjeshtër kërkimesh" (prof.ass), më 2007 iu dha titulli shkencor "Profesor". Ai është kryeredaktor i revistës "Univers" dhe sekretar kolegjumi i revistës "Mjekësia dhe infermieria bashkëkohore". Gjithashtu është aktiv për probleme të reformës arsimore dhe letërsisë.

Në prag të 100 vjetorit të Pavarësisë, Ariani u nderua nga Këshilli Bashkiak i Peshkopisë me titullin "Qytetar Nderi".

***


Në gjithë këto vite ai nuk e ka ndërprerë për asnjë çast veprimtarinë krijuese e atë shkencore dhe është i pranishëm edhe në faqet e shtypit. Deri tani me emrin e profesorit rrezatojnë 32 vepra artistike, shkencore dhe tekste shkollore: 10 botime shkencore, 12 vepra të letërsisë artistike dhe 10 tekste shkollore për arsimin parauniversitar dhe për atë pasuniversitar.

Nga librat studimorë shkencor po veçoj dy të tillë: **''Midis alternativave: shkolla private (jo publike)''**, i pari i këtij lloji në vendin tonë dhe studimi tjetër **''Adoleshentët dhe tranzicioni''**, për të cilat është shkruar jo edhe në shtypin pedagogjik dhe kanë gjetur aplikim në shkollat tona, në Shqipëri.

Në librin tjetër **''Hape portën e artë të leximit''** buron mesazhi i bukur e bashkëkohor se të lexuarit është gur themeli për suksesin e fëmijës në shkollë e madje gjatë gjithë jetës së tij. Pa fituar aftësinë për të ditur të lexojë mirë, të njohë teknikat bashkëkohore, etj, mundësinë për realizimin e vetvetes dhe për arritjen e suksesit profesional, pa dyshin që ata e lanë më të pakët.

Nga letërsia artistike po veçojmë:

Romani fantastiko – shkencor **"Pas takimit me alienët"** është një vepër tipike për nxënësit, ku tregohet për aventurat e një shkollari në botën reale fëminore dhe në atë të krijuar nga shkrimtari. Ky roman fanastiko-shkencor është shumë tërheqës, sepse autori e çon heroin e tij në aventura mjaft interesante që të ngjallin kureshtje me befasirat e



këndshme. Ky është edhe mendimi i lexuesve që u adresohet.

Përralla-novelë **"Aventurat e pabesueshme të Batos"** është një vepër artistike, fantastike, shkencore, e dallueshme nga vepra e tjera të këtij lloji. Përralla-novelë që në fillim na befason me gjetjen e bukur: ajo përshkruan aventurat e një djali me fletë, që quhet Bato. Kështu ai është me fletë nën sqetulla dhe "trimëritë" e tij janë kaq të mëdha sa edhe zgjuarësia e tij, që shpalosen kapitull pas kapitulli.

Vëllimi **''Trishtimi i blertë''** përmban 4 novela për moshën e rritur shkollore. Tematika e tyre është e njëjtë: atdhedashuria, pra dashuria për Atdheun dhe mbrojten e trojeve amtare. Janë domethënëse edhe titujt e vetë novelave si: ''Zambakët e liqenit'', ''Guri i vashës'', ''Grushti i fundit'' dhe ''Buzëqeshja e Kosovës bleron edhe gurin''. Dy novelat e para e marrin subjektin nga legjendat e Dibrës, e treta për marrëdhënimet me fqinjët dhe e katërta nga Kosova.

Disa botime të tij (rreth 8) bëjnë pjesë në listën e rekomandimeve të MASH për leximet jashtëklase. Këtu nuk po përmend edhe faktin se disa tregime të tij janë përfshirë në tekstet shkollore.

Nga tekstet shkollore po përmendim**:''Gjuha 4'', ''Gjuha shqipe 6'' dhe ''Gjuha shqipe 8''**

Është autor e bashkëautor në 3 tekste ahkollore, që MASH i rekomandon të pëdoren në shkolla si tekste alternative. Këto tekste janë ''Gjuha shqipe 4'', ''Gjuha shqipe 6'' dhe ''Gjuha shqipe 8' të cilat aktualisht përdoren në shkollat tona. Tekstet dallohen nga këto veçori:

Nga studimi i tekstit dhe ballafaqimi me programin, del se janë marrë parasysh dhe janë realizuar linjat dhe nënlinjat që përbëlnë fushat e studimit.

Materiali letrar është i larmishëm, i përshtatshëm për moshën që i adresohet dhe i zgjedhur mirë e me kujdes të veçantë, duke marrë letërsinë më të mirë si nga arritjet artistike, ashtu edhe nga mesazhi që përcjellë. Nuk po ndalem në tekstet universitare që janë në përdorim në Fakultete, sikurse janë **''Sociologjia'' për Fakultetin e Infermierisë të UT** dhe as në tekstin **''Sociologjia e arsimimit', për kandidatët e studimeve master në disa universitete** Nga kopshti i tij krijues mbinë 450 shkrime me materiale problemore, me përshkrime e reportazhe në organe të ndryshme, duke fituar edhe çmime në gazetari.

Si mësues dhe lexues më rrëmbeu magjia e dashurisë për shkrimtarin, për këmbënguljen që materializon vullnetet e idealet e dibranëve dhe lexuesve u lumturoi vetëdijen e adhurimin e krijuesit fisnik.

Sa mirë! Ariani zgjoi historinë e tejshekujve, e cila ndjehet e shkruar në veprën monografike "Dibra e Madhe dhe një vështrim në Dibrën e Vogël". Ajo jehon si buçimë sinfonike me nota patriotike në shkronjat e alfabetit tonë kombëtar. Nga një vepër "enciklopedike", e vlerësuar nga kritika, buron dashuria, malli i shkruar, bota e personazheve historikë, karaktere të veçanta dibre me virtyte, ndiesi, impresione, duke e tjerrur prozën në vitalitetin e krahinës e qxtetit të Dibrës e etur për liri. Autori ka kërkuar me pasion shkrimtari heronj me potencë, udhëheqës me role historike, që janë skalitur e veshur me tipare të thjeshta popullore dhe me urtësi mençurie, gra e burra të gjendur në kuvende e luftra. Janë plazmuar në breza emrat e dibranëve: Skënderbeu i 25 betejave në Dibër, Iljaz Pashë Dibra (kryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit)., Sheh Mustafa i Zerqanit, Said Najdeni, (hapi shkollën e parë shqipe), Baba Fejzë Bulqiza, Vehbi Agolli (kryetar i Pleqësisë në qeverinë e Vlorës, 1912), Selim Rusi (mbrojti Kuvendin e Dibrës), Tefik Jegeni (pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit), Eqerem Cami, Sherif Langu, Hafëz Raif Kadiu, Xhemal Mullai (Dibra), Xhelal Mullai, Ramiz Daci, Haxhi Ismet Dibra, Abdurrahman Dibra, Faik Shatku, Haki Sharofi, Edip Tërshana, Haki Stërmilli, Abdi Haxhiu dhe një listë e gjatë e njerëzve patriotë e ardhetarë të njohur tej e më tej se krahina e Dibrës.

***

Brezi i autorit i ka të lexuara ngjarjet dhe të dëgjuara, ndaj e ka lakuar mirë, sa dhe qyteti i Dibrës të duket personazh i gjallë vigan që mbijeton, lufton, bën kuvende, (madje edhe kongrese), bën dasma, lind fëmijë e tund djepat e vazhdimit të jetës.

Duket mjeshtria e pjekur e Arianit, pasioni, duke e përkëdhelur e ledhatuar fjalën, për t'i dhënë shije mendimit që të rrëmbejë lexuesin. Kjo e vesh veprën në formë me ëmbëlsinë e të shkruarit dhe me origjinalitetin e krijuesit të Dibrës së Madhe.

Prof.dr. Ariani u ka dhënë përgjigje gjithë pyetjeve për të njohur lexuesit, kryesisht me Dibrën e Madhe. Por idealja nuk ka limit.

Ndonëse burimet antike nuk janë të mjaftueshme, provohet se diibranët prejardhjen e tyre e kanë nga fisi Ilir i penestëve, në cep të Ilirisë. Pikpamjen që toka e Penestisë duhet kërkuar në trevën e Dibrës, pranohet nga studjuesit. Këtë e pranon edhe shkrimtari bizantin Akropoliti. Pohohet se penestët kanë banuar në luginën e Drinit të Zi që në vitet 170-169 p.e.r. Mehdi Frashëri në historinë e lashtë të Shqipërisë shkruan: "Penestia-ky fis banonte gjithë Valatin e Sipërm të Matit dhe të Drinit të Zi. Kryeqytetii tyre ka qenë Uskana, Dibra e Vjetër".

Lexues i dashur. Lexoni A. Kadiun nga fq. 74-83 "Një vështrim ndryshe nga historiografia tradicionale" që të kuptoni thellësinë e analizës historike të tezës së tij shkencore.

Duke qenë bir i Dibrës së Madhe në origjinë, askush tjetër nuk do ta derdhte djersën e tij pa pasur hovet e shpirtit të ndezur zjarr nga dashuria për dibranët. (Sa nder!)

Ndaj vepra e dashuirisë e kapi autorin me duart e mistikes, edhe dy herë të tjera më parë, deri sa botoi veprën panteon me bagazh të ndriçëm vlerash historike-shkencore, si etnografike, onomastike, etnologjike, etnokulturore e të tjera të popullarizuara. Rroftë dashuria e shkrimtarit!.

Gazeta "Illyria" në SHBA, ndër të tjera shkruajti: "…sa e sa ngjarje me rëndësi kombëtare e jetike si për Dibrën, ashtu edhe për Shqipërinë, fillimin e përfundimin e kanë pasur në Dibër dhe si protagonistë kanë qenë dibranët…"

Luheshin fatet e kombit si në vitet e Lidhjes së Prizrenit. Kuvendi i Dibrës u hap në livadhet e Qernanëjcës së blertë. Dibranët mes shamive të kuqe, sikur kishin formuar flamurin kombëtar. Sheherlinjve u lexohej lumturia, kur takonin burrat delegatë, që vinin edhe nga Shkodra, Tirana, Elbasani, Mati. Kuvendit iu dërguan mesazhe edhe nga Gjakova, Gucia, Prizreni. Përshëndetën shumë personalitete të dëgjuar.

U paraqitën këto kërkesa:

– Bashkimi i gjithë shqiptarëve pa dallim feje.

– Lëvrimi dhe ruajtja e gjuhës shqipe.

– Hapja e shkollave dhe mësimi të zhvillohet në gjuhën amtare.

Me këto kërkesa Kuvendi provonte ekzistencën e kombit dhe hidheshin bazat e shtetit.

Kësisoj, në fund të shekullit 19-të u organizuan Kuvende në Dibër të Madhe për ruajtjen e tërësisë tokësore shqiptare. U mblodh ajka e Dibrës, kur asaj po i shkëputeshin edhe fushat e Kosovës, Çermenika e Dibra e Madhe.

Në 9 korrik 1908 dibranët përkrahën kryengritjen e repartit ushtarak të xhenjos që drejtohej nga oficeri shqiptar Ahmet Njazi Beu. Në shkurt 1909 plasi në Dibër kryengritja tjetër kundër marrjes ushtarë dhe mbledhjes së taksave. Xhonturqit organizuan Kongresin e Dibrës që të qetësonin gjendjen. Në të vërtetë Kongresi nuk i pati sukseset që priste Stambolli. Në këtë Kongres famëmadh u sanksionuan kërkesat që të çonin në fitoren e autonomisë. Rëndësi iu kushtua edhe çështjes së mësimit të gjuhës shqipe. Është e padiskutueshme se në Kongresin e Manastirit u fol e u diskutua për gjuhën shqipe dhe u përcaktua alfabeti që duhej të përdorej, por në Dibër u kërkua futja e mësimit të gjuhës shqipe edhe në shkollat shtetërore. Këto dy Kongrese kanë vlera kombëtare të njëjta.

Të gjitha zërat e kësaj vepre në unison përbëjnë një vlerë njerëzore dhe shkencore që ka arritur të dritëzojë prof.dr. Arian Kadiu.

Në autostradën e shkronjave janë kopsitur shekujt e vuajtjes e mjerimit nën robëri. Autori ka vështruar me kompetencë ndjesitë e ngjarjeve, krejt ndryshe nga një pjesë e historianëve tanë. Ata i paraqesin ndeshjet me pushtuesit apo ngjarjet, por mendimi i tyre vetiak nuk del gjëkundi duke ia lënë ta gjejë lexuesi. Ndërsa prof. A. Kadiu e shpreh, e shtjellon mendimin, i jep jetë e bindje duke mbajtur pozicion të pranueshëm shkencor, larg subjektivizmit.

Sido, duke qenë shkrimtar e "tradhëton" nga një herë "historianin" dhe mishëron personazhet historikë dhe hyn në botën e virtyteve e vlerave volitive të karaktereve të heronjve.

***

Analizën më të plotë e me përgjegjësi profesionale e ka bërë prof. dr. akademiku Gjovalin Shkurtaj, i cili e quan veprën e Arianit "Enciklopedi historike, shoqërore dhe etnokulturore". Ai trajton vlerat e kësaj vepre me 650 faqe dhe është përshëndetur dhe vlerësuar me dinjitet mjaft pozitivisht nga historiani prof.dr. Muharrem Dezhgiu, juristi Kujtim Osmani, prof.dr. Gazmend Shpuza, studjuesi Nexhat Myftiu, studjuesi dhe poeti Namik Selmani etj.

Shpirti i tij krijues në botën e artit, sapo botoi, në prag të festës jubilare librin "100 vjet pavarësi, 100 figura dibranësh", e pritur mjaft mirë e që dëshmoi dashurinë e shkrimtarit. Edhe këtu buzëqeshja e tij përzgjodhi 100 personazhe që me vetëdijen demokrate të autorit e meritojnë të jenë në një libër, sepse autori nuk dremit me ëndërra apo mbi sirtarët e ndërgjegjies së plagosur nga sistemi monist.

Veprat zgjojnë vlerat e mëdha të kombit, të origjinës së Dibrës, me kryetarin e Pleqësisë së Vlorës 1912 (Haxhi Vehbi Dibra–Agolli), nënkryetarin e saj një tjetër dibran (Dom Nikollë Kaçorri), me Heroin Kombëtar dhe kryegjeneralin e lirisë shqiptare, Gjergj Kastriotin, me të cilin autori dritëron kombin, – të gjithë nga Dibra, – dhe qindra personalitete idealistë, patriotë, luftëtarë, politikanë, shkrimtarë, profesorë, gazetarë, mjekë, artistë, mësues, mistikë atdhetarë. Kësisoj edhe në këtë vepër shkëlqen vetëdija kombëtare dhe e përjetësisë së personaliteteve historikë me individualitete fisnikësh, që kanë të përbashkët: atdheun. kombin dashurinë, bukën, barutin, fëmijën, lirinë, shkollën.

Këto personalitete dibre, me veti fisnike mblidhen në muzeun e kujtesës, me një Korab vlerash, vitale dhe historia zbukurohet , Dibra ringjallet dhe lexuesve u rrinë pranë.

Përzgjedhja e autorit dhe simpatia e tij nuk fshihen, sepse duken ndiesitë e pavyshkura që shpërthejnë gjurmëve metaforike të ringjalljes, me karakteret e ndryshimeve, temperamenteve dhe cilësive volitive. Të pastër i gatuan luftëtarët shqiptarë, prandaj për ta u hapën portat e librave! Rrofshin shkrimtarët që mbledhin vlerat e kombit dhe pasurojnë ushtrinë e fisnikërisë me bukurinë shqiptare të karaktereve të larmishme dibrane me të gjitha vizionet intelektuale, duke gjelbëruar për këtë 100 vjetor fjalën e shkruar shqipe!

Krijuesi i botës së artit të shkruar ka ndiesi të veçanta që, kur ndërgjegjësohet, e përjeton realitetin e ngjarjes dhe e hedh në letër me emocione e frymëzim, larg pompozitteti të fjalës dhe me pastërtinë e gjuhës. Kështu Ariani mbledh mençurinë e trimërinë e Dibrës si në një muze magjik, ku personazhet prezantojnë tek lexuesi profilin e lirisë e të dijeve. Marrshimi në botën e studjuesit dhe krijuesit jehon dhe skanohet nga autori duke u veshur me mençuri dhe humanizëm. Dibra e meriton një botim të tillë për 100 figura dibrane, prandaj e falenderoj autorin, prof.dr. Arian Kadiun. Mes tyre janë edhe Josif Bagëri, Lulzim Basha,, Shefki Shatku, Ismet Bellova, Eqerem Cami, Iljaz Pasha, Fiqiri Dine, Abdurrahman Dibra, Elez Isufi, Nikollë Kaçorri, Faik Ballanca, Niazi Kosovrasti, Agim Krajka, Sherif Langu, Hoxhë Muglica, Sulejman Pitarka, Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Natasha Shehu, Edip Tërshana, Adivije Sharofi etj.

Edhe Dibrës sonë i duken plagët e brengave të zgalemëve që e munduan dhe e mundojnë me klane e mure gjaku, mure ndarës fataliteti të historisë në trupin tonë dhe më tokën tonë. Kujtdo i troket me dhimbje në kujtesë brenga e shpirtit. E vret akoma ajo, sepse "Shqipëria është ndarë për gjysëm me Drinin" (L.Poradeci). Në këtë fatalitet të rëndë e të hidhur, profesori ynë ka ditur të çmojë vlerat e personaliteteve, të cilëve nuk u tretet ashti, as truri dhe gjaku i kombit tonë në shekuj. Prandaj nuk derdhet copa-copa dashuria për komb e flamur, se Ariani, me dy veprat si dy binjakë i ka sjellë për të dëgjuar himnin epik të demokracisë, si magjinë e shpirtit atdhetar për t'u miqësuar me figurat e 100 dibranëve, me të cilët do të ndihet zëri poetik i fjalës, si një ideal demokratik, si dy libra motra që këndojnë për komb e flamur.

profil

Libri “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të Shqipërisë” është përpiluar për t’u ardhur në ndihmë specialistëve gjeologë, studentëve të fakulteteve të specialitetit gjeolog e jo gjeolog, disertantëve, biznesmenëve që kanë dëshirë të zhvillojnë bizneset e tyre me këto lëndë të para minerale industriale.

Kontributi i Bashkim Lleshit në gjeologjinë shqiptare

Libri “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të Shqipërisë” është përpiluar për t’u ardhur në ndihmë specialistëve gjeologë, studentëve të fakulteteve të specialitetit gjeolog e jo gjeolog, disertantëve, biznesmenëve që kanë dëshirë të zhvillojnë bizneset e tyre me këto lëndë të para minerale industriale, pushtetit qendror e lokal të interesuar për këto pasuri shumë të dobishme për zhvillimin e ekonomisë së tregut në vendin tonë.


Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që nga krijimi e deri më sot, ka kryer një volum të konsiderueshëm punimesh të rilevimit dhe kërkim-zbulimit për këto lëndë të para minerale industriale, si rezultat i të cilave janë zbuluar qindra vendburime dhe objekte, si dhe janë llogaritur qindra milionë ton rezerva gjeologjike, industriale dhe prognozë, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e industrisë në kuadrin e ekonomisë së tregut.

Në faqet e këtij libri (teksti mësimor) janë bërë përpjekje për të pasqyruar kontributin e gjithë gjeologëve të Shqipërisë, duke sistemuar dhe përgjithësuar rezultatet e punës së madhe të kryer në të gjitha ndërmarrjet gjeologjike të vendit tonë, nga Tropoja, Kukësi, Puka, Rubiku e Shkodra, në Peshkopi, Bulqizë e Burrel, duke vazhduar në Tiranë, Librazhd, Pogradec, Korçë e Gjirokastër, si dhe janë pasqyruar disa nga rilevimet gjeologjike të shkallës 1:25 000 të gjeologëve të Institutit të Naftës e Gazit në Fier të cilët në ndërtimin gjeologjik të shesheve që kanë rilevuar kanë vlerësuar edhe shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë jo metalorë.

Për tu ardhur në ndihmë lexuesve dhe përdoruesve të këtij libri, në fund janë sistemuar burimet bibliografike, për të gjithë vendburimet dhe objektet e shkëmbinjve dhe mineraleve industrialë jo metalorë të vendit tonë, ku pasqyrohen pothuajse të gjitha Raportet dhe Relacionet e punimeve të kërkim-zbulimit të kryera në Ndërmarrjet gjeologjike, si dhe studimet kryesore përgjithësuese për këto pasuri të kryera nga Instituti i Kërkimeve Gjeologjike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Volumin më të madh të punimeve të kërkim-zbulimit për shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë, deri në vitet nëntëdhjetë e ka kryer Ndërmarrja Gjeologjike e Tiranës e cila ka patur edhe një Ekspeditë të veçantë për materialet e ndërtimit, që ka ushtruar aktivitetin e saj në gjithë territorin e vendit (shiko në tekst), sepse ndërmarrjet e tjera gjeologjike kanë patur detyra të mëdha, sidomos për mineralet metalore të kromit, bakrit, hekur nikelit e nikelit silikat, boksideve etj.

Ekspedita e materialeve të ndërtimit në Ndër-






marrjen Gjeologjike të Tiranës është marrë me kërkim-zbulimin e gëlqeroreve dhe argjilave si lëndë të para ndërtimi për prodhimin e çimentos e tullave, të mermerëve e gëlqerorëve të mermerizuar, të kaolinave e tufeve vullkanike, të shkrifërimeve të vjetra e atyre të reja bregdetare, rërave kuarcore e ranorëve, të gipseve e kripërave, të asbestit, inerteve lumore, të magneziteve, feldshpateve, xhamit vullkanik, të gurëve dekorativë ofiolitikë etj. në shumë rrethe të vendit.

Në këtë ndërmarrje krahas kontributit të shumë gjeologëve të vjetër dhe me eksperiencë vlen të përmendet në veçanti kontributi shumë i madh e i rëndësishëm i gjeologes së vjetër e të pasionuar, Inxh.Savete Ohri.

Një kontribut të madh për njohjen e këtyre mineraleve ka dhënë edhe Prof. Dr. Agim Tërshana, një nga studiuesit më të mirë të këtyre mineraleve në vendin tonë i cili në vitin 1973 së bashku me gjeologun e vjetër Inxh.Nuredin Osmani, kanë botuar librin “Vendburimet e mineraleve të dobishme jo metalore dhe kërkimi i tyre” dhe në vitin 1995 me disa përmirësime ka ribotuar këtë libër.

Në vitin 1989 nga Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë në bashkëpunim me Fakultetin e Gjeologjisë dhe te Minierave dhe Ndërmarrjet gjeologjike u krye Studimi i Hartës metalogjenike të Shqipërisë.

Nga gjysma e parë e viteve nëntëdhjetë e deri në ditët e sotme pothuajse të gjitha ndërmarrjet e tjera gjeologjike të vendit tonë si dhe Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë, i kanë





Prof. Bashkim Lleshi është ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e gjeologjisë shqiptare. Një ndër botimet e tij të fundit, “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë (jometalorë) të Shqipërisë” është një pasuri e industrisë minerare në vend, e cila është vazhdimisht në kërkim të burimeve të reja. Ai ka marrë pjesë edhe në Studimin e Fisibilitetit të Rrugës së Arbërit në vitin 2003 dhe ka qenë organizatori kryesor i Kuvendit Tekniko Shkencor për Rrugën e Arbërit në Maj të vitit 2007. Në vitin 2008 ka botuar librin “Gjeologjia e Rrugës së Arbërit”, i cili është një libër i vlefshëm në historikun e rrugës në të ardhmen.

Bashkim Qamil Lleshi ka lindur në Zogje të Dibrës me 10 Dhjetor 1945. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje në vitet 1952-1956, Shkollën 7 vjeçare në Peshkopi në vitet 1956-1959. Shkollën e mesme për Gjeologji e ka filluar në vitin 1959 në Tiranë dhe e ka përfunduar në vitin 1963 në Prrenjas të Librazhdit

Në vitin 1968 ka përfunduar Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave në Universitetin i Tiranës ku u diplomua Inxhinier gjeolog. Në vitin 1969 ka filluar punën në Ndërmarrjen Gjeologjike të Bulqizës në fillim si Gjeolog në masivin ultrabazik të Lurës, më vonë gjeolog dhe K/gjeolog në Bulqizë. Në vitin 1977 ka punuar Shef i Seksionit të Industrisë në Peshkopi.

Nga viti 1978 deri në vitin 1984 ka punuar Drejtor i Institutit të Studimeve e Projektimeve të Gjeologjisë e Minierave në Tiranë. Në vitin 1983 ka mbrojtur Disertacionin me temë “Ndërtimi Gjeologjik dhe krommbajtja e masivit të Lurës” ku fitoi gradën Doktor i Shkencave. Nga viti 1984 deri në tetor të vitit 1998 ka punuar Inxhinier gjeolog dhe Drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike të Tiranës. Nga tetori i vitit 1998 deri në maj të vitit 1999 ka punuar Drejtor i Albkromit në Tiranë. Nga maji i vitit 1999 deri në vitin 2008 Inxhinier gjeolog në Ndërmarrjen gjeologjike të Tiranës me detyrë Drejtues projekti. Në vitin 1995 fitoi titullin As. Profesor, ndërsa në vitin 2001 fitoi titullin Profesor.

Gjatë punës së tij 41 vjeçare ka kryer 43 Projekte dhe 35 Studime e Raporte shkencore të kërkim zbulimit të mineraleve të dobishme magmatike, sedimentare, të gjeologjisë regjionale, rrezikut gjeologjik dhe mjedisit. Ka drejtuar grupin e Hartës Gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000 të botuar në vitin 1983, anëtar i grupit të Hartës Metalogjenike të Europës (pjesa e Shqipërisë) e vitit 1982 dhe anëtar i grupit të Hartës së Rrezikut Gjeologjik të Shqipërisë në shkallë 1:200 000 të botuar në vitin 2000.

Ka marrë pjesë në shumë aktivitete shkencore jashtë shtetit si: Simpoziumi Internacional Helenik (H.E.A.T) Athinë, Greqi (Prill 1981); Universiteti i Barit, Itali (Shkurt 1997); Universiteti Teknik i Stambollit Turqi, (Mars 1999); Simpozium i Gjeologjisë Inxhinierike dhe Mjedisit I A E G (BGR) Hanover Gjermani (Tetor 2000); Simpoziumi i Mjedisit dhe Ekonomia, Helsinki Finlandë (Gusht 2001); Seminar, Traborema, Shkup, Maqedoni (27-28 Mars 2003)’ Konferencë për lumenjtë, Prishtinë, Kosovë (19-21 Tetor 2004).

Ka kryer 35 Studime për mineralin e kromit, elementëve të grupit të platinit, gurëve dekorativë e lëndëve të para të ndërtimit, gjeologjisë regjionale, rrezikut gjeologjik e mjedisit, 45 Referate e kumtesa të mbajtura në konferenca e simpoziume brenda e jashtë shtetit dhe 21 artikuj shkencorë për problemet e mineraleve të dobishme dhe gjeologjisë regjionale, mjedisit etj. të botuara në Buletinin e shkencave gjeologjike e buletine jashtë vendit.

kushtuar rëndësi të veçantë kërkim vlerësimit dhe përgjithësimit të punimeve të kryera për lëndët e para minerale industriale në gjithë territorin e vendit.

Në vitet 1992-1995 nga Instituti i Gjeologjisë në bashkëpunim me Ndërmarrjet gjeologjike nën drejtimin e Prof.Dr. Dëfrim Shkupit u krye Studimi përgjithësues për Gurët dekorativë të Shqipërisë, ndërsa në vitin 2005 përfundoi studimi “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të Shqipërisë” nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në bashkëpunim me të gjitha ndërmarrjet gjeologjike, në kuadrin e Studimit të Strategjisë së zhvillimit të vendit tonë, nën drejtimin e Prof. Dr. Bashkim Lleshit ku kontribuuan edhe shumë specialistë të tjerë të gjeologjisë si: Gjovalin Leka, Vesel Hoxha, Polikron Vaso, Veip Gjoni, Agim Gucaj, Bislim Boshnjaku, Mimoza Hanxhari, Lumnije Dibra etj.

Në vitet 1998-1999 nga Fakulteti Gjeologjisë dhe i Minierave u krye studimi i Hartës Metalogjenike të Shqipërisë nën drejtimin e Prof.Dr. Besnik Ostrosit dhe kontributin e shumë specialistëve të tjerë të gjeologjisë.

Ndërsa në vitin 1996, Prof. Dr. Rushan Kocibelli në librin Historia e nëntokës shqiptare, një rëndësi të veçantë i kushton përshkrimit të mineraleve jo metalorë dhe shkëmbinjve industrialë të vendit tonë.

Njohjes së mineraleve industriale i kanë shërbyer dhe shumë rilevime gjeologjike të shkallëve 1:10 000 e 1:25 000 të kryera nga ndërmarrjet gjeologjike dhe ato të kryera nga Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë të filluara në vitet tetëdhjetë.

Falënderoj redaktuesin e këtij libri specialistin e vjetër të gjeologjisë, Prof.Dr.Aleks Vranai për punën e kujdesshme dhe me kompetencë profesionale që ka kryer ne redaktimin e këtij libri dhe specialisten gjeologe Lumnie Dibra për ndihmesën e dhënë në punimin në kompjuter të hartave.

KONTRIBUO PER GAZETEN
“është koha për t’u pajtuar...” merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

Fragment nga romani “Loti rebel”,
Botimet M&B, Tiranë, 2012

Dashuria nuk rri nën Gurin e Lotit

Nga **LUTFI HANKU**

...Humbej shkrimtari nëpër kulla e pallate të qytetit. Mblidhte vlerat njerëzore, si gjeologu gurët e kromit.

Hidhte në copa letrash fakte e mendime, edhe pse një sy ia kishin vjedhur shkronjat. Gjumin me kafe e vriste për të ringjallur vehtësinë e secilit “princ” bulqizak, që historia e ndriçon në 36 shkronja.

Kupa blu e qiellit ulet butësisht mbi kullat duke krjuar një halucinacion dehës. Pastaj lag buzët te Gurra e Kuqe..

Shkrimtari, edhe në natën e gjysmëbotës, flet me heronjtë. Shkruan. Yjet lëvizin. Xixëllojnë kaltërsinë.

Në agim yjet e ndezur puthin Gurin e Lotit rebel.

Lojërat e yjeve e çlodhën shkrimtarin me magjinë e romantikës mistike bulqizake.

Shirita drite hynë në kullën e Bulzak Cebegut, që mundohej ta mblidhte në pëllëmbët e duarve hisen e dritës së diellit.

Porta trokiti. Ca burra hynë në shtëpi. Donin shkrimtarin. Pas tyre mbërrin kryetari i komunës me Asllanin.

- E ka gdhirë mbi letra, -tha Karaj.

Bektash Jangulli hodhi sytë mbi copat e shkruara.

- Peshohen shpirtrat! -tha Sulë Alia duke lexuar.

- Nuk ka gjë që nuk peshohet, - ndërhyri Haziz Keta.

Sula lexoi një fragment me sy dhe e puthi. Si duket, i pëlqeu emërtimi i romanit”.


- O Zot, edhe yjet, edhe gurë, edhe lotë rebelë, edhe vrasje..., - tha nëpër dhëmbë Bektash Jangulli.

Abaz Gjoka vuri dorën në zemër.

- Gurë e lotë ka pas vendi, - tha Bulzak Cebegu.

Fluturimi nënqeshte duke shfletuar romanin.

-Mbajnë vehtësinë e Bulqizës, -tha Haziz Keta duke i shtrirë dorën shkrimtarit.



* * *

- Dua ta lexojë me zë Asllani fragmentin e fundit, -kërkoi shkrimtari duke i dhënë materialin.

...Ai uli të bijën nga kali. Pushuan tek çezma.

Eh, bota e njeriut! Këtë tokë të ngrirë e këtë sajz zgjodhi Zoti për ne..., - i tha vetes Bulzak Cebegu.

- Merr një dorë me dhé, -e porositi të bijën ai.

Asaj dy pika lot i pikuan në çikën e strehës.

Loti rebel i bulqizakut mblidhet si reja e shiut e nga halli shprazet syve.

Cuca “humbi” në heshtjen e lotëve. Dikush e tërhoqi. Në sy shkrepi vetëtima e zjarrtë. Ajo i kishte vjedhur fjalën. Magjia ia grabiti zërin e fjalës? Magjia e xhindosur!

-Baba! -belbëzoi cuca si engjëll.

Në dorë shtrëngoi dheun e lagur me lotë rebelë. U shkri fjala e ngrirë. Jehoi “magjia” e mrekullisë së besimit në dashurinë e Bulzak Cebegut!

Zëri i ASsllanit u ndal. Kulla mori frymë.

-Vazhdo! -u dëgjua kryetari i komunës.

Ata vështronin me dashuri shkrimtarin. Ndonjërit balli i rrudhej mbi vetulla. Tjetri zvogëlonte sytë pa vullnet, ose shtrembëronte buzët.

Monumenti i bukurisë, i gdhendur nga koha, Shkëmbi i Skënderbeut ndjeu dridhje deri në palcë, si ta lëvizte loti rebel. Vetëtimat e ndezura u shuan në hieroglifët e penestëve ilirë; gjurmët latine, bizantine, sllave, osmane e të Arbrit, fqinjëve italianë, gjermanë e sllavokomunistëve. Kocka pa emër ranë në zall. Retë e zeza ulën shpatat me ngarkesa plus-minus. Gjëmimet dhe furtuna u fshehën për çlodhje mbas Temlës së Peladhisë dhe gjëma u mbyt në gremina. Rruga e Arbërit u çlodh nga urimet e Bulzak Cebegut duke derdhur hijeshinë e shtegtimit të historisë.

Sakaq, dielli çau retë. Qielli u zbulua në nëntorin e qeshur. Hija e adhuruesit, me dritë dashurie zbriti nga shkëmbi dhe njeriu eci në Rrugën e Arbrit e ndërtuar që në shekullin XI. Dritëroi Bulqiza, dritëroi Gryka e Madhe. Ai u kthye nga mërgimi i gjatë. E solli dashuria!

He-he-heeej, erdhi njeriu! - u dëgjua zëri bubullues që mbante përdore Bulzak Cebegu .

Zë mistik!? - Si gjëmim. Në luginën e përmalluar u derdh. Bulqiza. Portat hapi.

- Dashuria si fëmija. Kur nuk i plotësohet kërkesa, loton...

- Dashuria nuk rri nën Gurin e Lotit, - tha Bulzak Cebegu, si të kërkonte kundërshtim nga vallja e burrave.

- Sa ai Gurë lotësh do të rrojë, - uroi Haziz Keta i gëzuar.

- Ardhtë në fëmijët e Bulqizës! -uroi dhe Asllan Daxha.

Rreshtat e fundit të epilogut të romanit i lexoi shkrimtari:

...Bulzak Cebegu iu ngjit majës së Plakthit shkëmbor. Dielli nxorri syrin dhe shuajti etjen duke pirë vesën e freskët të Plakthit, ndërsa Bulzaku shijoi hapjen e kaltërsisë mahnitëse të universit duke ndjerë rrezatimet e ëmbla të vakësisë diellore të mëngjesit.

- Ti na ke ngrohur, o diell i gjithësisë, - foli Bulzaku.

- Jo gjithmonë, o njeri. Retë e zeza m’i kanë vjedhur rrezet që ruaja për ju, - tha me keqardhje dielli.

- Shpirti ma do të të shpërblej, o vëlla bujar.

- O njeri, a i lyp gjë nëna fëmijës?

- Vetëm dashuri, o diell, vetëm dashuri...!

* * *

Motet mblodhën kullat e dy krahëve të Rrugës së Arbrit. Ndërsa mëngjesi i kulluar e ngriti Bulzak Cebegun si engjëll në fluturim mbi krahët e këngës:

Nga Qaf’-Bulli n’Fushë-Kala
Si Bulqiza jon’ nuk ka!

Heej, njerëz! - shkundi luginën e gjelbër gjëmimi i zërit të Bulzakut, që shtyu tisin gri të mjergullës dhe u dritëruan e u zgjuan nga nata e gjatë gjysmë shekullore princërit e dashurisë. Bulqiza u vesh blu dhe rozë!

Nuri i bukurisë ndriti në sytë e mallëngjyer të Karajt. Ai ngriti “hopa” njeriun e diellit. E uli në vesën e gurit. Aty e mbajtën gurët magjikë në botën e lotit rebel. Mbeti dhe në memorien e kullave e në kuvende si metafora të mençurisë ku derdhej dashurisë.

Bulzak Cebegu hodhi mbi asfalt dheun e lagur me lotë rebelë. Veturat frenuan. Zbritën me hijen e pushtetit dy kryetarët mes hijeshisë blu dhe rozë.


- Dhëmbin gjurmët! - foli Zeneli si të ndjente rënkimin e shekujve të perënduar.

- Erdhi koha e njeriut! - u përgjigj Keta duke u përqafuar bulzakçe.

Diell e dashuri u derdhën rrugës së Arbërit duke dritëruar me xixëllime blu e rozë për të tretur e tharë lotët shekullorë të rebelimit.

Libra që mund t’i gjeni në Panairin e Libri tnë Peshkopi

























Botime për Dibrën në

PANAIRIN E LIBRIT














Këto botime e shumë të tjera mund t'i gjeni në Panairin e Librit në Peshkopi në datat 28-31 Tetor 2015 ,
si dhe në Panairin e Librit në Tiranë në datat 11-15 Nëntor 2015

cyan magenta yellow black